



**Misioni i BE-së për Sundimin
e Ligjit në Kosovë – EULEX**

Raporti i Monitorimit të Drejtësisë

Gjetjet dhe rekomandimet

Nëntor 2025



Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë – EULEX

Raporti i Monitorimit të Drejtësisë

Gjetjet dhe rekomandimet

Nëntor 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	5
Parathënie	7
1. Hyrje	9
2. Gjetjet e Monitorimit Sistemik	10
2.1. Rastet e profilit të lartë	10
2.2. Produktiviteti i seancave gjyqësore.....	15
2.3. Mbikëqyrja gjyqësore në lloje të caktuara të privimit nga liria	18
2.4. Zbatimi i dënimeve plotësuese.....	20
2.5. Planifikimi dhe caktimi i seancave të shumëfishta në shqyrtimet kryesore	23
2.6. Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve me shkrim nga gjykatat themelore.....	26
2.7. Vazhdimi i ushtrimit të avokatisë nga avokatët e paditur ose të dënuar	27
2.8. Zbatimi i udhëzimeve për dënimet nga gjykatat themelore	29
2.9. Kërcënimet ndaj prokurorëve	33
3. Gjetjet nga monitorimi tematik	37
3.1 Llogaridhënia për pretendimet për keqtrajtim nga pjesëtarë të Policisë së Kosovës: vlerësim fillestar	37
3.2.1. Hetimet për dhunën në familje dhe mbrojtja e viktimave dytësore	44
3.2.2. Vlerësimi i provave në rastet e dhunimit	46
3.2.3. Drejtësi miqësore për fëmijët në rastet e dhunës seksuale me viktimë të mitura.....	51
3.3. Krimet sipas të drejtës ndërkombëtare	53
3.4. Aplikimi i legjislacionit penal në rastet e nxitjes së përçarjes dhe mosdurimit	57
3.5. Përdorimi dhe mirëmbajtja e Sistemit për menaxhimin informativ të lëndëve	60

Lista e shkurtesave

GJTH	Gjykata Themelore
PTH	Prokuroria Themelore
KP	Kodi Penal
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
SIML	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve
GJA	Gjykata e Apelit
KPP	Kodi i Procedurës Penale
KPT (CPT)	Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës
KEDNJ (ECHR)	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GJEDNJ (ECtHR)	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
DHB	Divizioni i Hetimeve të Brendshme
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
OAK	Oda e Avokatëve të Kosovës
AKI	Agjencia e Inteligjencës e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
PK	Policia e Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës
LESK	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale
LESP	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
IPK	Inspektorati i Policisë së Kosovës
GJS	Gjykata Supreme
PSO	Procedura Standarde Operative
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

Parathënie



Kam kënaqësinë ta prezantoj Raportin e Monitorimit të Drejtësisë për vitin 2025 të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).

Ky është raporti i tetë që e ka hartuar EULEX-i prej vitit 2018, që kur e përmbylli gradualisht mandatin ekzekutiv të tij në sistemin e drejtësisë. Ashtu si edhe katër Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë të publikuara nga viti 2020, ky botim është publik. Kjo e konfirmon qëllimin tonë për ta rritur llogaridhënien institucionale dhe për të promovuar një kuptim më të thellë të zbatimit të sundimit të ligjit në Kosovë.

Ndërsa Raporti i kaluar i Monitorimit të Drejtësisë, i publikuar në vitin 2024, u përqendrua në vlerësimin e progresit të bërë në zbatimin e rekomandimeve nga raportet e mëparshme, ky raport i kthehet shqyrtimit të aspekteve specifike të funksionimit të gjithë zinxhirit të drejtësisë penale, në përputhje me raportet e publikuara në vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Gjetjet kryesore të këtij Raporti të Monitorimit të Drejtësisë rrjedhin si nga monitorimi sistemik ashtu edhe nga ai tematik. Disa nga këto gjetje përsërisin çështjet e identifikuar në raportet e mëparshme të EULEX-it; të tjerat i referohen fushave të reja që Misioni filloi t'i monitoronte viteve të fundit. Konkretisht, EULEX-i e konsideroi të rëndësishme ta shqyrtojë funksionimin e procesit të llogaridhënies për pretendimet për keqtrajtim nga Policia e Kosovës, mbikëqyrjen efektive gjyqësore në lloje specifike të privimit nga liria, si dhe zbatimin e legjislacionit penal për nxitjen e përçarjes dhe mos-tolerancës. Raporti gjithashtu i analizon shqetësimet e ngritura nga rastet e kërcënimeve ose frikësimeve ndaj profesionistëve të sistemit të drejtësisë, veçanërisht prokurorëve, në disa raste që burojnë nga përfaqësues institucionale dhe politike. Duke e pasur parasysh lidhjen e thellë të këtyre çështjeve me sundimin e ligjit dhe vlerave demokratike në Kosovë, ato meritojnë një angazhim të fortë dhe të bashkërenduar nga të gjitha këndvështrimet institucionale.

Raporti i Monitorimit të Drejtësisë i këtij viti paraqet rekomandime të shumta për institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë, bazuar në monitorimin e afërsisht 400 rasteve dhe mbledhjen e të dhënave dhe informatave nga policia, prokuroria, zyrtarët gjyqësorë, pjesëtarët e odave të avokatëve dhe shoqërisë civile. Fokusi është vendosur qëllimisht në fushat ku vazhdon të ketë mangësi dhe ku kërkohet përmirësim. Ndërsa i vlerësojmë angazhimet dhe progresin e arritur nga institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë që nga krijimi i Misionit në vitin 2008, rekomandimet tona kanë për qëllim të nxisin progres të mtejshëm dhe ta mbështesin Kosovën në mënyrë konstruktive, në përputhje me partneritetin e gjatë dhe produktiv të ndërtuar dhe të zhvilluar midis Misionit tonë dhe këtyre institucioneve.

Bazuar në gjetjet e tij nga monitorimi sistemik, EULEX-i vlerëson se prej publikimit të Raportit të Monitorimit të Drejtësisë të vitit 2024 nuk janë materializuar ndryshime të rëndësishme, pavarësisht angazhimeve institucionale. Ky përparim i kufizuar është i dukshëm në trajtimin e rasteve të profilin të lartë, *proporcionin* e seancave gjyqësore produktive dhe aplikimin jokonsekuent të dënimeve plotësuese. Sidoqoftë, një aspekt pozitiv është se praktika e caktimit të më shumë se një seance të radhës, e madje edhe më shumë se dy, është rritur ndjeshëm, veçanërisht në rastet e ndërlikuara dhe ato me shumë të pandehur. Kjo tregon një zhvillim pozitiv në planifikimin e gjykimeve, në përputhje me rekomandimet e mëparshme të EULEX-it. Megjithatë, kontrasti në dënime vazhdon pavarësisht ekzistencës së Udhëzimeve për Dënimet të Gjykatës Supreme, të hartuara për ta tejkaluar këtë problem.

Lidhur me gjetjet e monitorimit tematik, EULEX-i vlerëson se Kosova ka krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale për të siguruar llogaridhënien për keqtrajtimin nga Policia e Kosovës. Megjithatë, ajo duhet të sigurojë që kjo kornizë të zbatohet plotësisht dhe në praktikë në të gjitha rastet kur ngrihet ndonjë pretendim i argumentueshëm, pavarësisht nga grada ose njësia e zyrtarit të policisë. Kjo gjithashtu ka rëndësi të madhe për ruajtjen e besimit publik në Policinë e Kosovës në një nivel të lartë.

Zbatimi i legjislacionit penal për nxitjen e përçarjes dhe mos-tolerancës, një temë tjetër e shqyrtuar në këtë raport, duhet t'i përmbahet në mënyrë strikte standardeve të drejtave të njeriut. Qasja ndëshkuese ndaj asaj që mund të konsiderohet manifestim i lirisë së shprehjes rrezikon ta dëmtojë besimin e publikut në institucione, veçanërisht në radhët e komuniteteve jo-shumicë. Prandaj, një qasje e arsyeshme nga autoritetet, e bazuar në angazhim konstruktiv dhe dialog me të gjitha segmentet e shoqërisë, mbetet thelbësore.

Përkitazi me luftën kundër dhunës në familje, shqyrtimi i një mostre rastesh zbuloi se duhet t'i kushtohet vëmendje më e madhe mbrojtjes së fëmijëve si viktimat dytësore. Analiza e aktgjykimeve nga gjykatat në të gjithë Kosovën për veprën penale të përdhunimit, tregon se nocionet e paragjykuara dhe stereotipet rreth kësaj forme të dhunës seksuale ndikojnë në vlerësimin e provave. Këto supozime të rreme mund të rezultojnë në aktgjykime të gabuara, ri-viktimizim dhe mungesë besimi në gjyqësor. Për më tepër, në lidhje me rastet e dhunës seksuale ku viktimat është i mitur, monitorimi i EULEX-it zbuloi se pajisjet dhe shfrytëzimi i dhomave të intervistave miqësore për fëmijë dallojnë ndjeshëm, ndërsa intervistat nuk filmohen edhe kur pajisjet janë në dispozicion.

Sa i përket hetimit, ndjekjes penale dhe gjyimit të krimeve sipas së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht krimeve të luftës, EULEX-i vuri në dukje aktivitet të vazhdueshëm në rritje në të gjitha fazat. Megjithatë, ndërsa bëhen përpjekje për të ofruar drejtësi për viktimat, autoritetet duhet t'i respektojnë plotësisht standardet e gjyimit të drejtë; në këtë kontekst Misioni identifikoi disa fusha shqetësuese.

Përfundimisht, Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), i krijuar nga viti 2018, vazhdon të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës. Funkcionalizimi i tij duhet të vazhdohet dhe të forcohet më tej përmes buxhetimit, planifikimit dhe trajnimit të duhur.

Duke i ndarë këto gjetje dhe rekomandime specifike përcjellëse me institucionet dhe publikun e gjerë, EULEX-i synon t'i inkurajojë të gjitha palët e interesuara, nga lidhshipi politik dhe institucional deri te shoqëria civile dhe individët, që të angazhohen për t'i mbështetur vlerat e demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Ky angazhim i përbashkët është thelbësor për rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Në këtë rrugëtim, Kosova gjen tek EULEX-i një partner të përkushtuar dhe të besueshëm, ndërsa ky raport është një shembull tjetër i angazhimit tonë për ta mbështetur Kosovën, institucionet dhe popullin e saj.

Si përfundim, dua të theksoj se ky Raport i Monitorimit të Drejtësisë nuk do të kishte qenë i mundur pa angazhimin dhe bashkëpunimin e institucioneve përkatëse të Kosovës, të cilave u shpreh mirënjohjen time të sinqertë dhe ripohoj vendosmërinë e palëkundur të Misionit tonë që të vazhdojmë të punojmë së bashku krah për krah si partnerë të besueshëm.

Giovanni Pietro Barbano

Shefi i Misionit EULEX në Kosovë

1. Hyrje

Njësia për Monitorimin e Rasteve (NJMR) e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) e vlerëson funksionimin e Policisë së Kosovës (PK) dhe gjyqësorit në aspektin e përputhshmërisë procedurale, ligjore dhe të drejtave të njeriut. Ky Raport i Monitorimit të Drejtësisë i vlerëson aspektet specifike të funksionimit të gjithë zinxhirit të drejtësisë penale, policisë, prokurorisë dhe gjykatave, në përputhje me Raportet e Monitorimit të Drejtësisë të publikuara në vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Seksioni i parë, i titulluar “Monitorimi sistemik”, ofron informacione mbi sfondin, gjetjet dhe rekomandimet për rastet e profilit të lartë, produktivitetin e seancave gjyqësore, zbatimin e dënimeve plotësuese, planifikimin dhe caktimin e seancave të njëpasnjëshme, kohëzgjatjen për t’i marrë vendimet me shkrim nga gjykatat themelore, vazhdimin e ushtrimit të avokatisë nga avokatët e paditur ose të dënuar, zbatimin e Udhëzimeve për Dënimet nga gjykatat themelore dhe kërcënimet ndaj prokurorëve. Ky kapitull përfshin gjithashtu një analizë të mbikëqyrjes gjyqësore të formave specifike të privimit nga liria, pas disa rasteve të monitoruara nga EULEX-i në vitet 2023 dhe 2024.

Seksioni tjetër, i titulluar “Monitorimi tematik”, përqendrohet në lloje specifike të veprave penale, siç është dhuna në baza gjinore, ku përfshihen hetimet për dhunën në familje dhe mbrojtjen e viktimave dytësore, vlerësimin e provave në rastet e përdhunimit dhe drejtësinë miqësore për fëmijët në rastet e dhunës seksuale ku viktima është i mitur, krimet sipas të drejtës ndërkombëtare dhe zbatimin e legjislacionit penal për nxitjen e përçarjes dhe mos-tolerancës. Ky seksion përfshin gjithashtu një vlerësim fillestar mbi llogaridhënien për keqtrajtimet e pretenduara nga pjesëtarët e PK-së. Në fund, ky seksion përmban analizën për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen së Sistemit Informativ për Menaxhimin e Lëndëve (SIML).

Shumica e gjetjeve i referohen periudhës nëntor 2024 deri në shtator 2025, por raporti përmban edhe informacione mbi zhvillimet që kanë ndodhur para ose pas asaj date, kur ato janë të rëndësishme.

2. Gjetjet e Monitorimit Sistemik

2.1. Rastet e profilit të lartë

Sfondi

Për qëllimet e monitorimi, EULEX-i e përcakton një rast të profilit të lartë si një rast në të cilin të pandehurit kishin pozita të larta politike ose administrative, akuzat e ngritura kundër tyre kishin të bënin me grupe të mëdha të organizuara, vepra të rënda penale dhe dëme me vlerë të lartë, si dhe raste të trajtuara më parë nga EULEX-i të cilat janë ende në proces. Veprat kryesore penale kanë të bëjnë me krimin e organizuar, korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimet e dhunshme.

Në të gjitha Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë, EULEX-i raportoi se një numër i konsiderueshëm i rasteve të profilit të lartë kishin shënuar përparim të ngadaltë si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë procedurave gjyqësore, të cilat ndonjëherë përfshinin rigjykime të përsëritura. Raste të tjera të profilit të lartë përparuan, ndërsa shpesh përfunduan me lirime nga akuzat, duke përfshirë disa raste të mëparshme të EULEX-it. Rastet e profilit të lartë tërheqin interes të gjerë publik dhe dukshmëri të lartë duke pasur parasysh faktin se autorët e krimeve shpesh janë njerëz të njohur dhe/ose akuzohen për vepra shumë të rënda. Prandaj, është me interes të veçantë që këto raste të trajtohen me kohë dhe në mënyrë efektive, pasi ato ndikojnë në besueshmërinë e sistemit të drejtësisë në tërësi dhe e formësojnë besimin e publikut në gjyqësor.

Gjetjet

Rastet e profilit të lartë që janë ende në proces me një përparim minimal ose pa aktgjykim përfundimtar

Shumë raste të profilit të lartë, përfshirë rastet e mëparshme të EULEX-it, kanë pasur vonesa për vite me radhë deri në gjykimin e tyre, kurse një numër i rëndësishëm i tyre nuk kanë arritur deri te një aktgjykim përfundimtar. Për shembull, në rastin e mëparshëm të EULEX-it *Olympia* në lidhje me vrasjen e një pjesëtari të stafit të UNMIK-ut dhe një zyrtari të PK-së në vitin 2004, Gjykata Themelore (GHTH) e Prishtinës e dënoi njërin nga të pandehurit me tetë vjet burgim kurse tjetrin e liroi nga akuzat me aktgjykimin e shpallur më 13 shtator 2023. Aktgjykimi u ankimua dhe Gjykata e Apelit (GJA) mbajti një seancë në mars 2025. Megjithatë, deri në korrik 2025, GJA nuk kishte nxjerrë ende ndonjë vendim, 21 vjet pas kryerjes së krimit dhe tetë vjet pas ngritjes së aktakuzës.

Në rastin e mëparshëm të EULEX-it *City Club*, aktakuza është ngritur në vitin 2017 kundër një të pandehuri të akuzuar për vrasjen e një personi dhe plagosjen e dy personave tjerë në janar 2010 në klubin e natës “City Club” në Pejë. Më 30 nëntor 2023, në rigjykimin e dytë, i pandehuri u shpall i pafajshëm, pas shtatë vitesh në paraburgim dhe dy dënimeve të mëparshme. Aktgjykimi u ankimua nga prokurori dhe më 20 shtator 2024, GJA e ndryshoi vendimin e GJTH-së, e dënoi të pandehurin për vrasje të rëndë dhe për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe e dënoi atë me 24 vjet burgim duke urdhëruar paraburgimin e tij. Avokati mbrojtës e ankimoi aktgjykimin në Gjykatën Supreme (GJS). Më 25 shkurt 2025, GJS e anuloi përsëri aktgjykimin e GJA-së dhe e ktheu rastin për rigjykim. Ky do të jetë rigjykimi i tretë i këtij rasti, pothuajse tetë vjet pas ngritjes së aktakuzës dhe 15 vjet pas kryerjes së krimit.

Në rigjykimin e dytë të rastit *Enver Sekiraga*, në maj 2024 i pandehuri u dënua me 25 vjet burgim për vrasjen e një zyrtari policie. Krimi ka ndodhur 17 vjet më parë, ndërsa aktakuza është ngritur nga EULEX-i para dhjetë vitesh. Kur u shpall aktgjykimi, gjyqtari i shkallës së parë hoqi

papritur masën e arrestit shtëpiak të caktuar kundër të pandehurit, gjë që rezultoi në pezullimin e gjyqtarit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Gjykata e Apelit më vonë e ndryshoi masën në paraburgim, por i pandehuri nuk mund të gjendej më nga PK-ja dhe është ende në arrati. Ankesa kundër aktgjykimit është në pritje të shqyrtimit në GJA.

Në *rastin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit*, udhëheqësit të “Iniciativës Qytetare Serbia, Demokracia, Drejtësia”, të kryer në vitin 2018, aktakuza u ngrit në dhjetor 2020 kurse shqyrtimi gjyqësor filloi më 6 korrik 2021. Seancat e rregullta ishin të planifikuara, por një numër i konsiderueshëm i tyre ishin joproductive ose u anuluan. Aktgjykimi u shpall nga GJTH e Prishtinës më 28 qershor 2024. Katër nga gjashtë të pandehurit u shpallën fajtorë. Megjithatë, aktgjykimi në formë të shkruar nuk u përgatit deri në maj 2025, kurse tani është ankimuar.

Në *Rastin e Turqve të Deportuar*, ish-Drejtori i Agjencisë së Inteligjencës të Kosovës (AKI) u dënua për keqpërdorim të pozitës ose autoritetit zyrtar me katër vjet e tetë muaj burgim. Të pandehurit e tjerë u liruan nga akuzat. Vendimi u nxor më 19 korrik 2023, pothuajse dy vjet pas ngritjes së aktakuzës dhe pesë vjet pas deportimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova në Turqi bazuar në një kërkesë nga autoritetet turke. Më shumë se një vit më vonë, më 13 dhjetor 2024, GJA e ktheu rastin në rigjykim për ish-Drejtorin e AKI-së. Rigjykimi filloi më 12 shkurt 2025, në prani të katër shtetasve turq të prekur, të cilët ishin liruar nga autoritetet turke, dhe që atëherë seancat janë duke u zhvilluar rregullisht.

Rasti i *Veteranëve* është ende në proces, shtatë vjet pasi u ngrit aktakuza kundër 12 personave me akuzën e keqpërdorimit të pozitës ose autoritetit zyrtar. Të pandehurit u akuzuan për keqpërdorim të pozitave të tyre si anëtarë të një Komisioni Shtetëror duke u mundësuar pothuajse 20,000 personave të marrin përfitime veteranësh për të cilat ata nuk kishin të drejtë. Pas pesë përpjekjeve të dështuara, seanca e parë e rigjykimit u zhvillua më 31 tetor 2023, pas anulimit të aktgjykimit lirues nga GJA të nxjerrë në shkallë të parë për të gjithë 12 të pandehurit në mars 2022. Pavarësisht se rigjykimi ka vazhduar nga tetori 2023, vetëm më 14 korrik 2025 gjykata miratoi një vendim duke i dënuar të gjithë të pandehurit, përveç dy prej tyre, me një vit burgim secilin. Versioni me shkrim i vendimit ende nuk është në dispozicion. Prandaj, nuk dihet nëse vendimi do të ankimohet përsëri.

Një vendim është nxjerrë gjithashtu në rastin *Autostrada e Shkupit*, për të cilin është ngritur aktakuza më 4 shkurt 2022 kundër ish-Ministrit të Infrastrukturës, Pal Lekaj, dhe tre të pandehurve të tjerë për keqpërdorim të pozitës ose autoritetit zyrtar. Më 31 janar 2024, të katër të pandehurit u dënuan në shkallë të parë me burgim midis tre vjet e tetë muaj dhe një vit e tetë muaj. Megjithatë, GJA e anuloi aktgjykimin e shkallës së parë me vendimin e datës 25 shkurt 2025 dhe e dërgoi atë për rigjykim. Seanca e parë e rigjykimit u zhvillua më 23 korrik 2025.

Gjykimet në disa prej rasteve *Brezovica*, të cilat për një kohë të gjatë ishin bllokuar plotësisht, kohëve të fundit e kanë përshpejtuar ritmin e tyre. Rastet lidhen me akuza që përfshijnë keqpërdorimin e detyrës zyrtare, marrjen e ryshfetit, ushtrimin e ndikimit në lidhje me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e mjedisit. Seanca fillestare e *Rastit Brezovica I*, bazuar në aktakuzën e datës 11 nëntor 2020 kundër 11 të pandehurve, pas përpjekjeve të shumta të pasuksesshme për gati dy vjet, u zhvillua në gusht 2023. Përfundimisht, më 4 korrik 2025, dy inspektorë komunalë ndërtimor nga Komuna e Shtërpçës u dënuan me një vit burgim efektiv dhe dënime plotësuese për keqpërdorim të pozitës ose autoritetit zyrtar, ndërsa një i pandehur i tretë u dënua me një vit burgim me kusht dhe një gjobë prej 20,000 eurosh për veprën penale të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të mjedisit. Më parë, ishte arritur një marrëveshje për pranimin e fajësisë me pesë të pandehur për një shumë totale prej më shumë se 100,000 eurosh për veprën penale të ndotjes, degradimit dhe shkatërrimit të mjedisit, duke përfshirë dëmet. Në *Rastin Brezovica II*, ku aktakuza është ngritur më 9 dhjetor 2022 kundër 12 të pandehurve, fillimi i shqyrtimit kryesor u shty disa herë, dhe pati vonesa të shumta nga

seanca fillestare që u zhvillua më 3 prill 2023. Megjithatë, nga nëntori 2024 deri në janar 2025, u zhvilluan seanca të shpeshta përmes planifikimit të seancave të njëpasnjëshme në përputhje me rekomandimet nga Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë të EULEX-it, por përsëri midis janarit dhe qershorit 2025 nuk u zhvillua asnjë seancë.

Rastet e profilit të lartë pa përparim të konsiderueshëm

Një numër i konsiderueshëm i rasteve të profilit të lartë vazhduan me ritëm të ngadaltë ose madje nuk lëvizën fare gjatë kësaj periudhe raportimi.

Midis tyre, për shembull, është pjesa e ndarë nga *Rasti i Arratisjes nga Spitali*, që lidhet me frikësimin e dëshmitarëve të krimeve të luftës në lidhje me rastin *Drenica I*. Ky rast, me aktakuzën e datës 17 nëntor 2016, u nda nga rasti kryesor në shkurt 2020 dhe që atëherë ka grumbulluar vonesa të konsiderueshme. Rasti ka të bëjë me tetë të pandehur, përfshirë Kryetarin e Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku.

Rasti i mëparshëm i EULEX-it, *Toka 4*, në të cilën një grup i madh të pandehurish akuzohet për pronësi të paligjshme të tokës shoqërore, dhe i cili lidhet me rastet e mëparshme të EULEX-it, *Olympus I* dhe *Olympus II*, është një shembull tjetër i një rasti të profilit të lartë që ka mbetur pezull për vite me radhë, pa seanca produktive në periudhën 2019-2022. Gjykimi rifilloi në fund të vitit 2022 dhe u mbajtën disa seanca produktive gjatë vitit 2023, edhe pse me një ritëm të ngadaltë. Gjatë vitit 2025, rasti ngeci përsëri, më shumë se nëntë vjet pas ngritjes së aktakuzës nga prokurorët e EULEX-it më 3 mars 2016.

Në mënyrë të ngjashme, rigjykimi në rastin *Salih Qitaku* etj., ka ngelur pezull që nga seanca fillestare e rigjykimit në korrik 2017, deri më tani pa sukses, fillimisht për shkak të numrit të madh të rasteve të caktuara gjyqtarit, më vonë për shkak të daljes në pension të tij, kurse aktualisht për shkak të urdhër-arrestit ndërkombëtar kundër tre prej të pandehurve që ndodhen jashtë vendit. Aktakuza është ngritur në vitin 2014 kundër katër pjesëtarëve të dyshuar të një grupi të organizuar kriminal për organizimin e migrimin të paligjshëm të banorëve të Kosovës në vendet e Evropës Perëndimore.

Një tjetër ish-rast i EULEX-it që pati pak ose aspak përparim, pavarësisht se aktakuza është ngritur në vitin 2015, është *Rasti Touareg*. Ky është një rast veçanërisht sfidues pasi përfshin 41 të pandehur dhe akuza komplekse për krim të organizuar, shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, kontrabandë mallrash, falsifikim dokumentesh, tregti të ndaluar dhe shmangie tatimore, me një dëm të vlerësuar për buxhetin e Kosovës prej mbi 2.6 milionë eurosh. Rasti ishte transferuar nga GJTH e Mitrovicës në Departamentin Special të GJTH të Prishtinës në shkurt 2024 për shkak të ngarkesës së lartë me raste, së bashku me 12 raste të tjera komplekse me aktakuza të ngritura nga EULEX-i ose Prokuroria Speciale. Një nga rastet e transferuara është edhe *Rasti Transporti*, për të cilin aktakuza u ngrit në vitin 2016, por ndryshe nga *Rasti Touareg*, më 1 korrik 2025 u nxor një aktgjykim që i dënoi shtatë të pandehur me shtatë vjet burgim për kontrabandë mallrash dhe pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal. 21 të pandehurit e tjerë u liruan nga akuzat. Nga ana tjetër, në *Rastin Qarku*, që nga transferimi i tij në GJTH të Prishtinës në shkurt 2024, ku të pandehurit u akuzuan si pjesë e një grupi të organizuar kriminal për shmangie të pagesës së tarifave të detyrueshme doganore, kontrabandë mallrash, falsifikim dokumentesh, tregti të ndaluar dhe shmangie tatimore, ka pasur vetëm dy përpjekje për ta filluar shqyrtimin gjyqësor, në prill dhe korrik 2025. Një seancë e re është caktuar për tetor 2025.

Rasti *Fahredin Gashi*, në të cilin aktakuza është ngritur në GJTH të Prishtinës më 5 nëntor 2010, ngeci për një periudhë të gjatë në pritje të kërkesës së kryetarit të trupit gjykues drejtuar KG-JK-së në lidhje me emërimin e një eksperti të huaj për ta bërë vlerësimin e të pandehurit. Ky

rast është një ish-rast i EULEX-it kundër Fahredin Gashit për kryerjen e pretenduar të veprës penale krime lufte kundër popullatës civile, si dhe kundër Hysri Ramës për dhënien e ndihmës autorëve pas kryerjes së veprave penale. Në janar 2025, GJTH e Prishtinës e pezulloi rastin për shkak të gjendjes mendore të pandehurit. Vendimi për pezullim u ankimua nga avokati i të pandehurit dhe në mars 2025, GJA e pranoi kërkesën për hedhjen poshtë dhe për këtë e udhëzoi GJTH-në. Bazuar në këto udhëzime, gjyqtari i pushoi procedurat në korrik 2025.

Në ish-rastin e EULEX-it, *Bill Clinton II*, ku aktakuza është ngritur më 22 gusht 2014 dhe i është dorëzuar homologëve vendas më 24 prill 2018, nuk u shënua asnjë përparim për gati katër vjet, pjesërisht për shkak të pandemisë me COVID-19 dhe pjesërisht për shkak të ndryshimeve në përbërjen e trupit gjykues. Ky rast lidhet me rastin e sipërpërmendur *Enver Sekiraqa*. Menjëherë pas vrasjes së zyrtarit të PK-së Triumf Riza në gusht 2007, PK-ja dyshoi se Enver Sekiraqa e kishte orkestruar vrasjen. Në shtator 2007, policët kolegë të Rizës, në shenjë hakmarrjeje, dyshohet se vendosën një bombë në ndërtesën ku ndodhej kafeneja Sekiraqa, nga e cila u vranë dy persona dhe u plagosën disa të tjerë. Në fund të vitit 2024, filloi shqyrtimi kryesor gjyqësor dhe gjatë vitit 2025 rasti ka qenë aktiv, por me një ritëm të ngadaltë.

Për më tepër, hetimet për rastin e mëparshëm të EULEX-it në lidhje me vrasjen e pjesëtarit të stafit të EULEX-it Audrius Šenavičius në shtator 2013, *Rasti Blu*, ka pasur disa zhvillime kohët e fundit kur më 19 tetor 2025, PK-ja, me kërkesë të Prokurorisë Speciale, kreu disa bastisje në veri të Kosovës.

Rastet e profilit të lartë të gjykuara me lirime nga akuzat

Në përputhje me gjetjet e raportuara në Raportin e mëparshëm të Monitorimit të Drejtësisë të EULEX-it, një numër i konsiderueshëm i rasteve të profilit të lartë përfunduan me lirime nga akuzat, megjithëse në disa prej këtyre rasteve ishin shqiptuar dënimet në gjykimet fillestare. Për shembull, në ish-rastin e EULEX-it *Medicus*, ku aktakuzat u ngritën në vitin 2010 për trafikim organesh njerëzore dhe krim të organizuar, duke pretenduar se gjatë vitit 2008 kishin ndodhur dhjetëra transplantime të paligjshme të veshkave në Klinikën Medicus, në qershor 2023 GJTH i liroi nga akuzat të dy të pandehurit në rigjykimin e dytë, edhe pse ata ishin shpallur fajtorë më parë, përfshirë edhe nga ish-trupat gjykues të EULEX-it. Vendimi për ankesën është ende në pritje.

Në rastin *Autostrada e Gjilanit*, në të cilin katër zyrtarë nga Ministria e Infrastrukturës u paditën në shkurt 2021 me disa akuza, të tilla si ushtrim i ndikimit, keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar dhe pastrim parash, të gjithë u liruan nga akuzat me një aktgjykim të shkallës së parë më 7 maj 2024. Më 28 maj 2025, GJA e rrëzoi pjesërisht vendimin dhe e ktheu rastin në rigjykim të pjesshëm në lidhje me tre akuza kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës Betim Reçica kurse e la në fuqi lirimimin nga akuzat për tre të tjerët. Më 22 korrik 2025, GJTH e Prishtinës shpalli një vendim lirues në rigjykimin e këtij rasti.

Në rastet e mëparshme të EULEX-it *Grande I dhe II*, prokuroria ngrii aktakuzën në dhjetor 2016 kundër një grupi prej 20 të pandehurish, përfshirë Ukë Rugovën, djalin e ish-Presidentit Ibrahim Rugova, në GJTH të Prishtinës. Të pandehurit u akuzuan për organizim dhe pjesëmarrje në një grup kriminal, kontrabandë me migrantë dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Aktakuza pretendon se të pandehurit përdorën mjete mashtruese për të marrë viza Shengen për banorët e Kosovës nga Ambasada e Italisë në Prishtinë, duke përfituar kështu përfitim të konsiderueshëm material për veten e tyre. Rastet u ndanë në dy raste të ndara. *Rasti Grande I* (që përfshinte Ukë Rugovën) përfundoi me librim nga akuzat nga GJTH e Prishtinës në mars 2023 për akuzat më të rënda. Vendimi me shkrim u bë i disponueshëm më 30 qershor 2023 dhe u ankimua. Rasti është ende në pritje në GJA. *Rasti Grande II*

pati të njëjtat zhvillime. Në tetor 2023, të 15 të pandehurit u liruan nga akuzat, rasti u dërgua pjesërisht për rigjykim dhe në tetor 2024, gjykata i liroi përsëri të gjithë të pandehurit. Vendimi u ankimua dhe është ende në pritje në GJA.

Rasti *Avanci*, në të cilin dy zyrtarë të punësuar në Agjencinë e Produkteve Medicinale të Kosovës dhe në Ministrinë e Shëndetësisë u akuzuan për përvetësim të paligjshëm në detyrë dhe ndërhyrje në sistemet kompjuterike në vitin 2020, zgjati pesë vjet për t'u përfunduar vetëm në shkallën e parë. Sipas prokurorit, dëmi i supozuar ndaj buxhetit të Kosovës arriti në mbi një milion euro. Më në fund, në maj 2025, të dy zyrtarët u liruan nga akuzat me vendim të GJTH të Prishtinës.

Në ish-rastin e EULEX-it *Olympus I*, në vitin 2016 është ngritur aktakuza me akuzat për pronësi të paligjshme të tokës shoqërore dhe pronave të tjera. Pas pandemisë me COVID-19, seancat dëgjimore u zhvilluan rregullisht në GJTH të Prishtinës nga mesi i vitit 2022 deri më 11 maj 2023, por me një ritëm shumë të ngadaltë në pjesën e dytë të vitit 2023. Disa seanca të njëpasnjëshme u caktuan në fillim të vitit 2024, por pak prej tyre ishin produktive. Përfundimisht, më 26 dhjetor 2024, GJTH e Prishtinës e nxori vendimin. Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Azem Sylja, dhe tetë të pandehur të tjerë u liruan nga të gjitha akuzat, ndërsa shtatë të pandehur u shpallën fajtorë për krim të organizuar dhe u dënuan me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe gjoba nga 20,000 deri në 50,000 euro.

Shembuj të tjerë janë rastet e mbetura *Stenta*. Në rastin *Stenta III*, i cili mbeti i pazgjidhur nga nëntori 2021 deri në janar 2024, GJTH e Prishtinës më 21 tetor 2024 shpalli lirimin nga akuzat e 14 të pandehurve (persona fizikë dhe juridikë), për akuzat për dhënie ryshfeti, trajtim mjekësor të papërgjegjshëm dhe shmangie tatimore. Lidhur me akuzën për trajtim mjekësor dhe farmaceutik të ushtruar në mënyrë të paligjshme, aktakuza u rrëzua sepse kishte arritur afatin e parashkrimit. Vendimi lirues u konfirmua nga GJA në shtator 2025.

Stenta II ishte ndarë në një rast më të madh *Stenta II.1*, me 43 të pandehur, dhe rastin *Stenta II.2*, ku paralelisht gjykohej një grup më i vogël. Aktgjykimi për rastin *II.1* u shpall më 20 shtator 2023 dhe të gjithë të pandehurit u liruan nga akuzat. Prej atëherë, u gjykua edhe rasti *Stenta II.2*, ku përsëri të gjithë të pandehurit u liruan nga akuzat. Më 27 mars 2025, GJA e hodhi poshtë ankesën për rastin *Stenta II.1* dhe la në fuqi vendimin e mëparshëm. Në shtator 2025, GJA e la në fuqi gjithashtu vendimin për lirimin nga akuzat për rastin *Stenta II.2*. Pas këtyre vendimeve të GJA, të gjithë të pandehurit në rastet *Stenta* janë liruar nga akuzat bazuar në aktgjykime të formës së prerë.

Si përfundim, në lidhje me trajtimin e rasteve të profilit të lartë nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme që nga publikimi i Raportit të Monitorimit të Drejtësisë 2024. Shumë prej këtyre rasteve, përfshirë ish-rastet e EULEX-it, ende vuajnë nga vonesa të zgjatura dhe janë larg gjykimit përfundimtar. Për më tepër, përdorimi i tepërt i rigjykimeve, jo vetëm një herë, por disa herë, kontribuon për një 'rrugëtim të pafund' nëpër sistemin e drejtësisë.

Rekomandime

- ✓ Në përputhje me Planin Strategjik të KGJK-së për Efikasitetin e trajtimit të rasteve të korrupsionit, Keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe Krimin të organizuar 2025-2027, EULEX-i e inkurajon KGJK-në që ta vazhdojë monitorimin sistematik të trajtimit të rasteve të profilit të lartë, me qëllim identifikimin dhe adresimin e shkaqeve të procedurave jashtëzakonisht të gjata, duke përfshirë rigjykimet e përsëritura.
- ✓ EULEX-i gjithashtu u bën thirrje kryetarëve të gjykatave, përfshirë atë të GJA-së, që të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që rastet të mos vonohen padrejtësisht.

2.2. Produktiviteti i seancave gjyqësore

Sfondi

Si pjesë e monitorimit të rasteve penale të përzgjedhura, prej vitit 2019, EULEX-i ka monitoruar *proporcionin* e seancave produktive në faza të ndryshme të procedurave gjyqësore, pasi të ketë filluar shqyrtimi kryesor. Seancat produktive lidhen drejtpërdrejt me të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, një e drejtë e garantuar sipas Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe të drejtën për dëmshpërblim për viktimat e veprave penale. Kur arsyetohet me arsye të bazuara mirë, për shembull kur është e nevojshme të mbliidhen prova të reja, shtyrja e një seance nuk ngre shqetësime të veçanta dhe mund të konsiderohet si një dukuri normale në administrimin e një rasti. Megjithatë, kur shtyrja e përsëritur e seancave mund të ishte shmangur në mënyrë të arsyeshme dhe ajo është pasojë e veprimeve ose mosveprimeve nga autoritetet, vonesa e shkaktuar është e panevojshme, çon në humbje të burimeve dhe mund ta dobësojë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Për qëllime të analizës statistikore në këtë raport, gjatë vlerësimit të produktivitetit të seancave gjyqësore, EULEX-i dallon tre kategori seancash: produktive, joproduktive dhe të anuluar. Një seancë konsiderohet produktive kur mbahet sipas planit dhe bëhet përparim drejt gjykit, për shembull, kur diskutohen provat materiale, të pandehurit, palët e dëmtuara ose dëshmitarët merren në pyetje ose mbahen fjalët hyrëse dhe përmbyllëse. Nga ana tjetër, një seancë është joproduktive kur ajo fillon, por shtyhet pa ndonjë përparim domethënës. Së fundmi, një seancë anulohet kur, megjithëse e planifikuar shpeshherë shumë kohë më përpara, ajo anulohet me një njoftim shumë të vonshëm (p.sh., vetëm një ditë ose edhe disa orë para seancës) bilës pa filluar fare.

Statistikat e paraqitura më poshtë i referohen seancave të planifikuara pas fillimit të shqyrtimit kryesor. Shpalljet e aktgjykimeve dhe seancat e procedurës paraprake nuk janë përfshirë në këto të dhëna.

Gjetjet


Në periudhën qershor 2024 - korrik 2025, EULEX-i monitoroi gjithsej 478 seanca, nga të cilat 132 (28%) u shtynë pa asnjë përparim. Në veçanti, 75 seanca, që përbëjnë 16% të totalit, ishin joproduktive, kurse 57 seanca, që përbëjnë 12% të totalit, u anuluan.

Duke i krahasuar këto shifra me ato të përfshira në Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë të publikuara në vitet 2021, respektivisht 2022 dhe 2024, nuk u shënua asnjë përmirësim real në produktivitetin e seancave gjyqësore, siç ilustron në paraqitjen e mëposhtme, pavarësisht miratimit të Planit Strategjik për Efikasitetin dhe priorizimin e rasteve brenda gjyqësorit 2022-2025 nga KGJK në vitin 2022¹. Sa për referencë, në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2021, *proporcioni* i seancave joproduktive në mesin e atyre të monitoruara nga EULEX-i ishte 30%, në raportin e vitit 2022 ishte 26%, ndërsa në raportin e fundit, të vitit 2024, përqindja e seancave joproduktive dhe të anuluar ishte 28%².

1 Plani Strategjik për Efikasitetin dhe priorizimin e rasteve brenda gjyqësorit 2022-2025, i miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 8 qershor 2022, është i disponueshëm në versionin shqip në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2022/06/KGJK_Plani_strategjik_per_permiresimin_qasjes_ne_drejttesi_2022_2025_lidhur_me_efikasitetin_dhe_prioritizimin_lendeve_brenda_sistemit_gjyqesor.pdf (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025). Dy nga objektivat kryesore të Planit Strategjik ishin rritja e produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e rasteve dhe forcimi i kapaciteteve të gjyqësorit për trajtimin e numrit të madh të rasteve që bien brenda kornizës së rasteve me përparësi të lartë, sipas neneve II.1 dhe II.2.


2 Para shtatorit 2022, EULEX-i nuk mbante shënime për numrin e seancave të anuluar, por vetëm për ato joproduktive. Prandaj, monitorimi u ndryshua pas kësaj date, duke përfshirë seancat e anuluar kur EULEX-i vërejti, përmes aktiviteteve monitoruese, një model të rritjes së seancave gjyqësore të anuluar.

Seancat pa përparim



Gjithashtu në këtë periudhë raportimi, dy arsyt kryesore për seancat joproductive ose të anuluar janë mungesa e të pandehurit ose kërkesa e tij/saj për ta shtyrë seancën pa ndonjë arsye të duhur (29 seanca, ose 22% nga totali i seancave joproductive/të anuluar), e ndjekur nga mungesa ose kërkesa e avokatëve për ta shtyrë seancën (22 seanca, ose 17%), kryesisht duke pretenduar se kishin nevojë për më shumë kohë për ta përgatitur rastin ose se ishin të sëmurë. Veçanërisht, disa seanca duhej të shtyheshin për shkak të mungesës së pjesëmarrësve të tjerë në gjykim: në veçanti, mungesa e palëve të dëmtuara, dëshmitarëve, ekspertëve ose përkthyesve të gjykatës shkaktoi shtyrjen e 19 seancave (14%), mungesa e anëtarëve të trupit gjykues çoi në shtyrjen e 14 seancave (11%), ndërsa mospjesëmarrja e prokurorëve në seanca shkaktoi shtyrje vetëm në tetë seanca (6%). Mos-përparimi në 40 seancat e mbetura (30%) u shkaktua nga çështje të ndryshme administrative (të tilla si vonesa në përkthimin e dokumenteve gjyqësore, avancimi në detyrë/pensionimi i anëtarëve të trupit gjykues, kërkesat për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues ose çështje të ndryshme teknike) dhe arsye tjera të paspecifikuara.

Arsyet për seancat joproductive/të anuluar



Nga gjithsej 478 seanca të monitoruara, 137 ishin për raste të profilin të lartë. Përqindja e seancave joproductive dhe të anuluar në këtë grup ishte 35% (48 seanca), e ngjashme me 34% të regjistruar në Raportin e fundit të Monitorimit të Drejtësisë. Prandaj, kjo përqindje vazhdon të mbetet e lartë, megjithëse rastet e profilin të lartë duhet të gjykojnë menjëherë për shkak të ashpërsisë së krimeve ose profilin të pandehurve, siç është theksuar më parë nga EULEX-i.

Për më tepër, një nga arsyet më të shpeshta për shtyrjen e seancave në këtë lloj rastesh mbeti mungesa e të pandehurit për shkak të sëmundjes. Megjithatë, EULEX-i vuri në dukje se në shumë situata gjendja shëndetësore nuk ishte verifikuar siç duhet nga trupi gjykues, dokumentet mjekësore ose ishin dorëzuar me vonesë ose nuk ishin dorëzuar fare. EULEX-i gjithashtu vërejti se, në disa raste, disa seanca ishin shtyrë për të njëjtën arsye përpara se gjykata të vendoste ta zbatonte ndonjë nga masat e disponueshme në Kodin e Procedurës Penale (KPP) për t'i sanksionuar palët që i vonojnë procedurat për shkak të mungesës së tyre të paarsyeshme³.

Për shembull, nga seancat e monitoruara nga EULEX-i gjatë periudhës raportuese, kishte shumë pak raste kur gjykatat zbatuan masa kundër palëve që shkaktuan vonesa të paarsyeshme, përkatësisht gjoha në shumën prej 500 eurosh të lëshuara ndaj avokatëve mbrojtës për mungesë ose urdhër-arreste të lëshuara ndaj të pandehurve për mungesë.

Si përfundim, gjatë periudhës së raportimit nuk është bërë ndonjë përparim domethënës drejt rritjes së *proporcionit* të seancave produktive, ku përqindja e seancave joproductive dhe të anuluar mbetet relativisht në të njëjtin nivel si në vitet e mëparshme. Përveç kësaj, gjykatat vazhdojnë të ngurrojnë në zbatimin e masave të disponueshme për t'i shmangur vonesat e panevojshme dhe për ta rritur efikasitetin e procedurave gjyqësore.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i u bën thirrje gjykatave që të verifikojnë, sa më mirë që të jetë e mundur, vërtetësinë e arsyeve të paraqitura për mungesën e palëve dhe i inkurajon ato që të refuzojnë ta pranojnë çfarëdo arsyetim për mungesë të pambështetur në prova me shkrim.
- ✓ Trupat gjykues duhet të marrin parasysh lëshimin e urdhrave të gjykatës për të siguruar që të pandehurit që mungojnë të sillen para gjykatës me shoqërim policor kur mungesa nuk mund të arsyetohet siç duhet dhe në kohën e duhur.
- ✓ Gjykatat inkurajohen t'i përdorin mjetet në dispozicion për t'i mbajtur prokurorët dhe avokatët mbrojtës përgjegjës për vonesat ose mungesat e paarsyeshme duke njoftuar e Kryeprokurorin prokurorisë së tyre dhe Odën e Avokatëve.
- ✓ KGJK-ja duhet të sigurojë që gjykatat t'i zbatojnë objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik për Efikasitetin dhe priorizimin e rasteve brenda gjyqësorit 2022-2025, siç është trajtimi në kohën e duhur i rasteve me përparësi të lartë dhe shmangia e vonesave të panevojshme procedurale në përgjithësi.

³ Për masat në dispozicion të gjykatave, shih Kodin e Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, nenet 65, 301, 302, 304, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

2.3. Mbikëqyrja gjyqësore në lloje të caktuara të privimit nga liria

Sfondi

EULEX-i monitoroi disa raste ku personat ishin privuar nga liria e tyre nga PK-ja, pa mbikëqyrje fillestare të dukshme ose të mjaftueshme prokuroriale dhe gjyqësore.

Sipas KPP të Kosovës, PK-ja gëzon një shkallë të caktuar autonomie fillestare nga autoritetet prokuroriale në lidhje me veprimet e tyre hetimore. Për shembull, policia mund të ndërmarrë hapa për të mbledhur prova nga vendi i ngjarjes, të ndjekë të dyshuarit e hasur në vendin e ngjarjes, të gjejë autorët e krimit, të parandalojë arratisjen e autorëve të krimit dhe të ndërmarrë hapa të tjerë fillestarë të cilët duhet të kryhen shpejt pasi të ketë ndodhur një krim i dyshuar⁴. Si pjesë e hapave të saj fillestarë në lidhje me hetimet penale, policia gjithashtu ka të drejtë të ndalojë shkurtime personat që janë hasur në vendin e ngjarjes për maksimum gjashtë orë me qëllim marrjen e emrit, adresës së tyre dhe informatave tjera relevante. Ky lloj privimi nga liria, i quajtur “e drejta e policisë për të ndaluar për një kohë të shkurtër” mund të përdoret vetëm kur nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të mbledhur informata⁵.

Këto veprime hetimore të kufizuara, fillestare dhe autonome duhet të kuptohen si të atilla që e mbulojnë periudhën menjëherë pas ndodhjes së një krimit dhe kanë të bëjnë me veprime që duhet të ndërmerren shpejt. Ndërsa ato formalisht nuk konsiderohen si veprime fillestare hetimore policore, policisë gjithashtu i lejohet të arrestojë personat e kapur në flagrancë duke kryer një vepër penale që ndiqet penalisht sipas *detyrës zyrtare*, apo të cilët ndiqen menjëherë pas kryerjes së veprës penale, pa urdhër gjykate ose autorizim të prokurorisë. Kjo sipas KPP-së quhet “arrestim i përkohshëm”⁶. Përveç këtyre dy formave të privimit nga liria, përkatësisht “arrestimit të përkohshëm” dhe “të drejtës së policisë për të ndaluar për një kohë të shkurtër”, KPP-ja përcakton se policia e privon një person nga liria vetëm nëse ekziston një urdhër arresti vendas ose ndërkombëtar ose kur arrestimi është i autorizuar nga prokuroria. Megjithatë, një arrestim i autorizuar nga prokuroria lejohet vetëm pasi prokuroria të ketë filluar tashmë hetimet, të cilat kërkojnë një “dyshim të arsyeshëm” se është kryer një vepër penale. Përveç kësaj, prokuroria duhet ta ketë krijuar “dyshimin e bazuar”⁷, i cili ka një prag edhe më të lartë se sa “dyshimi i arsyeshëm”⁸, dhe kushtet për paraburgim, të tilla si, *ndër të tjera*, rreziku i arratisjes ose rreziku i prishjes të provave⁹. Duhet theksuar se dispozita e “ndalimit të përkohshëm policor” gjashtë-orësh, siç rregullohet nga Ligji për Policinë, nuk është e rëndësishme në këtë kontekst, pasi rastet e përmendura në këtë seksion kanë të bëjnë me hetimet penale për të cilat mbizotëron Kodi i Procedurës Penale¹⁰.

4 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, nenet 70 deri në 78. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

5 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, Neni 73: E drejta e Policisë për ndalim të shkurtër, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

6 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, Neni 160: Arrestimi i përkohshëm dhe Ndalimi policor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

7 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, Neni 19, paragrafi 1.9: ‘*Dyshim i Bazuar - njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë ka më shumë gjasa që të ketë kryer veprën penale se sa që të mos e ketë kryer atë. Dyshimi i bazuar duhet të mbështetet në prova të artikulueshme*’, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

8 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, Neni 19 paragrafi 1.8: ‘*Dyshim i Arsyeshëm - njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë mund të kryejë ose mund të ketë kryer veprën penale. Se çfarë mund të konsiderohet si “e arsyeshme” do të varet nga të gjitha rrethanat*’, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>. Ajo që mund të konsiderohet si “e arsyeshme” do të varet nga të gjitha rrethanat’, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61759>.

9 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, Neni 162: Arrestimi dhe Ndalimi Gjatë Fazës së Hetimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

10 Ligji për Policinë, 04/L-076, 19 mars 2012, ndryshimi i fundit më 27 Dhjetor 2024, Neni 11, paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/>

Kodi i Procedurës Penale përcakton gjithashtu se policia duhet t'i raportojë prokurorisë për çdo hap fillestar të ndërmarrë sa më shpejt të jetë e mundur dhe se prokuroria dhe policia duhet të punojnë së bashku gjatë këtyre hapave fillestarë për të përcaktuar nëse ka vend për ndonjë procedurë penale në bazë të përcaktimit të “dyshimit të arsyeshëm”.

Gjetjet

EULEX-i ka vërejtur se në disa raste penale, personat ishin privuar nga liria nga policia deri në gjashtë orë për marrje të mëtejshme në pyetje, pa dijeninë paraprake të prokurorisë, sepse emrat e tyre shfaqeshin në një regjistër të veçantë të PK-së, i titulluar në nivel të brendshëm si ‘stop listë’. Ky regjistër është pjesë integrale e Sistemit Informativ të Policisë së Kosovës, një instrument i brendshëm i PK-së i cili rregullohet nga një Procedurë Standarde Operimi (PSO). Ky privim specifik i lirisë mund të thuhet se nuk mbulohet nga KPP-ja, pasi prokuroria duhet të informohet për çdo hap fillestar të ndërmarrë si pjesë e një hetimi penal, ndërsa ndalimi policor gjashtë-orësh nga Neni 73 i KPP-së mund të përdoret vetëm për të marrë informata nga personat e hasur në vendin e ngjarjes. Siç është shpjeguar nga drejtuesit e PK-së, ekziston një mirëkuptim se policia mund të ndalojë ligjërisht çdo person që ndodhet në këtë regjistër të PK-së me autorizimin e saj dhe ta mbajë atë person deri në gjashtë orë për marrje në pyetje, edhe pse kjo nuk mund të konsiderohet më si pjesë e kompetencave fillestare të policisë, të cilat mbulojnë vetëm periudhën menjëherë pas ndodhjes së veprës penale. Ndërsa kjo nuk është shqetësuese në rastet kur ekziston një urdhër arresti i lëshuar nga gjykata, ose kur arrestimi është autorizuar tashmë nga prokuroria, megjithatë ngre shqetësime kur personat në këtë regjistër nuk kërkohen bazuar në një urdhër arresti ose nëse kur arrestimi nuk është autorizuar nga prokuroria. Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Policinë nuk e përmendin privimin nga liria bazuar në këtë regjistër të PK-së dhe çdo privim nga liria duhet t'i përmbushë kriteret e parapa nga standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, veçanërisht kriterin e ligjshmërisë që përfshin sigurinë juridike dhe mungesën e arbitraritetit. Privimi nga liria që bazohet në një PSO të brendshme të PK-së, në dukje të parë (*prima facie*) nuk e përmbush kriterin e ligjshmërisë, i cili është përcaktuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) për Nenin 5 të KEDNJ-së.

Praktika ka treguar në disa raste se, kur privimi nga liria bazohej në këtë regjistër të PK-së, policia e përdori periudhën gjashtorëshe për ta informuar prokurorinë dhe të kërkojë autorizimin për arrestim. Në shumë prej këtyre rasteve, u vu re se kallëzim penal nuk ishte paraqitur ende dhe as nuk ishte hapur ndonjë hetim nga prokuroria, që do të thotë se ende nuk ishte krijuar asnjë “dyshim i arsyeshëm” nga prokuroria. Duhet ritheksuar se, në përpjethje me Kodin e Procedurës Penale, për të autorizuar një arrestim, prokurori së pari duhet të ketë krijuar një “dyshim të bazuar” dhe kushtet për paraburgim.

Kjo praktikë nënkupton që prokuroria vihet në një pozicion të vështirë për të vendosur në një afat shumë të shkurtër kohor (për shkak të ndalimit maksimal prej gjashtë orësh nga policia), në rastet për të cilat nuk kishte dijeni paraprake dhe shpesh pa asnjë informacion ose provë të marrë rishtazi. Konkretisht, në këto raste, prokuroria duhet të hapë një hetim në mënyrë retroaktive përmes një “vendimi për fillimin e hetimeve”, i cili mund të bëhet vetëm nëse ekziston “dyshimi i arsyeshëm”, dhe më pas ta autorizojë arrestimin, i cili mund të bëhet vetëm në bazë të një “dyshimi të bazuar” të vërtetuar dhe ekzistimit të kushteve për paraburgim. Megjithatë, u vu re se në shumicën e rasteve të monitoruara, prokuroria e pranoi kërkesën e policisë

ActDetail.aspx?ActID=2806&langid=2 : ‘Autorizimet dhe kufizimet e zyrarit policor gjatë ushtrimit të detyrave përkritazi me hetimet penale, në mënyrë të përgjithshme, janë përcaktuar në ligjet e tjera, duke i përfshirë, por jo duke u kufizuar, në Kodin e Procedurës Penale’. Neni 20, paragrafi 1: ‘Zyrtari policor është i autorizuar ta ndalojë përkohësisht personin atëherë kur është e nevojshme: 1.1. ta mbroj personin nga rreziku dhe dëmi, veçanërisht kur personi s’ka mundësi për t’u mbrojtur; apo 1.2. ta identifikoj personin ose t’i kufizoj lëvizjet e tij, siç autorizohet me ligj, kur personi është jo bashkëpunues ndaj masave më të lehta’.

për ta autorizuar arrestimin dhe më pas kërkoi paraburgimin 30-ditor si masë më e rëndë e sigurisë, e cila më pas edhe u pranua nga gjykata.

Në aspekt pozitiv, EULEX-i vëren se disa bashkëbisedues në sistemin e drejtësisë e kanë pranuar se kjo praktikë ngre shqetësime dhe se duhet të shqyrtohet me kujdes në raport me Kodin e Procedurës Penale dhe standardet përkatëse të drejtave të njeriut.

Rekomandime

- ✓ Me përjashtim të rasteve të përcaktuara posaçërisht në KPP që kanë të bëjnë me arrestimin e të dyshuarve, PK-së i rekomandohet që të shmanget ndërmarrja e veprimeve me iniciativë të vet ose pa udhëzim ose urdhër nga prokuroria, që t'i fusë personat në regjistrin përkatës të PK-së që synon privimin e tyre nga liria.
- ✓ EULEX-i i bën thirrje Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe PK-së që ta shqyrtojnë së bashku përputhshmërinë e praktikave aktuale dhe t'i japin udhëzime të qarta PK-së për të siguruar që veprimet e tyre të jenë plotësisht në përputhje me kriteret e KPP-së dhe standardet të zbatueshme të drejtave të njeriut.

2.4. Zbatimi i dënimeve plotësuese

Sfondi

Dënimet plotësuese synojnë forcimin e efektit të dënimeve kryesore (si atyre kryesore ashtu edhe atyre alternative) dhe mund të shqiptohen vetëm në lidhje me to¹¹. Neni 59¹² i Kodit Penal (KP) përcakton një listë prej tetë llojesh të ndryshme dënimesh plotësuese, duke përfshirë ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik (paragrafi 2.3) dhe ndalimin e ushtrimit të një profesioni, aktiviteti ose detyre (paragrafi 2.4). Nenet 62¹³ dhe 63¹⁴ i rregullojnë më tej këto dy dënime plotësuese. Në Kodin Penal të vitit 2019, u futën dispozita të reja në nenet 62 dhe 63, të cilat e bënë të detyrueshme shqiptimin e këtyre dy dënimeve plotësuese, *mes tjerash*, në rastet e korrupsionit.

Në Raportet e Monitorimit të Drejtësisë të viteve 2022 dhe 2024, EULEX-i vërejti mospërputhje dhe mungesë të praktikave të standardizuara në zbatimin e këtyre dy kategorive të dënimeve plotësuese, veçanërisht në aspektin e përgjegjësisë së Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në të gjitha gjykatat themelore, komunikimit me institucionet e mandatuara për ta

11 Sipas nenit 40 të Kodit Penal, dënimet kryesore janë 1) dënimi me burgim të përjetshëm, 2) dënimi me burgim dhe 3) dënimi me gjobë. Lista e dënimeve alternative, siç përcaktohet në nenin 46 të Kodit Penal, janë 1) dënimi me kusht; 2) gjysmë liria; dhe 3) urdhri për punë në dobi të përgjithshme.

12 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 59, paragrafi 2: 'Dënimet plotësuese janë: 2.1. heqja e të drejtës për t'u zgjedhur; 2.2. urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit; 2.3. ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik; 2.4. ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës; 2.5. ndalimi i drejtimit të automjetit; 2.6. marrja e lejes së vozitjes; 2.7. urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe 2.8. dëbimi i të huajit nga Kosova', <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

13 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 62, paragrafi 3: 'Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas mbajtjes së dënitit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII (Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare) të këtij Kodi'. Neni 62, paragrafi 4: 'Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo në shërbime publike prej një (1) deri në pesë (5) vjet, nëse i njëjti është dënuar për dhunë në familje, sipas nenit 248 të këtij Kodi', <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

14 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 63, paragrafi 4: 'Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e profesionit, aktivitetit të pavarur, të detyrës menaxhuese apo administrative prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat penale në Kapitullin XXXIII (Veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare) të këtij Kodi', <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

mbikëqyrë ekzekutimin (Ministria e Administratës Publike¹⁵ dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale¹⁶) siç parashihet nga Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP)¹⁷, regjistrimit në Sistemin Qendror të Regjistrimit Penal dhe konvertimit të dënimeve me burgim në gjoba.

Gjetjet

Gjatë periudhës raportuese, EULEX-i gjeti se zbatimi i sanksioneve penale vazhdon të mos trajtohet në mënyrë të vazhdueshme si përgjegjësi e Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale në shumicën e gjykatave themelore. Kjo detyrë shpesh është e shpërndarë midis zyrave ose stafit të ndryshëm, gjë që nuk kontribuon në efikasitet ose llogaridhënie. Siç është theksuar tashmë në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2021, është e nevojshme të përcaktohen më mirë roli dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për zbatimin e sanksioneve penale përfundimtare, duke përfshirë dënimet plotësuese.

Në aspekt pozitiv, EULEX-i vërejti se disa gjykata filluan ta zbatojnë njërin nga dy dispozitat specifike në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Kriminale (LESK) duke ia dorëzuar aktgjykimet përkatëse Ministrisë së Punëve të Brendshme nga vjeshta e vitit 2024 e tutje. Megjithatë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ende nuk ka marrë ndonjë aktgjykim nga gjykatat për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve plotësuese. EULEX-i vuri në dukje se jo i gjithë stafi në gjykatat themelore përgjegjëse për zbatimin e këtyre dënimeve plotësuese është i informuar mjaftueshëm rreth këtyre dispozitave ligjore. Gjithashtu, EULEX-i vlerësoi përsëri se në disa raste, dënimet plotësuese nuk ishin regjistruar siç duhet ose ishin regjistruar në mënyrë të pasaktë në Sistemin Qendror të Regjistrimit Penal, pavarësisht përpjekjeve të bëra në këtë drejtim në nivel qendror për ta rritur kontrollin e cilësisë së të dhënave.

Ashtu si në Raportet e Monitorimit të Drejtësisë të viteve 2022 dhe 2024, EULEX-i mbledhi një mostër rastesh për të vlerësuar nëse dënimet plotësuese, të detyrueshme për dënimet për korrupsion në rast të dënimit me burgim, ishin shqiptuar vërtet siç kërkohet me ligj. EULEX-i gjithashtu shqyrtoi rastet e gjobave ose dënimeve me kusht pas indikacioneve të GJS në Udhëzimet Specifike të saj të vitit 2021 për veprat penale të korrupsionit, të cilat përcaktojnë se kur shqiptohet një gjobë ose dënim me kusht, gjykata duhet ta marrë parasysh ndalimin sipas paragrafit 2 të nenit 62 të Kodit Penal¹⁸.

Në veçanti, EULEX-i vlerësoi rastet sipas veprave penale të mëposhtme:

- *Keqpërdorimi i pozitës zyrtare*

Në bazë të vlerësimit të 28 aktgjykimeve fajësuese sipas Nenit 414 të KP-së, EULEX-i identifikoi se dënimet plotësuese u shqiptuan në 17 aktgjykime. Në dy aktgjykime të tjera, dënimi me burgim u pezullua dhe në gjashtë aktgjykime të tjera dënimi me burgim u konvertua në gjobë, kurse në këto tetë aktgjykime nuk u shqiptuan dënime plotësuese. Për më tepër, ishin tre aktgjykime ku ekzistonte detyrimi për ta shqiptuar një dënim plotësues, i cili megjithatë nuk u shqiptua nga gjykata, në shkelje të ligjit. Në njërin prej 17 aktgjykimeve të lartpërmendura me dënime plotësuese, burgimi ishte pezulluar, por gjykata vendosi ligjërisht të përcaktonte edhe një dënim plotësues. Nga 17 rastet me dënime plotësuese, në dy prej tyre kishte edhe konvertim të burgimit në gjobë,

¹⁵ Ministria e Administratës Publike u bashkua me Ministrinë e Punëve të Brendshme në vitin 2020.

¹⁶ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tani quhet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

¹⁷ Emri i ligjit u ndryshua nga LESP në LESK (Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale). Neni 161 i LESP nga gushti i vitit 2022 është neni 156 i LESK.

¹⁸ Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 62, paragrafi 2: "Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht", <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

por dënimi plotësues mbeti në fuqi. Është e rëndësishme të theksohet se diapazoni i burgimit për këtë vepër penale është prej një deri në tetë vjet. Kjo do të thotë se në pesë aktgjykime është shqiptuar dënimi minimal, kurse në gjashtë aktgjykime tjera edhe nën dënimin minimal. Duhet të theksohet se burgimi gjashtëmujor është periudha maksimale për të cilën lejohet konvertimi në gjobë. Siç u tha më sipër, në tetë raste dënimet me burgim u konvertuan më vonë në gjoba, me anë të së cilave është shmangur aplikimi i detyrueshëm i një dënimi plotësues për gjashtë prej tyre.

- Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik

Bazuar në vlerësimin e katër aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 415 të Kodit Penal, EULEX-i vlerësoi se në një aktgjykim dënimi me burgim ishte pezulluar dhe nuk ishte shqiptuar asnjë dënim plotësues. Në dy aktgjykime të tjera, dënimi me burgim u konvertua në gjobë, megjithatë kjo nuk e pengoi gjykatën ta shqiptonte një dënim plotësues. Në një rast të katërt, dënimi me burgim përfshinte një dënim plotësues.

- Konflikti i interesit

Bazuar në vlerësimin e një aktgjykimi fajësues sipas nenit 417 të Kodit Penal, në një dënim me kusht prej një viti burgim nuk është shqiptuar dënim plotësues.

- Përvetësimi në detyrë

Në një aktgjykim fajësues sipas nenit 418 të Kodit të Procedurës Penale, në një aktgjykim me dënim me tre vjet burgim është shqiptuar një dënim plotësues në përputhje me ligjin.

- Mashtrimi në detyrë

Bazuar në vlerësimin e një aktgjykimi fajësues sipas nenit 419 të KP-së, një dënim me burgim prej gjashtë muajsh u konvertua në gjobë pa ndonjë dënim plotësues.

- Marrja e ryshfetit

Bazuar në vlerësimin e katër aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 421 të KP-së, gjykata shqiptoi katër dënime plotësuese në rastet me dënim me burgim.

- Ushtrimi i ndikimit

Bazuar në vlerësimin e dy aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 424 të Kodit Penal, në një rast ku i pandehuri ishte dënuar me tetë muaj burgim nuk u shqiptua dënimi plotësues, ndërsa shqiptimi i një dënimi plotësues do të kishte qenë i detyrueshëm në këtë rast.

- Falsifikimi i dokumentit zyrtar

Bazuar në vlerësimin e katër aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 427 të Kodit Penal, në një rast ku i pandehuri ishte dënuar me burgim për një vit e gjashtë muaj nuk u shqiptua dënimi plotësues, për të cilin kjo ishte e detyrueshme. Në rastin e dytë, që kishte të bënte me një dënim me kusht prej një viti burgim, dhe në rastin e tretë, ku një burgim gjashtëmujor u zëvendësua me gjobë, nuk u shqiptuan dënime plotësuese. Në rastin e katërt, ku një burgim gjashtëmujor u konvertua në gjobë, gjykata themelore e shqiptoi një dënim plotësues.

- Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare

Bazuar në vlerësimin e 16 aktgjykimeve fajësuese sipas nenit 430 të Kodit Penal, vetëm në një aktgjykim u shqiptua dënimi plotësues (së bashku me gjobën dhe burgimin me kusht prej katër muajsh), ndërsa në tre aktgjykime u shqiptua vetëm një gjobë si dënim. Në 12 aktgjykime, dënimi me burgim u pezullua (pesë raste) ose u konvertua në gjobë (shtatë raste të tjera), pa u nënkuptuar asnjë dënim plotësues. Dënime minimale me burgim janë shqiptuar në katër raste kurse dënime nën minimum në katër të tjera, nga të cilat tre u pezulluan dhe pesë prej tyre u konvertuan në gjoba, duke e shmangur kështu aplikimin e detyrueshëm të një dënimi plotësues.

Si përfundim, EULEX vlerësoi se gjetjet e Raportit të Monitorimit të Drejtësisë 2024 në masë të konsiderueshme janë ende të vlefshme. Mospërputhje të ngjashme dhe mungesë praktikash të standardizuara në aplikimin dhe zbatimin e dy kategorive të vlerësuara të dënimeve plotësuese kanë vazhduar edhe në vitin 2025. Pavarësisht disa përmirësimeve të vërejtura në zbatim me një rritje të aplikimit të dënimeve plotësuese të detyrueshme, më shumë përpjekje për kontrollimin e cilësisë së të dhënave të Sistemit Qendror të Regjistrat Penal dhe rritje të njoftimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për aktgjykimet nga disa gjykata themelore, rekomandimet e mëposhtme vazhdojnë të jenë të aplikueshme. EULEX-i identifikoi përsëri aktgjykime për rastet ku dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik është dashur të shqiptohet në përputhje me nenin 62, paragrafi 3, të Kodit Penal. Në fund, aktualisht nuk ekziston asnjë mekanizëm monitorimi për të vlerësuar nëse gjyqtarët i aplikojnë dënimet plotësuese të detyrueshme në rastet që lidhen me korrupsionin.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i i rekomandon KGJK-së që të sigurojë se ekziston një sistem i unifikuar për zbatimin e dënimeve plotësuese. Për këtë qëllim, KGJK-ja duhet t'i sqarojë të gjitha aspektet përkatëse përmes akteve nënligjore, në të cilat specifikohen qartë përgjegjësitë e secilit aktor.
- ✓ KGJK-së i këshillohet që ta krijojë një sistem të automatizuar të mbledhjes së të dhënave për dënimet plotësuese dhe zbatimin e tyre përmes SIML-së, i cili i përmban të gjitha informatat përkatëse, siç janë data përkatëse e njoftimit të dënimit plotësues, emrat e institucioneve të cilave u është komunikuar dhe i zyrtarit që e ka lëshuar atë.
- ✓ KGJK-ja duhet të sigurojë që Sistemi Qendror i Regjistrat Penal të përmbajë të dhëna të plota në lidhje me dënimet plotësuese. Për ta lehtësuar këtë, EULEX-i rekomandon krijimin e një fushe të veçantë të dhënave për të përfshirë informatat në lidhje me ekzistimin e dënimit plotësues, natyrën e tij dhe kohëzgjatjen specifike.
- ✓ KGJK-ja duhet t'ua kujtojë gjykatave që t'ua komunikojnë me kohë dënimet plotësuese institucioneve përkatëse në përputhje me nenet 160 dhe 161 të LESP-së (tani nenet 155 dhe 156 të LESK-së të ri) dhe duhet të ndjekin rregullisht zbatimin efektiv të neneve 62 dhe 63 të KP-së.
- ✓ EULEX-i inkurajon KGJK-në që ta krijojë një mekanizëm monitorimi për të vlerësuar nëse gjyqtarët i aplikojnë dënimet plotësuese të detyrueshme në përputhje me nenet 62 dhe 63 të KP-së dhe të përcaktojë nëse në rastet e korrupsionit, gjykatat kanë tendencë t'i konvertojnë dënimet me burgim në gjoba, duke çuar jo vetëm në shmangien e dënimeve me burgim, por edhe në shmangien e aplikimit të detyrueshëm të dënimeve plotësuese.

2.5. Planifikimi dhe caktimi i seancave të shumëfishta në shqyrtimet gjyqësore

Sfondi

Në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2022, EULEX-i e trajtoi praktikën e zgjatjes së tepërt të procedurave gjyqësore dhe ndikimin e saj në të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, siç garantohet me Nenin 6 të KEDNJ-së. Meqenëse planifikimi dhe caktimi i seancave gjyqësore ndikojnë ndjeshëm në ecurinë e procedurave gjyqësore, EULEX-i rekomandoi që gjykatat duhet ta planifikojnë të gjithë shqyrtimin gjyqësor në një fazë të hershme të procedurës, të caktojnë seancat pasuese brenda një muaji sa herë që është e mundur dhe të planifikojnë disa seanca në ditë të njëpasnjëshme, veçanërisht në gjykimet me një numër të madh të pandehurve.

Përfundimi në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2024 ishte se si KGJK-ja ashtu edhe Departamenti Special në GJTH të Prishtinës kishin krijuar sensibilizimin për rëndësinë e menaxhimit të rasteve dhe për praktikën e planifikimit të seancave të ardhshme përmes planeve të tyre strategjike dhe planeve të punës. Ndërsa u vunë re disa përmirësime në disa gjykime që përfshinin një numër të madh të pandehurve, në përgjithësi, nuk është vërejtur ndonjë përmirësim në lidhje me caktimin e seancave pasuese brenda një muaji ose caktimin e seancave të njëpasnjëshme.

Për Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2025, EULEX-i e ka monitoruar caktimin e seancave gjyqësore në rastet penale të monitoruara gjatë periudhës nga shtatori 2024 deri në qershor 2025. Këtu nuk përfshihen seancat për paraburgimin dhe sehqyrtime fillestare, pasi që në këto seanca nuk bëhet planifikim i gjykimit. Për më tepër, kjo nuk i përfshin gjykimet ku është mbajtur vetëm një seancë dhe nuk është caktuar asnjë seancë e re. Së fundmi, seancat e anuluar dhe joproduktive llogariten si seanca të planifikuara. Metodologjia për këtë raport ndryshon pak nga ajo e përdorur në Raportet e mëparshme të Monitorimit të Drejtësisë. Lidhur me caktimin e seancave brenda një muaji, në këtë raport monitorimi përqendrohet në periudhën midis dy seancave, jo në kohën nga kur është caktuar seanca. Arsytet për këtë janë se praktika e caktimit të seancave të shumëfishta është bërë më e zakonshme, blloku i seancave shpesh përbëhet nga më shumë se dy seanca dhe seancat nuk janë domosdoshmërisht në ditë të njëpasnjëshme. Prandaj, seancat kryesisht nuk janë më shumë se një muaj larg njëra-tjetrës. Dallimi tjetër në metodologji është se në këtë raport, llogaritet edhe numri i gjykimeve ku gjykata, në një ose më shumë raste, ka caktuar më shumë se një seancë në të njëjtën kohë. Kjo mënyrë e monitorimit jep një tregues për atë se sa e zakonshme është të caktohen seanca të shumëfishta në rastet e monitoruara nga EULEX-i.

Gjetjet

Gjatë periudhës së monitorimit të lartpërmendur, EULEX-i numëroi 395 seanca të planifikuara në 64 raste të ndryshme. U vu re se gjykata caktoi seanca të shumëfishta një herë ose disa herë në 37 raste. Në pjesën tjetër të rasteve (27), pas çdo seance ishte caktuar vetëm një seancë e ardhshme. Në Raportin e mëparshëm të Monitorimit të Drejtësisë, EULEX-i përcaktoi se gjykatat caktuan dy ose më shumë seanca në 40% të seancave ku ishin caktuar seanca pasuese. Për shkak të praktikës në rritje të caktimit të më shumë se dy seancave në të njëjtën kohë, për të caktuar një numër më të madh seancash përdoren më pak seanca dëgjimore. Për shembull, në *Rastin Kokaina*, ku janë gjashtë të pandehur, gjykata deri më tani i ka caktuar katër blloqe me pesë, përkatësisht tre, pesë dhe dy seanca, gjithsej 17 seanca nga tetori 2024. Në rastin *Vrasja e trefishtë në Gjilan*, rast ky me tre të pandehur, janë pesë blloqe me nga pesë ose katër seanca në secilin bllok, gjithsej 20 seanca të planifikuara nga shtatori 2024. Në rastin *Brezovica II*, një rast i ndërlikuar me 12 të pandehur, ku gjykimi filloi në nëntor 2024, gjykata ka planifikuar tashmë 25 seanca në katër blloqe me nga katër, përkatësisht pesë, shtatë dhe nëntë seanca. Megjithatë, duhet përmendur se rasti *Brezovica II* i pati disa seanca të anuluar. Për shembull, një bllok i tërë me shtatë seanca u anulua.

Nga monitorimi, vërehet gjithashtu se nga 395 seancat e planifikuara, 58 seanca ishin me më shumë se një muaj diferencë, 26 seanca me më shumë se dy muaj diferencë dhe shtatë seanca me më shumë se tre muaj diferencë. Në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë 2024, u vu re se në 44% të rasteve, seancat pasuese u caktuan brenda një muaji, 45% brenda dy muajve dhe 11% brenda tre muajve ose më shumë. Edhe nëse metodologjia është paksa e ndryshme, në periudhën e fundit të monitorimit, seancat u caktuan rregullisht brenda një muaji nga njëra-tjetra, me vetëm rreth 15% të seancave të planifikuara me më shumë se një muaj diferencë dhe më pak se 7% me më shumë se dy muaj diferencë.

Duke i krahasuar të dhënat, praktika e caktimit të më shumë se një seance në të ardhmen, dhe madje edhe më shumë se dy seancave, është rritur ndjeshëm, veçanërisht në rastet komplekse dhe rastet me shumë të pandehur. Për më tepër, në shumicën dërmuese të gjykimeve, nuk ka më shumë se një muaj midis dy seancave, duke treguar një zhvillim pozitiv në planifikimin e gjykimeve, në përputhje me rekomandimet e mëparshme të EULEX-it.

Duhet theksuar se Plani i Punës për vitin 2025 i Departamentit Special të GJTH të Prishtinës¹⁹ (Plani i Punës) thekson se Departamenti Special do të vazhdojë me seanca të njëpasnjëshme për rastet e identifikuar, duke theksuar se kjo mbetet një prioritet për planin e punës për vitin 2025, ashtu siç ishte edhe për vitin e mëparshëm. Duke marrë parasysh se shumë nga gjykimet e monitoruara nga EULEX-i trajtohen nga Departamenti Special i GJTH të Prishtinës, vlen supozimi që praktika e inkurajuar nga Departamenti Special ka kontribuar në zhvillimin pozitiv të vërejtur në lidhje me caktimin e seancave.

Megjithatë, caktimi i seancave vazhdon të planifikohet gjatë gjykimit dhe pas seancës gjyqësore, e jo në fillim të procedurave gjyqësore. Në fakt, në Planin e Punës të lartpërmendur theksohet gjithashtu caktimi i një takimi përgatitor dhe një seance dëgjimore statutoire për ta planifikuar ecurinë e rastit dhe për të përcaktuar (ndër të tjera) *“orarin e punës (orari dhe numri i seancave gjyqësore të nevojshme për rastin konkret)”*. Për më tepër, thuhet se trupi gjykues *“identifikon ditët e nevojshme për seanca të njëpasnjëshme për rastin konkret dhe i cakton datat e seancave të njëpasnjëshme. Ai i informon palët për seancat e njëpasnjëshme dhe aktivitetet që do të ndërmerren në këto seanca, duke përfshirë monitorimin e zbatimit të seancave të njëpasnjëshme dhe zbatimin e aktiviteteve të planifikuara”*. Kjo është në përputhje me rekomandimet e EULEX-it nga Raporti i Monitorimit të Drejtësisë 2022.

Në situatë ideale, të gjitha seancat e gjykimit duhet të caktohen në ditë të njëpasnjëshme në një bllok. Kjo do të siguronte që gjykimet të ishin koncize dhe efektive. Palët profesionale do të përdornin më pak kohë për përgatitje për secilën seancë dhe cilësia e vendimit do të përfitonte. Megjithatë, Kodi i Procedurës Penale përcakton një afat për fillimin e shqyrtimit gjyqësor (brenda një muaji pasi të konfirmohet aktakuza)²⁰ dhe kjo, në kombinim me praktikën e caktimit të seancave deri më tani, mund të çojë në vështirësi për mbledhjen e prokurorëve dhe avokatëve mbrojtës brenda një periudhe të shkurtër kohore për ta zhvilluar një gjykim të plotë në ditë të njëpasnjëshme. Nga ana tjetër, zhvillimet pozitive të përshkruara më sipër, në kombinim me planifikimin e duhur të gjykimeve të theksuara në Planin e Punës, mund të hapin mundësinë e një trajtimi më të strukturuar dhe efektiv të gjykimeve.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i i inkurajon gjykatat që të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të planifikuar disa seanca në ditë të njëpasnjëshme sa herë që është e mundur, pasi kjo është dëshmuar se e rrit efikasitetin në zhvillimin e gjykimeve.
- ✓ Gjykatave u rekomandohet ta miratojnë një plan për ta caktuar të gjithë shqyrtimin gjyqësor në një fazë të hershme të procedurës, siç parashikohet në Planin e Punës për vitin 2025 të Departamentit Special të GJTH të Prishtinës.
- ✓ EULEX-i e këshillon KGJK-në që ta marrë parasysh aftësinë e gjykatave për t'i planifikuar dhe caktuar seancat gjyqësore si një tregues efikasiteti.

¹⁹ Plani i Punës së Departamentit Special në GJTH të Prishtinës për vitin 2025 (pritet të miratohet nga KGJK).

²⁰ Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, Neni 280 dhe Neni 249, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>.

2.6. Kohëzgjatja e marrjes së vendimeve me shkrim nga gjykatat themelore

Sfondi

Neni 6 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme. Kjo e drejtë njihet gjithashtu në mënyrë të qartë nga Kushtetuta e Kosovës sipas Nenit 31. Për t'i dhënë fuqi kësaj të drejte, Kodi i Procedurës Penale përcakton afate specifike kohore për t'i përfunduar fazat e ndryshme të procedurës dhe afate kohore për palët ose gjykatën për të kryer veprime specifike²¹.

Lidhur me aktgjykimin, Neni 368 i KPP-së përcakton se ai duhet të hartohet me shkrim brenda 15 ditëve nga shpallja e tij, nëse i pandehuri është në paraburgim ose nëse është caktuar masa e paraburgimit, ndërsa në të gjitha rastet e tjera duhet të hartohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Si përjashtim, kur një rast është kompleks, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund t'i kërkojë kryetarit të gjykatës ta zgjasë afatin deri në 60 ditë.

Gjetjet

Nga korriku 2023 deri në prill 2025, EULEX-i llogariti kohën e kaluar midis shpalljes me gojë të aktgjykimit deri në dorëzimin me shkrim në 32 raste penale²². Nga këto raste, gjysma konsiderohen raste komplekse dhe gjysma raste jo të ndërlikuara, sipas nenit 19 të KPP-së. Në pesë raste, të pandehurit mbetën në paraburgim pas shpalljes.

Në rreth gjysmën (17) nga të gjitha rastet e monitoruara, aktgjykimi nuk u dorëzua brenda afatit të përcaktuar nga KPP-ja. Në rastet që konsiderohen komplekse, gjysma e aktgjykimeve u vonuan, dhe në rastet që nuk konsiderohen komplekse, më shumë se gjysma (nëntë) e aktgjykimeve u vonuan. Koha mesatare e vonesës ishte 36 ditë në rastet jo-komplekse dhe 25 në rastet komplekse. Në disa raste, vonesat ishin të konsiderueshme. Në një rast kompleks, për shembull, aktgjykimi u vonua me 88 ditë, kurse në një rast jo-kompleks, 131 ditë. Në këto raste specifike, i pandehuri/të pandehurit nuk qëndruan në paraburgim pas shpalljes së aktgjykimit. Vlen të përmendet se në rastin *Autostrada e Shkupit*, i cili është një rast i profilit të lartë, aktgjykimi u hartua brenda 49 ditëve nga shpallja, duke treguar përkushtim të plotë për ta respektuar afatin qoftë edhe në një rast kompleks si ky.

Në dy raste komplekse, i pandehuri/të pandehurit mbetën në paraburgim dhe aktgjykimet u dorëzuan brenda 53, përkatësisht 58 ditëve, prandaj nuk u vonuan. Në tre raste jo të ndërlikuara, i pandehuri/të pandehurit mbetën në paraburgim, kurse, derisa në një rast aktgjykimi nuk u vonua, në dy të tjerat aktgjykimi u vonua për 45, përkatësisht 14 ditë. Duke pasur parasysh se afati kohor për aktgjykimin me shkrim është më i shkurtër në rastet me paraburgim, atyre duhet t'u jepet përparësi.

Nga informacioni i dhënë EULEX-it nga gjyqtarët e gjykatave themelore, mund të konkludohet se kur një afat i zgjatur konsiderohet i arsyeshëm nga kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari kërkon një zgjatje nga kryetari i gjykatës. Nëse kryetari i gjykatës pajtohet, gjë që ndodh në të shumtën e rasteve, siç përcaktohet nga KPP-ja, kryetari i gjykatës e merr vendimin, i cili më pas dokumentohet në dosjen e rastit. Sipas gjyqtarëve, palët nuk informohen për vendimin, kështu që ata nuk janë në dijeni nëse aktgjykimi do të jepet brenda 15, 30 apo 60 ditëve, apo nëse do të ketë një vonesë më të gjatë. Duke e pasur parasysh rëndësinë e një aktgjykimi penal,

21 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

22 Nga 32 raste, 23 raste janë nga Gjykata Themelore e Prishtinës, tre raste janë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës, dy raste janë nga Gjykata Themelore e Gjakovës, dy raste janë nga Gjykata Themelore e Ferizajt dhe nga një rast nga Gjykata Themelore e Prizrenit dhe Gjykata Themelore e Pejës.

veçanërisht për të pandehurin dhe palën e dëmtuar, afati kohor brenda të cilit do të jepet dënimi duhet t'u komunikohet në mënyrë transparente të gjitha palëve të përfshira. Siç është shpjeguar nga gjyqtarët, vonesat shpesh vijnë për shkak të mungesës së kohës, pasi ata janë të zënë me seanca pothuajse çdo ditë, dhe se ata mund ta hartojnë aktgjykimin vetëm pas orarit të punës.

Gjetjet e EULEX-it tregojnë se gjykatat themelore, në shumë raste, nuk i përmbahen afateve kohore të përcaktuara nga KPP-ja. Ndërsa hartimi i aktgjykimeve është shpesh një detyrë komplekse dhe që kërkon shumë kohë, si dhe gjyqtarëve shpesh u mungon koha për të punuar në to, është shumë e rëndësishme që gjykatat të veprojnë brenda kornizës së ligjit. Palët, veçanërisht të pandehurit, nuk duhet të presin për një periudhë të pacaktuar për ta marrë aktgjykimin, edhe nëse janë në dijeni të rezultatit të gjykimit nga shpallja e atij aktgjykimi. Mosrespektimi i afatit nga gjykatat mund të ndikojë negativisht në besimin te gjyqësori. Në fund të fundit, një vonesë në dorëzimin e aktgjykimit me shkrim mund të kontribuojë duke ndikuar negativisht në kohëzgjatjen e arsyeshme të procedurave dhe madje të çojë në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë²³, veçanërisht pasi vonesa ndikon në kohën kur mund të paraqitet një ankesë e mundshme ndaj aktgjykimit²⁴.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i u bën thirrje gjyqtarëve të gjykatave themelore që t'i finalizojnë aktgjykimet me shkrim brenda afatit ligjor, duke i dhënë përparësi veçanërisht rasteve kur i pandehuri/ të pandehurit mbeten në paraburgim.
- ✓ Për gjyqtarët e gjykatave themelore, është e rëndësishme të ndahet më shumë kohë jashtë seancave për t'i hartuar aktgjykimet brenda orarit të punës.
- ✓ EULEX-i rekomandon fuqimisht që kryetarët e gjykatave t'ua komunikojnë të gjitha palëve të përfshira vendimet për zgjatjen e afateve për dorëzimin e aktgjykimeve me shkrim në përputhje me nenin 368 të KPP-së.

2.7. Vazhdimi i ushtrimit të avokatisë nga avokatët e paditur ose të dënuar

Sfondi

Avokatët luajnë një rol themelor në zbatimin e sundimit të ligjit, sigurimin e qasjes në drejtësi dhe sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Për ta përmbushur këtë rol, ata duhet të veprojnë me integritet, pavarësi dhe në interesin më të mirë të drejtësisë²⁵.

Në Kosovë, ushtrimi i avokatisë rregullohet nga Ligji për Avokatinë, i cili përcakton kushtet për pezullimin, ndërprerjen dhe humbjen e së drejtës për ta ushtruar avokatinë²⁶. Sipas këtij ligji,

23 GJEDNJ, *B kundër Austrisë*, 28 mars 1990, paragrafi 52.

24 Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, periudha për të cilën zbatohet Neni 6 mbulon të gjithë procedurën, duke përfshirë procedurat e apelit, shih *König kundër Gjermanisë*, 28 qershor 1978, paragrafi 98.

25 Standardet e përcaktuara në, për shembull: Parimet e Përgjithshme për Profesionalistët Ligjorë, të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve më 20 shtator 2006, <https://www.ibanet.org/MediaHandler?id=E067863F-8F42-41D8-9F48-D813F25F793C>; Parimet Bazë mbi Rolin e Avokatëve, të miratuara nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kryerësve të Veprave Penale, Havana, Kubë, 27 gusht deri më 7 shtator 1990, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/basic-principles-role-lawyers>; ose Rekomandimi Nr. R (2000) 21 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare mbi lirinë e ushtrimit të profesionit të avokatit, i miratuar nga Komiteti i Ministrave më 25 tetor 2000 në takimin e 727-të të Zëvendësministrave, <https://www.icj.org/wp-content/uploads/2014/10/CoE-rec200021-freedom-exercise-profession-lawyer.pdf> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

26 Ligji nr. 04/L-193 për Avokatinë, 31 maj 2013, neni 37, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8673&langid=2>: 'Nëse ushtrimi i avokatisë është ndërprerë për shkak se kundër avokatit është në zhvillim e sipër procedura disiplinore, kohëzgjatja e ndërprerjes së ushtrimit të avokatisë llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar, sipas të cilës iu ka ndërprerë e drejta e ushtrimit të avokatisë. (...)'. Neni 38: 'Ushtrimi i avokatisë ndërpritet, nëse: 1.1. kundër avokatit është iniciuar procedurë penale për veprën penale, e cila e bën të padenjë për ushtrimin e avokatisë; 1.2. kundër avokatit është iniciuar procedurë disiplinore për shkak të shkeljes

një avokat mund të pezullohet nëse rrethanat e një rasti në të cilën është i përfshirë avokati çojnë në fillimin e procedurave disiplinore, por që nuk janë aq të rënda sa të shkaktojnë ndërprerjen e ushtimit të avokatisë. Në të kundërtën, nëse veprat penale për të cilat akuzohet avokati e bëjnë avokatin të padenjë për ta ushtruar avokatinë, apo nëse avokati dënohet për ato vepra penale, e drejta për ta ushtruar avokatinë i ndërpritet.

Ekziston një dallim kyç midis aktakuzës (akuza formale) dhe dënimit (një konstatim fajësie). Aktakuza nuk barazohet me fajësinë dhe i nënshtrohet prezumimit të pafajësisë sipas Nenit 6, paragrafi 2, të KEDNJ-së. Prandaj, pezullimi automatik ose heqja e licencës bazuar vetëm në aktakuzën në përgjithësi konsiderohet jo proporcionale dhe potencialisht e paligjshme, por një pezullim i përkohshëm mund të jetë i lejueshëm në raste të jashtëzakonshme kur është në rrezik integriteti i profesionit ose besimi publik. Për dallim nga kjo, dënimet penale, veçanërisht ato që përfshijnë keqpërdorim të pozitës/autoritetit, korrupsion, pengim të drejtësisë ose dhunë, zakonisht kërkojnë sanksione disiplinore, duke përfshirë heqjen e licencës, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së²⁷.

Gjetjet

EULEX-i identifikoi disa raste gjatë procedurave të shqyrtimeve gjyqësore ku avokatët, pavarësisht se ishin subjekt i procedurave penale në proces ose ishin dënuar, megjithëse jo me vendim të formës së prerë, vazhdonin të ofronin përfaqësim ligjor për të pandehurit. Në disa raste, akuzat penale kundër këtyre avokatëve lidheshin drejtpërdrejt me sjelljen e tyre profesionale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ofrimin e ndihmës për autorët e krimit pas kryerjes së ndonjë veprë penale²⁸, pengimin e provave ose procedurave zyrtare²⁹ dhe ushtrimin e ndikimit³⁰.

Për shembull, EULEX-i monitoroi një seancë në të cilën një avokat mbrojtës, i cili vetë ishte i pandehur në një rast gjyqësor në proces për abuzim seksual, u desh të kërkonte shtyrjen e seancës sepse duhej të ishte i pranishëm në seancën ndaj tij në cilësinë e të pandehurit. Në një rast tjetër të profilit të lartë të monitoruar nga EULEX-i, njëri nga avokatët mbrojtës ishte vetë i akuzuar dhe po i nënshtrohej procedurave gjyqësore për korrupsion, ndërsa në një rast tjetër të profilit të lartë, njëri nga avokatët mbrojtës ishte arrestuar me akuza që lidheshin me dhënien e ndihmës autorëve të krimit pas kryerjes së veprës penale, pengimin e provave ose procedurave zyrtare dhe ushtrimin e ndikimit. Disa ditë më vonë, i njëjti avokat ishte i pranishëm në sallën e gjyqit në cilësinë e avokatit mbrojtës, megjithëse arrestimi i tij dhe hetimet në proces kundër tij ishin bërë tashmë publike.

Pavarësisht kërkesave të shumta me shkrim dhe personalisht, Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), duke u thirrur në konfidencialitet, nuk ka ofruar të dhëna statistikore në lidhje me numrin e avokatëve me aktakuzë ose të dënuar, ose numrin e procedurave disiplinore të iniciuara në raste të tilla, megjithëse EULEX-i kërkoi vetëm të dhëna numerike, pa asnjë informatë personale. Përveç kësaj, nga informatat që EULEX-i i ka marrë nga KGJK-ja, SMIL-i nuk e bën dallimin e të pandehurve në bazë të profesionit të tyre, duke e bërë të pamundur përcaktimin se sa avokatë aktivë janë subjekt i gjykimeve penale në proces.

së rëndë të detyrës së avokatit dhe prestigjit të avokatisë, 1.3. avokati është dënuar për veprën penale, e cila e bën të padenjë për ushtrimin e avokatisë; (...): Neni 39: 'Avokati e humb të drejtën për ushtrimin e avokatisë, nëse: (...) 1.5. i është shqiptuar dënimi disiplinor i ndalesës së përhershme të ushtrimit të avokatisë; (...) 1.9. është dënuar më shumë se një (1) vit pa kusht me burgim për vepra penale, të cilat e bëjnë të padenjë për ushtrimin e avokatisë; (...)'

27 GJEDNJ, *Samarin kundër Rusisë*, 2017: GJEDNJ mbështeti heqjen e së drejtës së avokatit për ushtrimin e avokatisë, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së besimit të publikut në profesionin ligjor. GJEDNJ, *Dimitrov kundër Bullgarisë*, 2011: GJEDNJ vendosi që një ndalim i përjetshëm për një vepër të lehtë penale ishte jo proporcional, duke përforcuar parimin e rehabilitimit.

28 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 380, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> <https://gzk.rks-gov.net/Act-DocumentDetail.aspx?ActID=18413>.

29 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 386, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

30 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 424, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

Rastet e monitoruara nga EULEX-i, megjithëse të kufizuara në numër, mund të ngrenë pikëpyetje në lidhje me integritetin e profesionit juridik nëse avokatëve që janë subjekt të procedurave penale në proces u lejohej ta vazhdojnë ushtrimin e avokatisë, veçanërisht kur aktorë të tjerë kyç në sistemin e drejtësisë, siç janë prokurorët ose gjyqtarët, në rrethana të ngjashme pezullohen.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i i rekomandon OAK-ut që t'i rishikojë dhe zbatojë rregullat e brendshme disiplinore në përputhje me Ligjin për Avokatinë dhe të sigurojë që hetimet për shkelje profesionale të iniciohen *sipas detyrës zyrtare* me të mësuar për ngritjen e aktakuzës ose dënimin e ndonjë anëtari.
- ✓ OAK-u inkurajohet gjithashtu të zbatojë masa *të përkohshme* që mund të caktohen në pritje të rezultatit të procedurave penale, me masa mbrojtëse të integruara për garantimin e procesit të rregullt ligjor dhe proporcionalitetit.
- ✓ Për ta rritur llogaridhënien, EULEX-i i propozon OAK-ut që ta rishikojë qasjen e saj ndaj transparencës në përputhje me interesin publik dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë raportimin publik të dhënave të përgjithshme në lidhje me rastet disiplinore, pezullimet dhe heqjen e licencës në lidhje me parimet e konfidencialitetit dhe, në bashkëpunim me organet mbikëqyrëse dhe subjektet e tjera monitoruese, të ofrojë të dhëna relevante sipas masave mbrojtëse të duhura.
- ✓ EULEX-i gjithashtu e inkurajon KGJK-në që, në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë, të fillojë përmirësimet teknike në sistemin SMIL për të përfshirë shënimin opsional të statusit profesional (p.sh., avokat, prokuror, gjyqtar, noter).

2.8. Zbatimi i udhëzimeve për dënimet nga gjykatat themelore

Sfondi

Më 15 shkurt 2018, GJS miratoi Udhëzime të Përgjithshme jo-detyruese për Dënimet për Kosovën me qëllim unifikimin e praktikës së dënimeve nga gjykatat dhe adresimin e problemit që zakonisht quhet 'pabarazi në dënime'. Në këtë kontekst, ky term në thelb nënkupton shqiptimin e dënimeve të ndryshme të paarsyeshme për të njëjtën vepër penale, të cilat mund të çojnë në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë³¹. Qëllimi i Udhëzimeve për Dënimet është që t'i mbështesin gjyqtarët në vendimmarrje të drejta duke u ofruar atyre një listë indikative të rrethanave që do të përdoren për zbutjen dhe rëndimin e dënimeve, si një plotësim i rregullave për dënimet të përcaktuara në nenet 69 dhe 70 të KP-së³². Përveç listës indikative të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, Udhëzimet për Dënimet u ofrojnë gjyqtarëve edhe tabela numerike me pikënisje fillestare të sugjeruara për ta llogaritur dënimin.

Për të adresuar aspekte specifike të dënimeve, në shkurt të vitit 2020, GJS miratoi Udhëzime Specifike për Shqiptimin e gjobave si ndëshkime në veprat penale nga Kodi Penal (dhe krijoi një kalkulator për llogaritjen e gjobës penale) ndërsa në qershor të vitit 2021 miratoi Udhëzimet specifike për Dënimet për Korrupsionin zyrtar dhe Veprat kundër detyrës zyrtare. Ato nuk i zëvendësojnë Udhëzimet e Përgjithshme për Dënimet, por ofrojnë hollësi në lidhje me këto vepra penale specifike.

31 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Prishtinë, 20 korrik 2012. Nr. Ref. AGJ 285/12, Rasti Nr. KI 04/12.

32 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 69 dhe neni 70, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

Më 8 nëntor 2024, për ta unifikuar praktikën e dënimeve nga gjykatat pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal në vitin 2019, GJS miratoi Udhëzime të reja për Dënimet, duke i shfuqizuar ato të vitit 2018. Ndryshe nga Udhëzimet për Dënimet të vitit 2018, ku mesatarja midis minimumit dhe maksimumit ligjor caktohej si pikënisje për të gjitha dënimet e parashikuara nga KP-ja, në Udhëzimet për Dënimet të vitit 2024 është ndjekur një qasje e ndryshme. Për secilin kapitull të KP-së (duke përjashtuar Kapitullin XXXIII, i cili mbulohet nga Udhëzimet për Dënimet për Korrupsionin zyrtar dhe Veprat kundër detyrës zyrtare të përmendura më sipër), janë përcaktuar tre shkallë të ndryshme të pikënisjes fillestare: një e treta, gjysma ose dy të tretat e minimumit dhe maksimumit të përcaktuar të dënimit, varësisht nga rreziku dhe dominimi i veprave penale, si dhe nga interesi i përgjithshëm për politika më të rrepta si në legjislacion ashtu edhe në zbatim. Pikënisjet fillestare përcaktojnë pozicionin brenda një shkalle të kategorisë nga e cila do të fillojë llogaritja e dënimit. Pasi të përcaktohet pikënisja fillestare, gjykata merr parasysh faktorët tjerë rëndues dhe lehtësues, si dhe dënimet e mëparshme, për ta rregulluar dënimin brenda këtij diapazoni. Llogaritja e faktorëve rëndues kryhet duke shtuar përqindjen e duhur të këtij faktori në pikënisjen fillestare, ndërsa llogaritja e faktorëve lehtësues kryhet duke e zvogëluar përqindjen e duhur të këtij faktori nga pikënisja fillestare. Si hapa të mëtejshëm, gjykata përcakton nëse dënimet alternative dhe/ose plotësuese për atë vepër penale janë të mundshme, proporcionale dhe të përshtatshme dhe përcakton dëmshpërblimin/kompensimin³³.

Gjetjet

Për të vlerësuar nëse gjykatat themelore i ndjekin Udhëzimet e Përgjithshme të Dënimeve të GJS-së (Udhëzimet për Dënimet), EULEX-i analizoi aktgjykimet e gjykatave themelore të përzgjedhura rastësisht të publikuara midis janarit 2024 dhe qershorit 2025 për 12 vepra penale³⁴. Bazuar në këtë vlerësim, EULEX-i gjeti se dënimet në gjykatat themelore për të njëjtat vepra penale vazhdojnë të jenë të pa unifikuara. Të gjitha aktgjykimet e analizuara e kanë një pjesë të arsytimit për atë se si përcaktohet dënimi, dhe ato përfshijnë përcaktimin e dënimit kryesor dhe më pas referencën në rregullat e përgjithshme të përcaktuara në nenet 69 dhe 70 të KP-së. Megjithatë, arsyetimi mbështetet në shabllone të cilat kanë tendencë të jenë shumë të përgjithshme dhe nuk pasqyrojnë konsideratat specifike në secilin rast. Në asnjë nga aktgjykimet e analizuara, gjykatat nuk shpjegojnë se cilat prova i mbështesin konstatimet se rrethanat personale të pandehurit janë faktor lehtësues. Për më tepër, kur shqiptojnë ndonjë gjobë, gjykatat nuk i specifikojnë në aktgjykime të ardhurat dhe gjendjen financiare të pandehurit dhe nuk e shpjegojnë se si llogaritet gjoba e shqiptuar.

Për shembull, sipas Udhëzimeve për Dënimet të vitit 2018, të aplikueshme deri në vjeshtën e vitit 2024, për veprat penale të armëmbajtjes pa leje³⁵, pikënisja fillestare për ta llogaritur dënimin është pika e mesit të diapazonit në dispozicion e identifikuar nga KP-ja për secilën vepër specifike penale. Në pikën e mesit, gjykatës i jepet diskrecioni maksimal për të lëvizur lart ose poshtë brenda diapazonit të përcaktuar me ligj³⁶. Edhe pse pika e mesit të dënimit alternativ për armëmbajtje pa leje është një gjobë prej 3,750 eurosh (dënimi i përcaktuar sipas nenit përkatës është një gjobë deri në 7,500 euro ose burgim prej pesë vjetësh), dënimi më i lartë i shqiptuar në rastet e analizuara është një gjobë prej 1,500 eurosh edhe në rastet kur i pande-

33 Udhëzimet për Dënimet 2024, Kapitulli VI. Fazat e Dënimit, f. 82 dhe 83 të versionit në anglisht.

34 Kodi Penal, 06/L-074, 14 Janar 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> si më poshtë: Mbajtje pa leje e armëve (9 vendime); raste korrupsioni si keqpërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar, dhënie ryshfeti, marrje ryshfeti, konflikt interesi, keqpërdorim dhe mashtrim në prokurimin publik, mashtrim me subvencione, mashtrim në detyrë (19 vendime); dhunë në familje (9 vendime); vrasje (10 vendime); rrezikim i trafikut publik (8 vendime); ndërtim i paligjshëm (9 vendime). Vendimet nuk janë përfundimtare, pasi kjo nuk është e nevojshme për qëllimin e analizës.

35 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 366, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

36 Udhëzime të Përgjithshme për Dënimet, Gjykata Supreme e Kosovës, 2018, Kapitulli 3, Nënkapitulli 3.3 Pikënisja e Dënimit dhe kohëzgjatja e supozuar, f. 27 në versionin në anglisht.

huri kishte një precedent penal në të kaluarën. Përveç kësaj, kur shqiptohen dënime me kusht, gjykata nuk përfshin arsyetim specifik se pse beson se kërcënimi me dënim është i mjaftueshëm për ta penguar të pandehurin të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Në shumicën e aktgjykimeve që kanë të bëjnë me këtë vepër penale, gjykatat kanë pranuar si rrethanë lehtësuese faktin që i pandehuri shfaq pendesë dhe premtion të mos e përsërisë veprën penale, ndërkohë që në të njëjtën kohë kanë theksuar se i pandehuri ishte dënuar më parë për të njëjtën vepër penale. Për më tepër, në aktgjykimet kur të pandehurit u deklaruan fajtorë dhe nuk kishin precedent penal, gjykatat shqiptuan gjoba që ndryshonin nga 300 deri në 1,500 euro. Në një rast tjetër që lidhej me të njëjtën vepër penale, ku disa nga të pandehurit kishin precedent penal në të kaluarën kurse të tjerët jo, gjykata u dha të gjithëve të njëjtin dënim, pa asnjë arsyetim. Këta shembuj tregojnë se dënimi ndonjëherë është arbitrar, pasi nuk ruhet ekuilibri midis rrethanave rënduese dhe lehtësuese.

Qasje e njëjta jounike për shqiptimin e dënimeve u has në rastet e korrupsionit të trajtuara nga departamentet e krimeve të rënda të gjykatave themelore. Udhëzimet për Dënimet të vitit 2021 për Korrupsionin zyrtar dhe Veprat kundër detyrës zyrtare ofrojnë tre diapazonë të dënimeve për veprën penale të konfliktit të interesit, për të cilën parashikohet një dënim me gjobë dhe burgim deri në tre vjet³⁷, varësisht nga përgjegjësia e të pandehurit. Në të gjitha rastet e analizuara për këtë vepër penale, dënimi i shqiptuar ishte gjashtë muaj burgim (me kusht ose i zëvendësuar me gjobë), dhe në mënyrë kumulative një gjobë në diapazonin prej 800-2,500 eurosh. Në asnjë nga këto raste nuk u shqiptua ndonjë dënim plotësues. Nuk kishte asnjë arsyetim pse u aplikua diapazoni relativisht i ulët i dënimit nëse ishin të pranishme rrethanat rënduese, ose pse u zëvendësua burgimi me gjobë. Në rastet e keqpërdorimit dhe mashtrimit në procedurat e prokurimit publik, me një dënim të parashikuar me gjobë dhe burgim deri në pesë vjet³⁸, të gjitha dënimet e shqiptuara u përcaktuan në diapazonin e ulët të dënimit për këtë vepër (burgim prej gjashtë muajsh, të gjitha të zëvendësuar me gjoba)³⁹. Vetëm në një rast u caktua dënimi plotësues për ndalimin e pjesëmarrjes në procedurat e dhënies së kontratave të prokurimit publik. Edhe GJA-ja, kur e konfirmoi një aktgjykim në lidhje me keqpërdorimin dhe mashtrimin në procedurat e prokurimit publik, nuk dha arsyetim për atë se pse dënimi i shqiptuar ishte nën kufijtë e parashikuar me ligj. Në një rast keqpërdorimi të pozitës ose autoritetit zyrtar⁴⁰ i cili shkaktoi dëme mbi 1,000 euro, dënimi i shqiptuar ishte me burgim prej gjashtë muajsh i zëvendësuar me një gjobë prej 3,600 eurosh. Megjithatë, dënimi i përcaktuar është burgim nga një deri në tetë vjet dhe sipas Udhëzimeve për Dënimet të vitit 2021 diapazoni i ulët i dënimit (nga tre sa janë: i ulët, i mesëm dhe i lartë) është midis dy dhe tre vjetësh⁴¹. Në një rast ryshfeti⁴², si personat që dhanë ashtu edhe ata që morën ryshfet kishin precedentë të mëparshëm penalë, e madje edhe i pandehuri që mori ryshfetin (një ekspert gjyqësor i cili ishte dënuar për të njëjtën vepër penale katër vjet më parë), prapëseprapë morën dënime nën diapazonin e ulët të dënimit. Nga aspekti pozitiv, atij iu ndalua ushtrimi i profesionit të tij për dy vjet si dënim plotësues. Lidhur me vendimet e fajësisë në rastet e korrupsionit të nxjerra nga Departamenti Special në GJTH të Prishtinës të shqyrtuara nga EULEX-i, dënimet e shqiptuara ndoqën diapazonin e rekomanduar për dënimet të Udhëzimeve për Dënimet të vitit 2018. Aktgjykimet ishin të arsyetuara mirë në pjesën e dënimit dhe pasqyronin rrethanat lehtësuese dhe rënduese të konsideruara si dhe rolin e secilit të pandehur.

37 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 417, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

38 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 415, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

39 Përveç në një marrëveshje për pranimin e fajësisë ku dënimi me gjashtë muaj burgim ishte me kusht.

40 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 414, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

41 Ndërsa neni 71 i Kodit Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, i lejon gjykatës të shqiptojë një dënim nën kufijtë e përcaktuar me ligj, duhet të jepet arsyetim, i cili nuk është përfshirë në këtë vendim.

42 Dhënia e ryshfetit sipas nenit 422, paragrafi 1 i Kodit Penal, 06/L-074, 14 janar 2019 dhe marrja e ryshfetit sipas nenit 421, paragrafi 1 i Kodit Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

Në rastet e dhunës në familje, të dy Udhëzimet për Dënimet parashikojnë të njëjtën pikënisje prej gjysmës së dënimit të përcaktuar: gjobë dhe burgim deri në tre vjet⁴³. Monitorimi i rasteve sipas nenit 248, paragrafët 1 dhe 3, të KP-së tregon se llogaritjet e dënimeve me burgim janë brenda diapazonit të Udhëzimeve për Dënimet, megjithëse shpesh më shumë peshë u jepet faktorëve lehtësues. Gjithashtu, në rastet e vrasjeve, gjykatat shqiptojnë dënime brenda diapazonit të dënimeve të Udhëzimeve për Dënimet, dhe nëse dënimi është nën diapazonin minimal të dënimit, ato ofrojnë arsyetim të mjaftueshëm.

Lidhur me veprën penale të rrezikimit të trafikut publik⁴⁴, Udhëzimet për Dënimet të vitit 2018 dhe 2024 nuk zbatohen. KP-ja përcakton se aksidentet rrugore të shkaktuara nga pakujdesia që rezultojnë në lëndime të rënda trupore ose dëmtim prone prej 20,000 eurosh ose më shumë, mbartin një dënim me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet⁴⁵. Sipas të dy Udhëzimeve për Dënimet, ky konsiderohet një dënim i mesëm (me maksimum deri në pesë vjet) dhe pikënisja fillestare për llogaritjen e dënimit është gjysma (dy vjet e gjashtë muaj burgim). Në aktgjykimet e analizuara, dënime minimale dhe nën minimumin u shqiptuan edhe kur kishte rrethana rënduese, kurse në disa raste dënimi minimal prej gjashtë muajsh u zëvendësua me një gjobë që sillet nga 800 deri në 1,000 euro, e cila lejohej të paguhej me këste⁴⁶. Në një rast, gjykata shqiptoi një dënim nën minimumin, edhe pse i pandehuri kishte një precedent penal që duhet të kishte ndikuar në dënimin. Në një rast tjetër, dënimi u hoq edhe pse i pandehuri shkaktoi një aksident me pasojë vdekjen me një automjet të paregjistruar të cilin e drejtonte pa patentë shoferi⁴⁷. Në asnjë nga aktgjykimet e analizuara, gjykata nuk shqiptoi ndonjë dënim plotësues, siç është ndalimi i drejtimit të automjetit dhe konfiskimi i patentës⁴⁸. Dëmi i shkaktuar viktimave nuk u mor parasysh në dënim, kurse pjesa e arsyetimit të aktgjyqimeve nuk reflektoi mbi dëmin e shkaktuar.

Sa i përket veprës penale të ndërtimit të paligjshëm⁴⁹, Udhëzimet për Dënimet të vitit 2024 përcaktojnë se dënimi i parashikuar është një dënim i mesëm me maksimum deri në pesë vjet. Për dënimin e mesëm, pikënisja fillestare është gjysma, e cila sillet nga dy vjet e nëntë muaj deri në katër vjet e gjashtë muaj burgim në varësi të kualifikimit⁵⁰. Dënimet e shqiptuara për ndërtimet e paligjshme në zonat e mbrojtura dhe parqet kombëtare, me një pikënisje prej katër vjetësh e gjashtë muajsh burgim, dallojnë në gjykata të ndryshme themelore. Në dy aktgjykime të analizuara, u shqiptua një vit burgim me kusht me një periudhë verifikimi prej një viti. Në aktgjykimin për tre vila të ndërtuara ilegalisht në Grykën e Rugovës, u shqiptua një dënim prej pesë muajsh burgim, i zëvendësuar më pas me një gjobë prej 800 eurosh, ndërsa për një shtëpi të ndërtuar ilegalisht në “Parkun Kombëtar të Sharrit”, dënimi ishte katër muaj burgim i zëvendësuar me një gjobë prej 1,000 eurosh. Në të katër rastet, të pandehurit e pranuan fajësinë, shfaqën pendesë dhe nuk kishin të kaluar kriminale. Vetëm në një nga këto aktgjykime, gjykata mori parasysh rrethanat rënduese (si qëllimi, rrethanat dhe rrezikshmëria e veprës penale për shkak të mjedisit të mbrojtur), por prapë shqiptoi një dënim të butë pa arsyetuar se pse nuk ndikuan rrethanat rënduese në dënim. Në rastet që kishin të bënin me ndërtime të paligjshme të cilat vazhduan edhe pas urdhrit të lëshuar nga institucioni kompetent për të ndalur punimet⁵¹ (me dënim të përcaktuar me gjobë dhe burgim nga një deri në pesë vjet, me tre vjet si pikënisje), u pa që dënimi ishte gjithashtu i butë. Në këto raste, dënimet u llogaritën në diapazonin minimal edhe pse kishte rrethana rënduese (shkallë e lartë e qëllimit, mënyra dhe rrethanat

43 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 248, paragrafët 1 dhe 3 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

44 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 370, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

45 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 370, paragrafi 8, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

46 Arsyetimi në aktgjykime nuk e pasqyron mënyrën se si gjykata e ka llogaritur gjobën dhe se si kjo shumë e pasqyron peshën e veprës penale dhe rrethanat financiare të të pandehurit.

47 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 78, paragrafi 1 (1.1), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

48 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, nenet 64 dhe 65, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

49 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 359, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

50 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 359, paragrafët 2-4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

51 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 359, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

e kryerjes dhe rreziku). Ndërsa nuk lidhen drejtpërdrejt me dënimin, vlen të përmendet se në të gjitha aktgjykimet e analizuara në lidhje me ndërtimet e paligjshme, gjykatat urdhëruan prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe shpenzimet do të mbulohen nga ana e të pandehurve⁵². Megjithatë, këta urdhra mbeten të pazbatuar, pasi që asnjë nga ndërtimet e paligjshme në “Parkun Kombëtar të Sharrit” dhe në Grykën e Rugovës nuk janë prishur.

Bazuar në nivelin e zbatimit, Udhëzimet për Dënimet të GJS-së duket se janë relativisht të panjohura në mesin e gjyqtarëve në gjykatat themelore. Ky përfundim mbështetet nga fakti se për shumicën e gjyqtarëve, Udhëzimet për Dënimet nuk ishin pjesë e procesit të tyre edukativ, pasi ato datojnë vetëm nga viti 2018. Në rastet e korrupsionit (përveç Departamentit Special në GJT të Prishtinës), posedimit të paligjshëm të armëve, aksidenteve rrugore dhe ndërtimit të paligjshëm, gjykatat normalisht japin dënime minimale dhe nën nivelin minimal, edhe kur ka rrethana rënduese. Kjo qasje e butë pa arsyetim të qartë e minon sundimin e ligjit në Kosovë, si dhe qëllimin e dënimit siç përcaktohet në KP, duke përfshirë zvogëlimin e përsëritjes së veprave penale dhe sigurimin e drejtësisë për viktimat⁵³.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i e inkurajon GJS-në që të vazhdojë ta rrisë sensibilizimin e gjyqtarëve në gjykatat themelore në lidhje me Udhëzimet për Dënimet, përmes takimeve, trajnimeve, punëtorive dhe me referenca në aktgjykimet e GJS-së.
- ✓ Udhëzimet për Dënimet duhet të përdoren nga gjyqtarët, duke përfshirë kalkulatorin për llogaritjen e gjobës penale, për të shmangur dallimet e paarsyeshme dhe të panevojshme në politikën e dënimeve.
- ✓ KGJK-së i këshillohet të sigurojë që Udhëzimet për Dënimet dhe kalkulatori për llogaritjen e gjobave penale të jenë lehtësisht të qasshme për gjyqtarët, si në formë dixhitale ashtu edhe në letër.

2.9. Kërcënimet ndaj prokurorëve

Sfondi

Në një shoqëri demokratike, prokurorët kanë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e sundimit të ligjit dhe në sigurimin e zbatimit të drejtësisë, duke përfaqësuar interesin publik. Vendimet e tyre mund të ndikojnë thellësisht në jetën, besimin publik dhe integritetin e sistemit të drejtësisë. Në Kosovë, prokurorëve u është besuar përgjegjësia për të filluar dhe zhvilluar procedurat penale, si dhe detyra dhe funksione të tjera të parapara me ligj. Në përputhje me legjislacionin vendas, funksionet prokuroriale duhet të kryhen në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe duhet të sigurojnë që të gjithë personat të trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit⁵⁴. Për t'i kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive, prokurorët duhet të jenë të lirë nga presionet, frikësimet ose kërcënimet e jashtme.

Gjatë aktiviteteve të rregullta të monitorimit, EULEX-i mësoi për disa raste kërcënimesh ose frikësimesh të drejtuara ndaj prokurorëve në lidhje me aktivitetet e tyre zyrtare dhe filloi një shqyrtim më të afërt të këtyre rasteve dhe të mënyrës se si trajtohen këto incidente brenda sistemit të drejtësisë.

52 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 359, paragrafi 5, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

53 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 38, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

54 Ligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, 17 maj 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=74943>.

Gjetjet

Përmes monitorimit të tij, EULEX-i vuri re raste të raportuara të kërcënimeve ose frikësimeve ndaj prokurorëve tek autoritetet. Në shumicën e tyre, hetimet nuk kanë treguar ndonjë përparim të vërtetë. Duhet theksuar se prokurorët që morën kërcënime po punonin në raste korrupsioni, në raste që përfshinin grupe të krimit të organizuar, në raste të profilin të lartë ose në raste politikisht të ndjeshme (ndëretnike).

Për më tepër, prokurorët ose pjesëtarët e familjes së ngushtë të tyre ndonjëherë janë kërcënuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në lidhje me aktivitetin e tyre profesional në ndonjë rast specifik. Për shembull, në një prej rasteve të monitoruara nga EULEX-i, një prokuror nga Prokuroria Themelore (PTH) ka qenë nën mbrojtje të afërt për pesë vjet tashmë⁵⁵. Kërcënimet ndaj prokurorit dhe një pjesëtari të familjes filluan në vitin 2020 pasi ai kishte ngritur një aktakuzë kundër një zyrtari të profilin të lartë me akuza për korrupsion. Hetimet kundër të dyshuarit filluan në vitin 2021, por u pezulluan menjëherë pas kësaj, për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga autoritetet e huaja gjyqësore. Kërkesa e fundit për bashkëpunim gjyqësor iu dërgua autoriteteve përkatëse në gusht 2024, por deri në datën e këtij raporti nuk është marrë asnjë përgjigje. Ndërkohë, i dyshuari u lirua në vitin 2021 kur kërkesa e prokurorit për ta vazhduar paraburgimin u refuzua nga gjykata dhe u caktua masa më e butë paraprake e dorëzatisë. I dyshuari u largua nga Kosova, ndërsa prokurori dhe pjesëtari i familjes së ngushtë vazhduan të merrnin kërcënime. Prokurorit më pas iu caktua mbrojtja e afërt. Ndërkohë, në vitin 2022, i njëjti prokuror u kërcënua për shkak të aktiviteteve hetimore në një rast tjetër të profilin të lartë. Pas ngritjes së aktakuzës, shqyrtimi gjyqësor filloi në vitin 2023 në një gjykatë në një region tjetër dhe është duke vazhduar ende në shkallën e parë. Që atëherë, prokurori ka lëvizur me mbrojtje të afërt, edhe kur udhëton për seancat në atë gjykatë për rastin në lidhje me të cilin pretendohet se ai/ajo është kërcënuar. I dyshuari për kërcënim në këtë rast është gjithashtu në arrati dhe në hetimet e filluara kundër tij ka pasur pak përparim.

Një prokuror tjetër i Departamentit të Krimeve të Rënda në një PTH tjetër ishte cak i disa kërcënimeve të njëkohshme gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së ankesës kundër një aktgjykimi lirues⁵⁶. Më konkretisht, disa kallëzime penale të rreme anonime ishin dërguar kundër një pjesëtari të familjes së ngushtë të prokurorit. Ndaj këtij pjesëtari të familjes menjëherë filluan hetimet. Disa muaj më vonë, një PTH tjetër konstatoi se akuzat ishin të rreme, se nuk ishte kryer asnjë veprë penale dhe hetimet u ndërpre. Megjithatë, ndaj personit anonim që kishte bërë kallëzimin e rremë nuk ishte ndërmarrë ndonjë veprim dhe as ndonjë masë hetimore. Ndërkohë, në mediat sociale u publikua një foto e këtij prokurori duke pretenduar në mënyrë të rreme se ai kishte vdekur. Shtatë muaj më vonë, i njëjti prokuror në emailin privat të tij mori një foto të rreme me përmbajtje eksplicite seksuale me një tekst shantazhues. Më vonë, kjo fotografi u përhap edhe në mediat sociale. Hetimet u iniciuan në të dy rastet e mediave sociale nga e njëjta PTH ku punon ky prokuror, por të dyshuarit janë ende të panjohur dhe nuk u arrit asnjë përparim i vërtetë.

Në vitin 2021, një prokuror i Prokurorisë Speciale u kërcënua verbalisht në shkrimoren e objektit të Prokurorisë Speciale. Hetimet u përfunduan me shpejtësi nga PTH-ja dhe brenda një muaji u ngrit aktakuza. Seanca fillestare u caktua nga gjykata tre vjet më vonë, pasi rasti nuk u konsiderua si rast urgjent sipas Planit Strategjik të KGJK-së për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025⁵⁷. Shqyrtimi gjyqësor filloi në vitin 2025 dhe është duke vazhduar ende në gjykatën themelore, megjithëse nuk është i një natyre komplekse.

⁵⁵ Prokurori u pajtua që EULEX-i do ta përmendte këtë rast në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë.

⁵⁶ Prokurori u pajtua që EULEX-i mund t'i referohet këtij rasti në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë.

⁵⁷ Plani strategjik për përmirësimin e qasjes në drejtësi 2022-2025, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/2023/03/KJC_Strategic_Plan_on_Access_to_Justice_2022.pdf (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

Një çështje tjetër e vërejtur nga EULEX-i është ajo e kërcënimeve ndaj prokurorëve, të cilat vijnë pas kritikave të ekzekutivit kundër tyre përmes medias, shpesh të zmadhuara përmes mediave sociale dhe platformave dixhitale⁵⁸. Për shembull, vendimi për të caktuar masën më të butë të sigurisë, arrest shtëpiak, ndaj një të dyshuari të ndaluar në fund të vitit 2022 u pasua nga kritika të ashpra në media nga anëtarë të qeverisë kundër prokurorit të rastit dhe gjyqtarit të procedurës paraprake. Kjo u pasua nga një grafit me mbishkrimin “*Shtyllë e turpit*” me emrat e gjyqtarit dhe prokurorit të përfshirë në këtë rast, të cilat u shfaqën në disa lokacione në Prishtinë menjëherë pas kësaj. Tre vjet më vonë, në vitin 2025, grafitet me emrat e tyre ende nuk janë hequr nga të gjitha lokacionet, ndërsa nuk është nisur asnjë hetim për këtë rast.

Në një aspekt pozitiv, EULEX-i vërejti se në rastet e kërcënimeve ndaj prokurorëve, KPK-ja zakonisht inicion ofrimin e mbrojtjes fizike për ta kur kjo konsiderohet e nevojshme, dhe në shumicën e rasteve reagon publikisht ndaj sulmeve përmes medias. Megjithatë, duhet bërë më shumë punë në trajtimin e çështjes së kërcënimeve ndaj prokurorëve. Disa nga rastet e rënda të kërcënimeve, përpjekjeve për të penguar, frikësuar, ndërhyrë ose hakmarrë ndaj prokurorëve synojnë pengimin e drejtësisë dhe për këtë arsye kërkojnë një hetim dhe gjykim të shpejtë dhe të plotë. Duke pasur parasysh këtë, si dhe duke e pranuar faktin se ka ngarkesë të madhe të punës së gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe detyrën e tyre për t’ju përmbajtur rregullave të KGJK-së për mënyrën e trajtimit të numrit të madh të rasteve të grumbulluara (duke u dhënë përparësi rasteve më të vjetra), vonesa në gjykimin e rasteve që kanë të bëjnë me kërcënimet ndaj gjyqtarëve ose prokurorëve dërgon një mesazh se ato nuk janë të rëndësishme, duke i lënë autorët e krimit të pandëshkuar. Një Shoqatë e Prokurorëve që funksionon mirë dhe e pavarur mund të ofrojë ndihmë dhe mbështetje personale për prokurorët e kërcënuar ose të frikësuar, por Shoqatës ekzistuese të Prokurorëve, megjithëse e miratuar zyrtarisht, i mungojnë burimet e nevojshme për të ofruar ndihmë kuptimplote.

Kërcënimet mund ta komprometojnë pavarësinë e prokurorëve, mund t’i frikësojnë ata për t’i ndryshuar ose braktisur rastet, dhe mund të çojnë në dobësimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe ta dekurajojnë bashkëpunimin e publikut për hetimet. Prandaj, është e domosdoshme që të gjitha rastet e kërcënimeve kundër prokurorëve të hetohen plotësisht dhe me shpejtësi. Hetimet efektive shërbejnë si për mbrojtjen e personit ashtu edhe për të dërguar një mesazh të qartë se nuk do të tolerohet asnjë përpjekje për ta penguar drejtësinë. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se GJEDNJ-ja në shumë raste e ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit në shoqëri, i cili, si garantues i drejtësisë, duhet të gëzojë besimin e publikut për të qenë i suksesshëm në kryerjen e detyrave të tij⁵⁹.

Rekomandime

- ✓ PTH-të duhet t’i japin përparësi hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve që përfshijnë përpjekje për t’i frikësuar ose kërcënuar prokurorët.
- ✓ EULEX-i i rekomandon KPK-së që ta krijojë dhe ta vërë në funksion një mekanizëm të strukturuar për vlerësimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve që për cak i kanë prokurorët.
- ✓ KPK-së i këshillohet që ta lehtësojë krijimin dhe funksionimin e një Shoqate të pavarur dhe vetërregulluese të Prokurorëve, e cila, përveç përgjegjësisë të tjera, do të ofronte mbështetje dhe përfaqësim institucional në rastet që përfshijnë kërcënimet ose presion të panevojshëm.
- ✓ Ekzekutivi duhet të përmbahet nga kritikave të ashpra publike ndaj prokurorëve individualë, pasi kjo mund të ketë ndikim në pavarësinë institucionale të prokurorisë, duke krijuar një ‘efekt frenues’ dhe duke rezultuar në auto censurë.

58 Në vitin 2024, një Zëvendës Ministër ndau një status në rrjetet sociale (Meta) të drejtorit të një kompanie i cili e quajti Prokurorinë Speciale një organizatë kriminale pasi ata kishin filluar një hetim kundër kompanisë.

59 GJEDNJ, *Kovesi kundër Rumanisë*, 2020, nr. 3594/19, paragrafi 201 dhe GJEDNJ, *Morice kundër Francës*, 2015, nr. 29369/10, paragrafi 128.

3. Gjetjet nga monitorimi tematik

3.1 Llogaridhënia për pretendimet për keqtrajtim nga pjesëtarë të Policisë së Kosovës: vlerësim fillestar

Sfondi

Në përputhje me standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, në Kosovë ndalimi i torturës dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose degradues është absolut dhe vlen në të gjitha rrethanat.⁶⁰ Autoritetet mbajnë detyrime si negative ashtu edhe pozitive kur bëhet fjalë për të drejtën për të qenë i lirë nga tortura dhe keqtrajtimi. Detyrimi negativ në thelb nënkupton që të gjithë zyrtarët, duke i përfshirë zyrtarët policorë, por pa u kufizuar vetëm në ta, duhet të përmbahen nga kryerja e akteve të torturës ose formave të tjera të keqtrajtimit. Detyrimi pozitiv kërkon krijimin e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore dhe institucionale që parandalon në mënyrë efektive torturën dhe keqtrajtimin, dhe detyrimin për të kryer hetime efektive ndaj të gjitha pretendimeve të besueshme ose pohimeve të argumentueshme për veprime të tilla. Për të arritur standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, hetimet mbi pretendimet për torturë ose keqtrajtim duhet t'i përmbahen disa parametrave thelbësore që sigurojnë efektivitetin e tyre. E para, masat hetimore të ndërmarra duhet të jenë të duhura; ato duhet të mundësojnë gjetjen e plotë të fakteve dhe identifikimin e përgjegjësve. E dyta, hetimet duhet të fillojnë menjëherë dhe të kryhen pa vonesa të panevojshme duke siguruar që provat të ruhen dhe dëshmitarët të jenë të disponueshëm derisa kujtimet e tyre të jenë ende të freskëta. E treta, viktimat duhet të përfshihen në procesin hetimor në një masë të arsyeshme. Kjo përfshinë informimin mbi zhvillimet e rëndësishme dhe lejimin për të kontribuar me informata relevante. Në fund, hetimi duhet të kryhet nga një organ që është i pavarur si institucionalisht ashtu edhe praktikisht nga të përfshirët në sjelljen e pahijshme të pretenduar, me qëllim të ruajtjes të besimit të publikut dhe shmangien e konflikteve të interesit.

Është gjithashtu e rëndësishme të nënvizohet se sipas standardeve ndërkombëtare, detyrimi për të kryer hetime efektive nuk është çështje e rezultatit, por e mënyrës. Kjo nënkupton se jo çdo hetim duhet domosdoshmërisht të jetë i suksesshëm ose të arrijë në një përfundim të prerë mbi vërtetësinë e pretendimeve të ngritura. Megjithatë, hetimi duhet të jetë i plotë dhe autoritetet duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshme në dispozicion për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë, ndër të tjera, deklaratat e dëshmitarëve okularë dhe provat forenzike. Çdo mangësi në hetime që dëmton mundësinë e tyre për të përcaktuar shkakun e lëndimeve ose identitetin e personave përgjegjës, mund të rrezikojë përmbushjen e këtij standardi.⁶¹

⁶⁰ Kjo bazohet në zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të drejtave të njohura sipas Konventës kundër torturës dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese; Konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, Konventës për të drejtat e fëmijës dhe Paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, por edhe dispozitës specifike nga neni 27 i Kushtetutës së Kosovës [Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues] i cili thekson se “Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues”.

⁶¹ Për më shumë informata mbi detyrimet pozitive dhe negative sipas Konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, ju lutemi referojuni “Udhëzuesit mbi nenin 3 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut: ndalimi i torturës” të Këshillit të Evropës, 28 shkurt 2025.

Në Kosovë, aktet e torturës dhe keqtrajtimit nga zyrtarë publikë janë të penalizuara me nenet 196⁶² dhe 195⁶³ të KP-së. Për më tepër, Ligji për Policinë përcakton që zyrtari policor nuk do të shkaktojë, nxisë, mbështesë ose tolerojë asnjë akt të torturës apo trajtimit çnjerëzor ose degradues në çfarëdo rrethane, dhe asnjë urdhër i lëshuar nuk do të arsyetojë ndonjë veprim të tillë.⁶⁴ Udhëzimi administrativ nr. 04/2019 për Shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në Policinë e Kosovës e klasifikon përdorimin e tepërt të forcës si shkelje disiplinore të rëndë.⁶⁵

Llogaridhënia për pretendimet për keqtrajtim dhe torturë nga PK-ja sigurohet përmes mekanizmave të ndryshme institucionale. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), një agjenci e pavarur brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme, është përgjegjës për hetimin e pretendimeve që përfshijnë elemente të veprave penale. IPK-ja mund të hetojë rastet bazuar në ankesa të jashtme, me vetiniciativë ose pas inicimit të brendshëm nga PK-ja ose referimit nga institucione të tjera. Pas një shqyrtimi fillestar të ankesës nga Departamenti i IPK-së për menaxhimin e ankesave, rasti procesohet nga Departamenti i hetimeve nëse ai përmban elemente të përfshirjes së zyrtarëve të PK-së në aktivitete kriminale, ndërsa i referohet Divizionit të Hetimeve të Brendshme (DHB) brenda PK-së kur përmban elemente të shkeljeve disiplinore.⁶⁶

Pasi të ketë hetuar rastet që përmbajnë elemente të veprave penale, IPK-ja i paraqet ato te autoritetet e ndjekjes penale përmes: një kallëzimi penal, kur, bazuar në informacionin e marrë, ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepër penale e ndjekur sipas detyrës zyrtare (në një rast të tillë, prokuroria vendosë nëse do ta ndjekë penalisht rastin apo jo);⁶⁷ një raport të veçantë, kur IPK-ja nuk ka mundur të mbledhë informacione të mjaftueshme që do të mund të përcaktonin dyshimin e arsyeshëm për kryerje të veprës penale (në një rast të tillë, prokuroria mund të kërkojë veprime pasuese nga IPK-ja ose të mbyllë hetimin).⁶⁸ Pasi rasti të arrijë te autoritetet e prokurorisë, ai vazhdon nëpër zinxhirin e drejtësisë si çdo rast penal tjetër. Në rast se individët vlerësojnë se autoritetet - me veprimet, mosveprimet ose vendimet e tyre - kanë shkelur të drejtat e tyre, ata mund të paraqesin ankesë te Avokati i Popullit.

Gjetjet

Në vitin 2021, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) publikoi gjetjet nga vizita e tij në Kosovë e kryer në tetor 2020. KPT theksoi se shumica e personave të intervistuar gjatë vizitës, të cilët ishin në mbajtje policore ose që një të kaluar të afërt kishin qenë në mbajtje policore, nuk ngritën pretendime për keqtrajtim nga zyrtarët policorë, por

62 Kodi Penal, 06/L-074, 14 Janar 2019, neni 196, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>: "Tortura 1. 1. Personi zyrtar ose personi i cili duke vepruar nën ndikimin ose me pëlqimin apo pranimin e heshtur të personit zyrtar kryen aktin e torturës, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet. 2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet. 3. Për qëllime të këtij neni, akti i torturës nënkupton kryerjen ose moskryerjen e një akti me anë të cilit me dashje personit i shkaktohet dhembja ose vuajtja e rëndë, qoftë fizike ose mendore, me qëllim të marrjes së informatës apo deklaratës nga personi i tillë ose nga personi i tretë, ose me qëllim të dënimit të personit të tillë për një vepër të cilën ai ose personi i tretë e ka kryer ose dyshohet se e ka kryer, ose për frikësimin apo shtrëngimin e personit ose të personit të tretë për arsye që kanë të bëjnë me diskriminim të çfarëdo lloji. Akti i torturës nuk përfshin asnjë veprim ose mosveprim që rrjedh vetëm nga aktet e pashmangshme apo karakteristike të sanksioneve të ligjshme.

63 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 195, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413> "Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike 1. Personi zyrtar, i cili duke keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij e keqtrajton, frikëson ose fyen rëndë dinjitetin e personit tjetër, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet. 2. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

64 Ligji për Policinë, 04/L-076, 19 mars 2012, ndryshimi i fundit më 27 dhjetor 2024, neni 13, paragrafi 3, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806&langid=2>.

65 Ligji për Policinë, 04/L-076, 19 mars 2012, ndryshimi i fundit më 27 dhjetor 2024, neni 19, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806&langid=2>.

66 Brenda vetë PK-së, strukturat kryesore të llogaridhënies përfshijnë Drejtorinë e hetimeve të brendshme, Komisionin disiplinor dhe Komisionin për përdorimin e forcës.

67 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 82 paragrafi 5, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

68 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 82 paragrafi 4, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

delegacioni dëgjoi një numër pretendimesh për keqtrajtim fizik në kohën e ndalimit dhe gjatë marrjes në pyetje nga policia.⁶⁹

Gjatë periudhës së raportimit, pas pretendimeve për keqtrajtim nga PK-ja të ngritura në media ose nga organizata të shoqërisë civile, veçanërisht në veri të Kosovës, EULEX-i shikoi funksionimin e procesit të llogaridhënies në lidhje me këtë lloj specifik të pretendimeve, me qëllim që të arrinte në një vlerësim fillestar paraprak të çështjes. Për ta bërë këtë, EULEX-i shqyrtoi praktikën gjyqësore ekzistuese të gjykatave të Kosovës mbi veprat penale nga nenet 195 dhe 196 të KP-së, dhe monitoroi trajtimin nga autoritetet përkatëse të një mostre të rasteve individuale relativisht të reja që përmbanin pretendime për keqtrajtim nga PK-ja.

Gjetjet mbi praktikën gjyqësore të publikuar të gjykatave të Kosovës

Për të identifikuar rastet relevante për këtë analizë, EULEX-i konsultoi faqen e internetit të KG-JK-së. Ndërsa nuk u gjetën raste gjyqësore që lidheshin me akuzat për torturë (neni 196 i KP), ishin 24 raste që lidheshin me keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimit publik (neni 195) të trajtuara nga gjykatat themelore. Në shumicën e rasteve, akuza penale nga neni 195 ishte e kombinuar ose me një akuzë për lëndim të lehtë trupor (neni 185) ose për lëndim të rëndë trupor (neni 186) të Kodit Penal aktual ose neneve përkatëse në Kodin Penal të mëparshëm. Faktet që i dhanë bazë rasteve kishin ndodhur në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2021. Bazuar në shqyrtimin e aktgjykimeve, është e qartë se nga 41 zyrtarë policorë të akuzuar në ato 24 raste, 18 ishin pjesë e 'njësive speciale' të ndryshme (44%), 15 i përkisnin njësive të rregullta ose njësia e tyre nuk ishte specifikuar në aktgjykim (37%), pesë ishin hetues (12%) dhe tre ishin nga policia e trafikut (7%). Rastet përfshinin gjithsej 29 viktima, përfshirë tre të mitur.⁷⁰ Koha mesatare e kaluar nga data e incidentit deri në datën e aktakuzës ishte afërsisht 560 ditë, ndërsa koha nga incidenti deri në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ishte rreth 1330 ditë.

Lidhur me lokacionet ku ka ndodhur keqtrajtimi i pretenduar, shumica (22 raste) kanë ndodhur jashtë ambienteve të policisë, përkatësisht gjatë ndalimeve, kontrolleve, operacioneve, pranxosjes dhe situatave të ngjashme; 11 raste kanë ndodhur brenda ambienteve të policisë, konkretisht në oborre, korridore, dhoma të intervistimit ose vende të tjera; dhe gjashtë raste kanë ndodhur gjatë transportimit. Në disa raste të vetme, keqtrajtimi ka ndodhur në lokacione të shumëfishta, p.sh. në rrugë ose në hapësira të tjera publike/private dhe gjatë transportimit, dhe/ose në ambiente të policisë.

Keqtrajtimi i pretenduar ka përfshirë gjuhë fyese dhe keqtrajtime fizike si grushtime, shkelmime, shuplaka, dhe goditje me shkopinj gome, duke rezultuar kryesisht në hematoma (mavijosje) dhe gërvishtje, dhe në disa raste fraktura të ekstremiteteve dhe të nofullës.

Në total, 73 akuza janë ngritur kundër 41 të akuzuarve. Nga këto akuza, 34 rezultuan në dënime për keqtrajtim (neni 195), 13 për lëndime të lehta trupore, dhe shtatë për lëndime të rënda trupore; nëntë akuza rezultuan me lirime nga akuzat dhe dhjetë u hodhën poshtë për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

Lidhur me dënimet, nga 45 dënimet e shqiptuara,⁷¹ 20 ishin gjopa që varionin nga disa qindra deri në 2000 euro; dhjetë ishin dënime me burgim (nga disa ditë deri në gjashtë muaj) të zëvendësuar me gjopa; tri ishin burgime me më pak se gjashtë muaj; katër ishin burgime me mbi gjashtë

69 Këshilli i Evropës, Raport për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi vizitën në Kosovë* të kryer nga Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues (CPT) nga 6 deri më 16 tetor 2020, shtator 2021, <https://rm.coe.int/1680a3ea32> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

70 Gjinia, moshë dhe etnia e zyrtarëve të policisë dhe viktimave nuk specifikohen; vetëm në pak raste shënohet shprehimisht se viktima është person nën moshën 18 vjeç.

71 Në disa raste, një dënim unik u shqiptua për akuza të shumëfishta; kjo shpjegon pse numri i dënimeve të shqiptuara është më i ulët se numri i akuzave që përfunduan me shpallje fajtor.

muaj; dhe tetë burgime ishin pezulluar për një periudhë të caktuar. Çuditërisht, nuk pati dënime plotësuese të propozuara nga prokurori dhe as të shqiptuara nga gjykata, pavarësisht kërkesave të përcaktuara në nenet 62 dhe 63 të KP-së (shih edhe seksionin përkatës në këtë raport).

Edhe pse proporcionaliteti i dënimit me veprën e kryer duhet të vlerësohet gjithmonë në raport me rrethanat specifike të secilit rast, paraprakisht mund të vlerësohet se, butësia e dukshme e dënimeve edhe në rastet kur akuza nga neni 195 është kombinuar me akuzat për lëndim trupor, në përgjithësi ngre pikëpyetje. Konkretisht, nëse sanksioni i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprave penale dhe në përputhje me natyrën absolute të ndalimit të torturës dhe maltretimit. Duke pasur parasysh detyrimet pozitive të Kosovës për të parandaluar këto sjellje të ndaluara, sistemi i drejtësisë duhet të sigurojë mundësinë e ushtrimit të efektit pengues dhe për këtë arsye duhet të vendosë sanksione që janë në proporcion me peshën e veprës penale, duke përfshirë dënimet plotësuese. Përndryshe, ekziston rreziku i dobësimit të besimit publik në sistemin e llogaridhënies, gjë që mund të shkaktojë një ndjenjë të pandëshkueshmërisë.

Gjetjet nga monitorimi i një mostre të rasteve nga EULEX-i

Gjatë periudhës së raportimit, EULEX-i monitoroi 25 raste të kohëve të fundit që përfshinin pretendime për maltretim ose përdorim të tepruar të forcës (përfshirë armët e zjarrit) që kanë ndodhur mes periudhës tetor 2022 dhe maj 2025. Për disa nga rastet e monitoruara, hetimet nga IPK-ja kanë përfunduar dhe rastet, në kohën e shkrimit të këtij raporti, ishin tek autoritetet e prokurorisë ose në gjykata, ndërsa tek raste të tjera hetimet nga IPK-ja ose DHB-ja kanë përfunduar dhe/ose janë ndërprerë. Duhet të merret parasysh se EULEX-i nuk i kishte në dispozicion dokumentet nga 25 dosjet përkatëse të rasteve dhe gjetjet bazohen kryesisht në informacione që janë marrë përmes takimeve me autoritetet përkatëse, dhe në disa raste edhe me viktimat e supozuara.

Zyrtarët e PK-së të përfshirë në shkeljet e pretenduara në 25 rastet e monitoruara përfshinin 13 zyrtarë policorë nga 'njësitë speciale', pesë zyrtarë policorë të rregullt me uniformë dhe dy zyrtarë policorë me veshje civile. Në gjashtë raste, njësia së cilës i përkasin zyrtarët policorë nuk është e njohur për EULEX-in. Në disa raste, numri i zyrtarëve policorë të përfshirë ose të paktën të pranishëm gjatë keqtrajtimit ose përdorimit të tepruar të forcës të pretenduar ishte i shumëfishtë. Pretendimet për maltretim përfshinin gjuhë fyese, shuplaka, grushtime dhe shkelmime, disa prej të cilave rezultuan në thyerje kockash.

Raportet e dërguara nga IPK-ja te prokurori përgjegjës përfshinin gjashtë kallëzime penale, dy raporte informative,⁷² 11 raporte të posaçme, ndërsa për shtatë raste lloji i raporteve nuk është i ditur. Në disa raste, prokurorit iu dërguan raporte të shumëfishta të ndryshme në lidhje me zyrtarë të ndryshëm. Për shembull, në një rast ku zyrtarët policorë në një pikë kontrolli qëlluan me armë një burrë që po ngiste makinën, IPK-ja hetoi katër zyrtarë policorë nga 'njësitë speciale' dhe ngriti tri kallëzime penale. Gjykata më vonë shpalli fajtor një zyrtar policor për tentim vrasje dhe e dënoi me tri vite burgim.

Në aspektin e parametrave të hetimeve efektive të përshkruara më sipër, EULEX-i vuri re pozitivisht se në një rast të pretenduar të dhunës fizike nga policia që rezultoi në lëndime trupore, IPK-ja hetoi incidentin me shpejtësi dhe ngriti dy kallëzime penale kundër dy zyrtarëve policorë në prokurori afërsisht një muaj e gjysmë pas ndodhjes së rastit. Për më tepër, në shumë raste, IPK-ja menjëherë filloi hetimet sipas detyrës zyrtare në mungesë të ankesave zyrtare dhe e komunikuan këtë publikisht. Në një numër të rasteve të tjera, IPK ndërmori hapa efektivë për të konstatuar faktet relevante, duke përfshirë sigurimin me shpejtësi të pamjeve të disponueshme të kamerave të sigurisë. Për më tepër, me qëllim të parandalimit të sjelljeve të pahijshme dhe

⁷² Raportet informative janë raporte të paraqitura në prokurori brenda 72 orëve nga marrja e informacionit në lidhje me mundësinë që të jetë kryer vepër penale që ndiqet penalisht sipas detyrës zyrtare.

reagimin e shpejtë, IPK-ja ka kryer monitorim të pavarur dhe të paanshëm të operacioneve policore gjatë ngjarjeve të profilit të lartë.

Megjithatë, EULEX-i ka identifikuar gjithashtu se në disa raste, hapat hetimorë të ndërmarrë nuk ishin mjaftueshëm të shpejtë ose duken të pamjaftueshëm. Në raste të shumfishta, hetimet fillestare u nisën disa javë pas akuzave publike, duke çuar në uljen e disponueshmërisë së provave dhe besueshmërisë së tyre. Intervistat me personat e përfshirë (zyrtarë policorë, viktima të dyshuara dhe dëshmitarë) ndonjëherë u mbajtën me vonesa, ndonjëherë disa muaj pas incidentit, edhe kur identiteti i tyre ishte i njohur; kjo qasje mund të rezultojë në uljen e vlerës së provave dhe të rrisë rrezikun e deklaratave të koordinuara. Ndërsa vonesat për mbajtjen e intervistave mund të arsyetohen me prioritete operative dhe mungesë të personelit, duhet të merret në konsideratë se mungesa e shpejtësisë mund të ndikojë në efektivitetin e përgjithshëm të hetimeve dhe për rrjedhojë në mundësinë e tyre për të konstatuar faktet dhe mbi të gjitha për të përcaktuar nëse akuzat janë të bazuara apo jo.

EULEX-i konstatoi gjithashtu se në disa hetime, IPK-ja nuk siguroi prova digjitale ose nuk i identifikoi me shpejtësi dëshmitarët relevant. Për më tepër, në disa raste, identiteti i zyrtarëve të pranishëm në momentin e keqtrajtimit të pretenduar nuk mund të përcaktohej. Duhet të theksohet se mos marrja e provave forenzike në dispozicion ose mungesa e ndjekjes së pistave të dukshme hetimore mund të komprometojë rëndë efektivitetin e hetimeve dhe mund të ngrejë dyshime publike në lidhje me përpikërinë e tyre. Në këtë kontekst, shpërndarja e fundit e kamerave për trup në stacionet e policisë në të gjithë Kosovën është një zhvillim pozitiv pasi përdorimi i tyre mund të parandalojë shkelje të mundshme dhe mund të ndihmojë në hedhjen poshtë të pretendimeve të pavërteta kundër PK-së.

Siç është theksuar tashmë nga KPT në vitin 2020,⁷³ dhe siç është identifikuar edhe në disa nga rastet e monitoruara, veçanërisht ato që përfshijnë njësi speciale, siguri i bashkëpunimit të zyrtarëve të policisë në lidhje me hetimet mund të paraqesë vështirësi për IPK-në dhe DHB-në. Kjo mund të jetë për shkak të një ndjenje të miqësisë e cila mund të rezultojë në heshtje të zyrtarëve në rast të shkeljeve të kryera nga kolegët e tyre. Mosarritja e identifikimit të gjithë zyrtarëve policorë të pranishëm gjatë ndonjë incidenti ose mos marrja e deklaratave të tyre i bën hetimet joefektive dhe kështu jo në përputhje me detyrimet pozitive të përshkruara më sipër.

Në lidhje me fazën e ndjekjes penale, deri sa është e rëndësishme të përsëritet se në shumicën e 25 rasteve, prokuroria ende nuk ka vendosur nëse do t'i ndjekë ata penalisht apo jo, diskutimet me disa prokurorë kanë nxjerrë në pah se rastet e dyshimeve për keqtrajtim nga PK-ja zakonisht nuk trajtohen si prioritet.

Kjo mund të paraqesë probleme në veçanti në lidhje me marrjen e provave që nuk janë marrë ende gjatë hetimeve të IPK-së. Si rezultat, këto prova mund të mos jenë më të disponueshme nëse kërkohen nga prokurori në një fazë shumë të vonshme. Një element tjetër shqetësues u ngrit në lidhje me një rast që përfshinte keqtrajtim dhe lëndime të rënda trupore që ndodhën gjatë një arrestimi. Prokurori përgjegjës për rastin informoi EULEX-in se ai po e konsideronte zgjidhjen e rastit me ndërmjetësim. Edhe pse ky veprim nuk është zyrtarisht i ndaluar,⁷⁴ është i papërshtatshëm në rastet e keqtrajtimit nga zyrtarët publikë dhe qartësisht nuk përmbush detyrimet pozitive për të drejtat e njeriut. Referimi i një rasti për ndërmjetësim nënkupton që faktet nuk do të përcaktohen, ata që janë përgjegjës nuk do të ndëshkohen dhe nuk do të

73 Këshilli i Evropës, Raport për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi vizitën në Kosovë* të kryer nga Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues (CPT) nga 6 deri më 16 tetor 2020, shtator 2021, faqja 13, <https://rm.coe.int/1680a3ea32> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

74 Kodi i Procedurës Penale, 08/L-032, 17 gusht 2022, neni 229, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>. Neni 229 lejon që rasti t'i referohet ndërmjetësimit formal për vepra penale të dënueshme me gjobë ose deri në tre vjet burgim (duke përjashtuar dhunën në familje dhe veprat penale kundër integritetit seksual). Referimi bëhet nën mbikëqyrjen e autoriteteve gjyqësore, me pëlqimin e palës së dëmtuar. Ndërmjetësimi kryhet përmes ndërmjetësuesve të pavarur dhe të çertifikuar.

ketë asnjë shqyrtim publik.⁷⁵ Ndërsa EULEX, në këtë fazë, nuk e ka përcaktuar shkallën në të cilën ndërmjetësimi përdoret në rastet e keqtrajtimit, fakti që kjo doli gjatë aktiviteteve të monitorimit ngre shqetësime. Në fund, EULEX vuri re se në disa raste, autoritetet e prokurorisë nuk e kanë konsideruar përfshirjen e akuzave për lëndime trupore, edhe nëse dokumentacioni mjekësor përcaktonte qartë se viktimat kishin pësuar lëndime.

Lidhur me DHB, i cili vepron brenda PK-së dhe është i ngarkuar me detyrën për disiplinën e brendshme dhe pajtueshmërinë me etikën, efektiviteti i tij është i lidhur ngushtë me qasjen me kohë në informatat për rastet dhe gatishmërinë e strukturës komanduese të PK-së për të mbështetur shqyrtimin e brendshëm. Pikat e forta të vërejtura nga EULEX-i në punën e DHB janë korniza rregullative solide, profesionalizmi dhe transparenca e dëshmuar, si dhe gatishmëria për të rekomanduar sanksione, si zbritje page, kur është e duhur. Për më tepër, EULEX-i konstaton se DHB në përgjithësi fillon intervistat dhe mbledhjen e provave sa më herët që të jetë e mundur gjatë procesit, respekton afatet kohore dhe informon ankuesit për rezultatin e hetimeve. Megjithatë, një çështje problematike e identifikuar nga EULEX-i është se DHB ndonjëherë shtyn gjetje përfundimtare për rastet e brendshme disiplinore deri pas përfundimit të procedurave gjyqësore penale.⁷⁶ Ndërsa kjo qasje synon të shmangë gjetjet kontradiktore dhe mund të arsyetohet në disa raste, në raste të tjera procedurat disiplinore duhet të zhvillohen paralelisht me hetimet penale. Shkeljet disiplinore të rënda i nënshtrohen parashkrimit pas katër viteve nga koha e kryerjes së veprimit dhe shkeljet disiplinore të lehta pas dy viteve nga koha e kryerjes së veprimit.⁷⁷ Prandaj, pezullimi i procedurave disiplinore në raste të caktuara mund të sjellë humbjen e provave përkatëse, rreziqet e parashkrimit, rreziqet e përsëritjes së shkeljeve në rastet kur zyrtarët rifillojnë detyrat e tyre dhe, në rastet më të këqija, të rezultojë në pandëshkueshmëri.

Lidhur me përfshirjen e viktimave të pretenduara në procesin hetimor dhe të drejtën e tyre për t'u informuar për zhvillimet e rëndësishme, EULEX-i konstatoi se ankuesit që kërkuan në mënyrë aktive informacione nga IPK-ja personalisht, si në lidhje me regjistrimin e ankesës ashtu edhe në lidhje me statusin e saj, në përgjithësi i morën ato informacione. Megjithatë, informacioni mbi zhvillimet e rëndësishme, si për faktin që IPK-ja nuk gjeti elemente të veprave penale dhe se rasti do t'i referohej DHB, ndonjëherë jepet me telefon. Kjo qasje lë hapësirë për keqkuptime dhe frustrim, pasi ankuesit mund të mos jenë në gjendje ta kuptojnë plotësisht se si funksionon procesi dhe mund të humbasin shpresën në sistem, veçanërisht në ato raste kur nuk dëgjojnë asgjë nga institucionet për një kohë të gjatë. Ofrimi i informacionit të saktë në lidhje me statusin e rasteve kur ato të kenë arritur te autoritetet e ndjekjes penale gjithashtu duket problematik nganjëherë, për shkak të prioritizimit të tyre të ulët në përgjithësi.

Si përfundim, EULEX-i konstaton se Kosova ka vendosur kornizë ligjore dhe institucionale gjithëpërfshirëse për përmbushjen e detyrimeve pozitive të saj dhe është e rëndësishme që ajo të zbatohet në praktikë në shkallën e saj të plotë në të gjitha rastet kur ngrihet ndonjë pretendim i argumentueshëm për keqtrajtim nga zyrtarë policorë, pavarësisht nga grada ose njësia e tyre. Viktimat e pretenduara duhet të informohen në mënyrë adekuate dhe proaktive për zhvillimet përkatëse gjatë gjithë procesit të llogaridhënies. Për më tepër, dënimet në rastet kur pretendimet konfirmohen duhet të jenë në përputhje me peshën e veprave.

Duke pasur parasysh se disa forma të keqtrajtimit nuk lënë lëndime ose shenja të dukshme (siç janë shuplakat) dhe mund të jenë të vështira për t'u vërtetuar në mungesë të dëshmitarëve ose provave forenzike, duke çuar në *de facto* pandëshkueshmëri, një mesazh i qartë duhet të vazh-

75 GJEDNJ, *Al Nashiri kundër Rumanisë*, 31 maj 2018, f. 641 dhe GJEDNJ, *Sabalić kundër Kroacisë*, 14 janar 2021, f. 97.

76 Udhëzimi administrativ nr. 04/2019 për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në Policinë e Kosovës, neni 5.16, <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/ADMINISTRATIVE-INSTRUCTION-No.-04-2019.pdf> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

77 Udhëzimi administrativ nr. 04/2019 për shkeljet, masat dhe procedurat disiplinore në Policinë e Kosovës, Neni 70 <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/ADMINISTRATIVE-INSTRUCTION-No.-04-2019.pdf> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

dojë t'i përçohet të gjithë zyrtarëve policorë se çdo formë e keqtrajtimit, përfshirë edhe keqtrajtimin verbal, është e paligjshme dhe përbën shkelje të drejtave të njeriut. Siç është theksuar nga KPT, PK duhet të promovojë një kulturë policore ku zgjedhja e keqtrajtimit konsiderohet joprofesionale dhe një kuptim të qartë se *"... fajësia për keqtrajtim shtrihet përtej autorëve të vërtetë deri tek kushdo që e di, ose që duhet ta dijë, se keqtrajtimi është duke ndodhur/ka ndodhur dhe nuk vepron për ta parandaluar ose raportuar atë"*.⁷⁸

Rekomandime

- ✓ Udhëheqja e PK-së duhet të vazhdojë të ritheksojë tek të gjithë zyrtarët policorë se gjatë ndalimit duhet të përdoret vetëm forca që është absolutisht e nevojshme dhe se, pasi të jetë kryer ndalimi dhe personat e ndaluar të jenë vënë nën kontroll, nuk duhet të përdoret forcë e mëtejme.
- ✓ Përmes trajnimeve, mbikëqyrjes dhe udhëheqjes, PK-ja duhet të vazhdojë t'u dërgojë një mesazh të qartë të gjithë zyrtarëve policorë se çdo formë e keqtrajtimit, përfshirë edhe keqtrajtimin verbal, është e paligjshme dhe do të ndëshkohet.
- ✓ EULEX-i i bën thirrje udhëheqjes së PK-së që të sigurojë përdorimin e detyrueshëm të kamerave trupore dhe kamerave të vëzhgimit CCTV në stacionet policore, nga patrullat dhe njësitë speciale. Në rastet kur kamerat trupore dhe kamerat e vëzhgimit CCTV janë të pamjaftueshme ose të padisponueshme, duhet të ndahen fonde të mjaftueshme për të adresuar këtë boshllëk, dhe udhëheqja e PK-së duhet të marrë në konsideratë dhënien e përparësive njësive ose stacioneve policore që kanë të dhëna të dëshmuara për shkelje, pretendime të argumentueshme të ngritura kundër tyre ose që veprojnë në kontekste të ndjeshme.
- ✓ Në rast të ankesave dhe/ose raportimeve publike të shumëfishta në lidhje me sjelljen e njësive specifike, IPK/DHB nuk duhet t'i hetojnë ato si raste të izoluara, por duhet t'i analizojnë dhe shqyrtojnë ato bashkërisht në mënyrë që të përcaktojnë modellet dhe/ose praktikat sistemike.
- ✓ Udhëheqja e PK-së duhet të marrë masa për të siguruar që zyrtarët policorë të mos mund të refuzojnë të japin deklaratat dhe të nxisë më tej mekanizmat ekzistues të sinjalizimit.
- ✓ EULEX-i inkurajon IPK-në që të përfshijë në protokollet hetimore masa për të siguruar sistematikisht mbledhjen e hershme të deklaratave dhe provave (gjithashtu edhe të natyrës digjitale).
- ✓ EULEX-i gjithashtu inkurajon DHB-në që t'i përmbahet afateve ligjore dhe të shmangë, aty kur është e mundur, mbështetjen në vendimet e gjykatës para se të përfundojë procedurat disiplinore.
- ✓ Prokuroritë themelore duhet të përpiqen t'i japin përparësi rasteve që përfshijnë shkelje nga policia.
- ✓ Prokuroritë themelore nuk duhet të përdorin ndërmjetësimin në rastet që përfshijnë shkelje nga policia.
- ✓ Autoritetet e ndryshme të përfshira në procesin e llogaridhënies duhet të sigurojnë me vetiniciativë që ankuesit të informohen për zhvillimet përkatëse dhe të kenë mundësinë të kontribuojnë me informacione përkatëse.

⁷⁸ Këshilli i Evropës, Raport për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi vizitën në Kosovë* të kryer nga Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose degradues (CPT) nga 6 deri më 16 tetor 2020, shtator 2021, faqja 14, <https://rm.coe.int/1680a3ea32> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

3.2. Dhuna në baza gjinore

3.2.1. Hetimet për dhunën në familje dhe mbrojtja e viktimave dytësore

Sfondi

Përmes një analize të shkurtër të gjashtë rasteve të dhunës në familje të zgjedhura rastësisht në të gjithë Kosovën, EULEX-i ka pasur për qëllim marrjen e një kuptimi fillestar mbi trajtimin e këtyre llojeve të rasteve nga policia dhe prokuroria dhe bashkëpunimin mes tyre. Për këtë analizë, përveç të dhënave të nxjerra nga rastet e përzgjedhura, një pyetësor i strukturuar i kryer me zyrtarë policorë dhe prokurorë të specializuar shërbeu për të siguruar mbledhjen e qëndrueshme të dhënave. Duhet theksuar se, në kohën e hartimit të këtij raporti, PSO e re⁷⁹ që rregullon bashkërendimin dhe bashkëpunimin mes ofruesve të shërbimeve, duke përfshirë policinë dhe prokurorinë, në përputhje me Ligjin e ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore,⁸⁰ ishte ende në procedurë të hartimit. Prandaj, PSO-ja në fuqi u përdor si termë e referencës.

Për më tepër, EULEX-i shqyrtoi aspektin e viktimave dytësore të dhunës në familje me fokus në mbrojtjen e dëshmitarëve fëmijë. Në këtë rast, analiza u nxor nga dy prej gjashtë rasteve të zgjedhura rastësisht, si dhe nga tri raste shtesë të ndjeshme të zgjedhura. Neni 26 i Konventës së Këshillit të Evropës për luftimin dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (e njohur si Konventa e Stambollit) thekson se të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë të gjitha formave të dhunës duhet të merren parasysh, duke përfshirë ofrimin e këshillimit psikosocial të përshtatshëm për moshën. Termi “dëshmitar fëmijë” i referohet jo vetëm fëmijëve që janë të pranishëm gjatë dhunës së ushtruar dhe që janë dëshmitarë të dhunës në mënyrë aktive, por edhe atyre që janë të ekspozuar ndaj britmave dhe zërave të tjerë të dhunës ndërsa fshihen afër ose që janë të ekspozuar ndaj pasojave afatgjata të një dhune të tillë.⁸¹

Gjetjet

Lidhur me bashkëpunimin mes policisë dhe prokurorisë në hetimin e rasteve të dhunës në familje, pesë prokurorë dhe zyrtarë policorë të specializuar rajonalë nga e gjithë Kosova⁸² raportuan njëzëri për marrëdhënie efikase dhe funksionale, një gjetje e konfirmuar edhe nga të anketuarit me pyetësor. Dy prokurorë ndanë vërtetimin e tyre se hetuesit policorë të specializuar në rastet e dhunës në familje caktohen shumë shpesh edhe në raste të tjera. Kjo çon në sforcimin e kapaciteteve të tyre dhe në pjesëmarrjen e zyrtarëve policorë jo të specializuar në vendin e ngjarjes.⁸³ Të dhënat e nxjerra prej gjashtë rasteve të dhunës në familje të përzgjedhura rastësisht tregojnë një përparim në kohë të këtyre rasteve dhe një angazhim të fortë për të mbrojtur viktimat. Konkretisht, në pesë prej gjashtë rasteve, hetuesi i PK-së i specializuar për rastet e dhunës në familje mori pjesë në vendin e ngjarjes; në një rast, zyrtari kujdestar ishte i pranishëm. Ndihma mjekësore iu ofrua viktimave në katër nga gjashtë rastet, ndërsa në një rast nuk ishte e nevojshme dhe në rastin tjetër viktimat ishin veçse të shtruar në spital. Në të gjashtë rastet, PK-ja raportohet se njoftoi Zyrën për mbrojtje dhe ndihmë për viktimat (ZMNV). Megjithatë,

79 PSO për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.

80 Ligji nr. 08/L -185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore, 12 tetor 2023, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=83131>.

81 Këshilli i Evropës, Raporti shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011, neni 26, paragrafi 144, <https://eige.europa.eu/resources/Explanatory%20report.pdf> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

82 Gjilan, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Mitrovicë.

83 Prokurorët nga Peja dhe Gjilani.

në asnjë prej rasteve shërbimet e ZMNV-së nuk kontaktuan viktimën. Në pesë nga gjashtë rastet, PK-ja njoftoi Qendrën për mirëqenie sociale, e cila iu drejtua viktimës në të gjitha rastet; në një rast, nuk u kërkua një ndërhyrje e tillë. Në pesë nga gjashtë rastet, PK-ja ia dorëzoi prokurorisë njoftimin fillestar në lidhje me rastin brenda 24 orëve;⁸⁴ në një rast, nuk u kërkua një ndërhyrje e tillë. Përsëri, në pesë nga gjashtë rastet, kallëzimi penal iu dorëzua prokurorisë brenda 48 orëve; në një rast, dorëzimi zgjati tri javë. Në rastin e fundit, viktimat u largua nga strehimorja për viktimat e dhunës në familje pas tri ditësh për t'u kthyer në shtëpinë e saj martesore jashtë vendit dhe më pas u pajtua me bashkëshortin e saj pasi kishte tërhequr kallëzimin e saj.⁸⁵ Në pesë nga gjashtë rastet, PK-ja e informoi viktimën për mundësinë për t'u mbrojtur në një strehimore për viktimat e dhunës në familje.⁸⁶ Katër nga gjashtë viktimat zgjodhën të ktheheshin në shtëpinë e tyre martesore ose prindërore.

Lidhur me mbrojtjen e të miturve si viktimat dytësore të dhunës në familje, në dy nga gjashtë rastet e përzgjedhura rastësisht, fëmijët kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje që ushtrohej ndaj nënave të tyre. Po kështu, fëmijët kanë qenë dëshmitarë të dhunës në të tri rastet e ndjeshme të përzgjedhura më tej. Edhe pse në asnjë nga rastet fëmijët nuk ishin shënjestër e drejtpërdrejtë fizike e autorit të veprës (në të gjitha rastet baballarët e tyre), ata e kanë parë dhunën nga një distancë e afërt ose kanë qenë të pranishëm në familjen ku ka ndodhur abuzimi.

EULEX-i vërejti se, si viktimat kryesore, nënat ishin në qendër të konsideratave mbrojtëse të prokurorëve, ndërsa prokurorët kishin një referencë shumë të kufizuar për fëmijët e përfshirë. Në një rast, EULEX-i kuptoi vetëm nga dokumentet e hetimit të ofruara se kishte edhe fëmijë që kishin qenë dëshmitarë të dhunës nga afër. Në dy nga rastet e ndjeshme, prokurori fillimisht nuk e dinte vendndodhjen e fëmijëve, duke supozuar se të afërmit ishin kujdesur për ta. Në një rast, kujdestaria e fëmijës iu besua babait, i cili ishte subjekt i një urdhri kufizues për shkak të dhunës në familje dhe kishte një histori të gjatë keqtrajtimi. Mbetet e dyshimtë nëse ky vendim ishte në interesin më të mirë të fëmijëve. Përveç kësaj, një vendim i tillë e mundëson thellimin e mëtejshëm të frikësimit nga babai ndaj nënës përmes referimit në mjete gjyqësore, gjë që përsëri nuk është në interesin më të mirë të fëmijëve.

Rekomandime

- ✓ Duke pasur parasysh rëndësinë e zyrtarëve policorë të specializuar që punojnë në rastet e dhunës në familje, EULEX-i u bën thirrje hetuesve policorë të specializuar për rastet e dhunës në familje që gjithmonë t'i japin përparësi këtyre rasteve, para se të caktohen në lloje të tjera të hetimeve. Prandaj, EULEX-i i bën thirrje gjithashtu PK-së që të sigurojë burimet e nevojshme që kjo të mundësohet.
- ✓ Meqenëse duket se njohja gjithnjë në rritje e ndikimit traumatik të dhunës në familje të fëmijët ende nuk është njohur plotësisht nga sistemi i drejtësisë i Kosovës, EULEX-i i bën thirrje PK-së dhe prokurorëve që të përmirësojnë qasjet e ndjeshme ndaj fëmijëve dhe të njohin plotësisht ndikimin traumatik të dhunës në familje të fëmijët në rastet kur ata janë viktimat dytësore.

⁸⁴ Në një rast zgjati tri ditë, vetëm sepse rasti u raportua nga spitali ku viktimat mori trajtim mjekësor.

⁸⁵ Pavarësisht kësaj, prokuroria përgatiti aktakuzë.

⁸⁶ Në një rast, kjo këshillë nuk ishte e zbatueshme.

3.2.2. Vlerësimi i provave në rastet e dhunimit

Sfondi

Rastet që kanë të bëjnë me veprën penale të dhunimit mund të jenë të vështira për t'u gjykuar. Krimi shpesh ndodh në mjedis të mbyllur pa dëshmitarë okularë dhe krimi nuk lë gjithmonë pas vetes prova mjeko-ligjore. Prandaj, aktakuzat për dhunime paraqesin sfidë për gjykatat.

Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përmbajnë detyrime pozitive mbrojtjen e grave dhe vajzave relevante në këtë kontekst. Në veçanti, neni 5 i Konventës së Stambollit përmban detyrimin për të marrë masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të ushtruar kujdesin e duhur për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe ofruar dëmshpërblim për aktet e dhunës të kryera nga aktorë jo-shtetërorë.

Korniza ligjore për veprën penale të dhunimit në Kosovë ka bërë përparim dhe është në përputhje me standardet ndërkombëtare.⁸⁷ Mungesa e pëlqimit nga viktimat është elementi përbërës i veprës penale (neni 227 i KP-së),⁸⁸ i cili është në përputhje me nenin 36 të Konventës së Stambollit.

Në vitin 2022, EULEX publikoi një raport të titulluar “Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë”,⁸⁹ duke ofruar një vlerësim paraprak të gjendjes aktuale në lidhje me trajtimin e rasteve të kualifikuara si dhunim në Kosovë, në aspektin e standardeve ndërkombëtare. Raporti i Monitorimit të Drejtësisë i vitit 2025 ofron një vërtetim më të thellë të vlerësimit të provave në rastet e dhunimit nga ana e gjykatave themelore.

Gjetjet

Për këtë kapitull, EULEX-i ka shqyrtuar 11 aktgjykime për akuzat për dhunim (neni 227 i KP-së) të lëshuara nga gjykatat themelore.⁹⁰ Nga rastet e përzgjedhura rastësisht, nëntë rezultuan me lirime nga akuzat dhe dy me shpallje fajtor. Të gjithë të pandehurit ishin burra të rritur, dhe të gjitha palët e dëmtuara ishin gra të rritura. Përveç kësaj, statistikave në vijim, që lidhen me periudhën nga janari 2023 deri në qershor 2025, të nxjerra nga SMIL dhe nga Drejtori i Departamentit të statistikave të KGJK-së, tregojnë se nga 31 të pandehur të akuzuar për dhunim,⁹¹ 15 të pandehur u liruan nga akuzat, 12 aktakuza u hodhën poshtë dhe katër të pandehur u shpallën fajtor. Kjo përkthehet në një shkallë të shpalljes fajtor prej 16% të numrit të përgjithshëm të aktakuzave të ngritura në atë periudhë raportimi, dhe një shkallë lirimi nga akuza prej 60%.

87 Instrumentet ndërkombëtare përkatëse janë Konventa e Këshillit të Evropës për luftimin dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) dhe KEDNJ.

88 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

89 EULEX, Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, 2022, [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(07.06.2022\)Report_EN.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(07.06.2022)Report_EN.pdf).


90 Nga 11 rastet, pesë janë nga GjTh e Prishtinës, dy nga GjTh e Prizrenit, dy nga GjTh e Gjakovës, një nga GjTh e Ferizajt dhe një nga GjTh e Pejës.

91 Disa aktakuza kishin vepra penale të ndërlidhura përveç akuzave për dhunim.

Trajtimi i rasteve të kualifikuara si dhunim në Kosovë

Gjykata Themelore	Numri i rasteve	Numri i të dyshuarve	Numri i të pandehurve të shpallur fajtorë për akuza për dhunim	Numri i të pandehurve të liruar nga akuzat për dhunim	Numri i aktakuzave të hedhura poshtë
2025					
GJTH Prishtina	1	1	0	0	1
GJTH Gjilan	0	0	0	0	0
GJTH Prizren	0	0	0	0	0
GJTH Mitrovicë	2	4	0	0	4
GJTH Pejë	0	0	0	0	0
GJTH Ferizaj	1	1	0	1	0
GJTH Gjakovë	1	1	0	1	0
Gjithsej për vitin	5	7	0	2	5
2024					
GJTH Prishtina	5	6	1	3	2
GJTH Gjilan	0	0	0	0	0
GJTH Prizren	6	7	2	4	1
GJTH Mitrovicë	2	2	0	0	2
GJTH Pejë	0	0	0	0	0
GJTH Ferizaj	1	2	0	2	0
GJTH Gjakovë	0	0	0	0	0
Gjithsej për vitin	14	17	3	9	5
2023					
GJTH Prishtina	3	3	1	2	0
GJTH Gjilan	0	0	0	0	0
GJTH Prizren	0	0	0	0	0
GJTH Mitrovicë	0	0	0	0	0
GJTH Pejë	0	0	0	0	0
GJTH Ferizaj	1	1	0	1	0
GJTH Gjakovë	2	3	0	1	2
Gjithsej për vitin	6	7	1	4	2
GJITHSEJ	25	31	4	15	12

Trajtimi i rasteve të cilësuara si dhunime në Kosovë



Duke u bazuar në shqyrtimin e aktgjykimeve, EULEX-i analizoi se si gjykatat i kanë vlerësuar provat e rasteve, siç janë referuar në arsyetimet e gjykatave dhe janë vlerësuar kundrejt nocioneve të paracaktuara rreth dhunimit, të njohura edhe si ‘mite mbi dhunimin’.⁹²

Deklaratat e të pandehurit dhe të palës së dëmtuar janë shpesh provat qendrore në rastet e dhunimit, ndërsa provat vërtetuese rrallë mbledhen ose rrallë janë të disponueshme. Për të vlerësuar se sa të besueshme janë deklaratat e tilla, gjykata duhet të vlerësojë disa elemente si tregues të besueshmërisë. Rëndësi duhet t’i jepet përmbajtjes së deklaratës dhe jo përshtypjes së përgjithshme të personit që jep deklaratën, ose faktorëve të tjerë joverbal, duke pasur parasysh se nuk duhet pritur ndonjë sjellje të veçantë nga viktimat. Përveç deklaratave të palëve, gjykata duhet të vlerësojë provat e tjera të paraqitura. Gjatë vlerësimit të deklaratës, gjykata duhet të marrë në konsideratë nëse faktet e përshkruara nga i dëmtuari, i pandehuri ose dëshmitari mbështeten me prova të tjera, si prova materiale dhe/ose deklarata të tjera, bazuar në kritere objektive. Shpesh, provat e tërthorta i mbështesin por edhe nuk i mbështesin deklaratat e palëve për atë që ka ndodhur.

Meqenëse dëshmitarët okularë të krimit janë të rrallë, deklaratat e dëshmitarëve që kanë bashkëvepruar me palët, dhe më e rëndësishmja me palën e dëmtuar, mund të jenë të vlefshme. Informacioni i dhënë nga pala e dëmtuar menjëherë pas incidentit, përveç vrojtimeve të vetë dëshmitarit, si për sjelljen dhe reagimet e palës së dëmtuar, në disa raste mund të përbëjë prova vërtetuese për deklaratën e palës së dëmtuar.

Gjatë vlerësimit të provave, veçanërisht deklaratës së palës së dëmtuar, është e rëndësishme që gjykata të ketë parasysh se jo të gjitha viktimat e dhunimit reagojnë njësoj. Reagimet mund të mos jenë gjithmonë në përputhje me atë që gjykata ose të tjerët e konsiderojnë racionale. ‘Ndërsa disa viktimat mund të reagojnë me një reagim ‘luftë’, d.m.th. duke u përpjekur të luftojnë sulmuesin dhe/ose të thërrasin për ndihmë, një reagim shumë i zakonshëm ndaj dhunimit është i ashtuquajti përgjigje me ‘ngrirje’. Kjo përgjigje nënkupton që viktimat nuk reziston,

⁹² Burt, Martha R., “Mitet dhe mbështetja kulturore për dhunimin”, shkurt 1980, Revista për personalitetin dhe psikologjinë sociale: 38 (2): 217-230. Mitet për dhunimin janë “besime paragjyquese, stereotipike dhe të pavërteta në lidhje me dhunimin, viktimat e dhunimit dhe dhunuesit” të cilat krijojnë “klime armiqësore ndaj viktimave të dhunimit”.

nuk thërret për ndihmë ose nuk përpiqet të luftojë sulmuesin.⁹³ Është e domosdoshme që një viktimë që deklaron se nuk e ka luftuar sulmuesin, ose që nuk ka bërë titur për ndihmë, të mos keqkuptohet sikur ka dhënë pëlqimin për aktin. Kjo vlen edhe nëse krimi ndodh në një situatë ku thirrja për ndihmë do të ishte e mundur, d.m.th. në një apartament me njerëz brenda.⁹⁴

Meqë krimi i dhunimit mund të jetë i dhunshëm, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe legjislacioni i Kosovës përcaktojnë se elementi përbërës është mungesa e pëlqimit dhe nuk kërkojnë dhunë ose forcë si elemente përbërëse të veprës penale.⁹⁵ Prandaj, mungesa e lëndimeve trupore nuk tregon se nuk ka ndodhur krim. Akti i depërtimit vaginal, i cili është forma më e zakonshme e dhunimit, nuk rezulton domosdoshmërisht në lëndime në rajonin gjenital. Mungesa e lëndimeve, gjenitale ose të tjera, siç përshkruhet në një raport mjeko-ligjor dhe/ose gjinekologjik, nuk mund të konsiderohet më vete si provë e mungesës së krimit.⁹⁶ Raporte të tilla duhet të vlerësohen në aspektin e provave të tjera të ofruara, siç është deklarata e palës së dëmtuar.

Në gjashtë prej 11 rasteve të analizuara, mungesa e lëndimeve fizike në rajonin gjenital u theksua nga gjykata si një nga arsyet për lirim nga akuzat. Në të gjitha rastet, dhuna e përshkruar nga pala e dëmtuar nuk do të çonte domosdoshmërisht në lëndime të tilla (domethënë, gjakderdhja vaginale ose dhimbja ekstreme gjenitale nuk u cekën). Në pesë raste, lëndime të tjera trupore u dokumentuan. Këto lëndime ishin në një masë të madhe në përputhje me mënyrën se si pala e dëmtuar përshkroi se si i pandehuri e kishte lënduar atë, gjë që duhet t'i kishte dhënë besueshmëri deklaratës së saj. Edhe pse konkluzioni përfundimtar i gjykatave në secilin rast nuk bazohej vetëm në mungesën e lëndimeve gjenitale, konstatimi se mungesa e lëndimeve të tilla theksohet në vendimet e lirimimit nga akuzat sugjeron që gjykatat janë të paktën pjesërisht të ndikuara nga stereotipet dhe nocioni i pavërtetë se dhunimi duhet të rezultojë në lëndime gjenitale, pjesë e atij grupi të nocioneve të paracaktuara rreth dhunimit të referuara si 'mite për dhunimin'. Si konfirmim se 'mitet e dhunimit' ekzistojnë në gjykatat në Kosovë, në një nga rastet që përfundoi me lirim nga akuzat, aktgjykimi i gjykatës theksoi se "aktet e dhunimit zakonisht shoqërohen me shenja në trup".

Në tri prej rasteve të analizuara, në vlerësimin e deklaratës gjykatat morën parasysh që pala e dëmtuar nuk kishte thirrur për ndihmë dhe as nuk kishte rezistuar fizikisht të pandehurit. Gjykata e konsideroi deklaratën e palës së dëmtuar si të paqëndrueshme, duke vënë në dukje se, ndërsa ajo pohoi se nuk kishte dhënë pëlqimin për marrëdhënie seksuale, ajo gjithashtu deklaroi se as nuk kishte thirrur për ndihmë pavarësisht pranisë së njerëzve të tjerë aty pranë, as nuk i kishte rezistuar fizikisht sulmuesit dhe as nuk kishte reaguar. Ky arsyetim ishte aplikuar edhe kur pala e dëmtuar shpjegoi se i pandehuri ishte fizikisht më i fortë se ajo, duke shtuar se ishte e frikësuar dhe e ngrirë në situatë. Për më tepër, në një nga rastet që përfundoi me shpallje fajtor, gjykata i vuri shumë theks faktit se pala e dëmtuar kishte rezistuar dhe i kishte thirrur një kallimtar për ndihmë (dhunimi kishte ndodhur brenda një automjeti). Këto gjetje mbështesin më tej idenë se në gjykatat në Kosovë ekziston një tjetër 'mit i dhunimit', përkatësisht që të gjitha viktimat e dhunimit reagojnë duke rezistuar dhe duke thirrur për ndihmë.

Kur bëhet fjalë për deklaratat e palëve, analiza e vendimeve gjyqësore sugjeron që mospërputhjet e konceptuara në deklaratën e palës së dëmtuar ndikojnë në vlerësimin e gjykatës. Në disa

93 GJEDNJ, *MC kundër Bullgarisë*, 2003, nr. 39272/98, paragrafi 164-166, [https://hudoc.echr.coe.int/%20eng-#%22itemid%22:\[%22001-61521%22\]](https://hudoc.echr.coe.int/%20eng-#%22itemid%22:[%22001-61521%22]) dhe CEDAW, *Vertido kundër Filipineve*, 2010, Komunikata nr. 18/2008, 2010, <https://juris.ohchr.org/casedetails/1700/en-US>.

94 Amnesty International, *Koha për ndryshim: Drejtësi për të mbijetuarit e dhunimit në shtetet nordike*, 2019, f. 54, <https://www.amnesty.org/en/documents/eur01/0089/2019/en/>.

95 Kodi Penal, 06/L-074, 14 janar 2019, neni 227, paragrafi 1, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>: "Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë [...]".

96 Universiteti i Birminghamit, *Mungesa e lëndimeve të ndërlidhura seksualisht nuk do të thotë që viktima e dhunimit ka 'trilluar'*, 6 tetor 2023, <https://www.birmingham.ac.uk/news/2023/lack-of-sexually-related-injuries-does-not-mean-rape-victim-was-making-it-up> (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

raste, gjykata e konsideroi deklaratën e palës së dëmtuar si kontradiktore dhe për këtë arsye jo të besueshme, për arsye që nuk bazoheshin në kritere objektive. Për shembull, në një rast, pala e dëmtuar ishte dërguar me makinë në një zonë të largët, ku kishte ndodhur dhunimi i pretenduar. Gjukata e konsideroi kontradiktor faktin që ajo nuk mund të kujtonte vendin e saktë të ngjarjes. Në një rast tjetër, gjykata e konsideroi kontradiktor faktin që pala e dëmtuar i kishte dërguar mesazhe të dashurit të saj dhe kishte shkuar në një motel me të, ndonëse deklaroi gjithashtu se kishte patur frikë prej tij dhe se marrëdhënia nuk kishte qenë e mirë në atë moment. Në mënyrë të ngjashme, në një rast gjykata nuk i dha besim një pale të dëmtuar që deklaroi se ishte dhunuar nga i dashuri i saj, sepse çifti kishte pasur marrëdhënie seksuale më parë. Këto qasje janë gjithashtu dëshmi të stereotipeve dhe paragjykimeve ekzistuese që ndikojnë në një vlerësim të paanshëm të fakteve të paraqitura.

Kur bëhet fjalë për provat e tërthorta, u vu re se gjykata në dy raste e shpërfilli plotësisht deklaratën e miqve dhe familjarëve të palës së dëmtuar, të cilët ajo i kishte kontaktuar menjëherë pas incidentit. Deklaratës së tyre në lidhje me atë që kishte thënë pala e dëmtuar, si dhe gjendjen e saj mendore në atë kohë, nuk iu dha asnjë vlerë gjatë vlerësimit të të gjitha provave. Arsyja në të dyja rastet ishte se ata nuk ishin dëshmitarë okularë të dhunimit të pretenduar. Ndërsa deklarata e dëshmitarit okular është shpesh më e vlefshme se provat e tërthorta, ajo shpesh nuk është e disponueshme në rastet e dhunimit dhe provat e tërthorta mund të përbëjnë prova mbështetëse thelbësore.

Në një çështje penale, është detyrë e gjykatës të vlerësojë provat për të parë nëse vepra penale është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Nëse provat nuk e arrijnë atë prag dhe i pandehuri lirohet nga akuzat, kjo nuk do të thotë që pala e dëmtuar po gënjente. Ajo që mund të ketë ndodhur, jashtë fushëveprimit të aktakuzës, nuk është detyrim i gjykatës të komentojë. Megjithatë, në analizën e aktgjykimeve, EULEX-i vuri re se, në aktgjykimet për lirim nga akuzat, gjykata ndonjëherë përdorte shprehje të tilla si “konfirmohet se nuk ka pasur marrëdhënie seksuale në atë kohë”. Përveç se shkon përtej fushëveprimit të një gjykimi penal, kjo tregon gjithashtu një shpërfillje të deklaratës së palës së dëmtuar dhe nënkupton se ajo gënjeu para autoriteteve gjyqësore, duke shkaktuar ritraumatizim dhe riviktimizim të mundshëm. Po kështu, në shumë raste, gjykata theksoi në arsyetim se “nuk iu dha kurrfarë besimi deklaratës së palës së dëmtuar, pasi ajo nuk mbështetet me asnjë provë tjetër”. Gjersa është e drejtë të jepet një lirim nga akuzat kur ka mungesë të plotë të provave mbështetëse, Konventa e Stambollit synon përdorimin e ndjekjeve penale pa viktimë dhe u kërkon autoriteteve prokuroriale dhe gjyqësore të Kosovës të sigurojnë që procedurat penale që lidhen me dhunën seksuale të mos varen tërësisht nga një raport ose ankesë nga viktimë dhe të mund të vazhdojnë edhe nëse viktimë tërheq deklaratën ose ankesën e saj.⁹⁷ Konventa e Stambollit promovon përdorimin e të gjitha formave të disponueshme të provave, jo vetëm deklaratën e viktimës, për të kompletuar një rast, duke përfshirë, përveç provave mjekësore, edhe provat digjitale (mesazhe me tekst, telefonata, foto etj.). Konventa e Stambollit e kërkon këtë për të zvogëluar varësinë nga viktimat e traumatizuara ose të pavullnetshme, për të rritur mbrojtjen e viktimave dhe për të përmirësuar shkallën e dënimeve.

Si përfundim, analiza e 11 aktgjykimeve nga gjykatat në të gjithë Kosovën tregon se nocionet e paracaktuara rreth dhunimit dhe stereotipet ndikojnë në vlerësimin e provave. Këto supozime të pasakta mund të rezultojnë në gjykime të gabuara, ri viktimizim dhe mungesë besimi në gjyqësor. Përveç kësaj, ato janë në kundërshtim me instrumentet ligjore ndërkombëtare, si Konventa e Stambollit, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) dhe KEDNJ.

⁹⁷ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011, neni 55, paragrafi 1, <https://rm.coe.int/168008482e>.

Rekomandime

- ✓ Duke marrë parasysh se gjetjet tregojnë se në gjykatat në Kosovë ekzistojnë bindje paragjyquese, stereotipe dhe të pavërteta rreth dhunimit, EULEX-i inkurajon KGJK-në që të ofrojë trajnime për gjyqtarët për vlerësimin e provave në rastet e dhunimit, duke përfshirë trajnime për përgënjeshttrimin e ‘miteve të dhunimit’.
- ✓ Për shkak të përdorimit të vërejtur të nocioneve paragjyquese gjatë vlerësimit të provave, EULEX-i u bën thirrje gjykatave që gjithmonë të kenë parasysh faktet e njohura në lidhje me dhunimin dhe reagimet e viktimës.
- ✓ Në përputhje me Konventën e Stambollit, e cila promovon përdorimin e të gjitha formave të disponueshme të provave në rastet e dhunimit, gjykatat duhet të vlerësojnë me kujdes të gjitha provat dhe të mos i shpërfillin provat e tërthorta.
- ✓ EULEX-i i inkurajon gjykatat që merren me rastet e dhunimit që të hartojnë me kujdes aktgjykimet, duke u përqendruar në atë që është dëshmuar në lidhje me aktakuzën dhe të shmangin marrjen e qëndrimit kundër palës së dëmtuar.

3.2.3. Drejtësi miqësore për fëmijët në rastet e dhunës seksuale me viktima të mitura

Sfondi

Në raportet e mëparshme të monitorimit të drejtësisë, EULEX-i ka vënë në pahë progresin e bërë nga Kosova në përafrimin e kornizës dhe praktikës së saj ligjore me kërkesat e Konventës së Stambollit.⁹⁸ Si dokument i rëndësishëm për aktorët në zinxhirin e drejtësisë penale, Protokoli shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale u miratua me vendimin e Qeverisë nr. 11/109 të datës 23 nëntor 2022. Protokoli, i hartuar me mbështetjen e EULEX-it, përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt zbatimit të detyrimeve sipas Konventës së Stambollit, si dhe Strategjisë kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026. Ai përshkruan hapat që duhen ndërmarrë nga autoritete të ndryshme në rastet e dhunës seksuale me qëllim standardizimin e këtyre proceseve.⁹⁹

Paralelisht me hapjen e paraparë të qendrave të referimit për dhunën seksuale dhe themelimin e ekipeve të reagimit ndaj sulmeve seksuale në të gjithë Kosovën, vrojtimet në vijim jepen në kuadër të mekanizmave aktualë në dispozicion, me fokus në drejtësinë miqësore për fëmijët në rastet e dhunës seksuale ndaj fëmijëve, veçanërisht intervistimin e fëmijëve dhe video-incizimin e këtyre intervistave.¹⁰⁰ Sipas nenit 112, paragrafi 4 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), fëmija viktimë nuk mund të intervistohet më shumë se dy herë gjatë gjithë procedurës penale, që përfshinë të gjitha fazat nga hetimi deri në gjykim. Sipas nenit 112, paragrafi 4.1, kjo intervistë drejtohet nga prokurori. KDM përcakton gjithashtu në nenin 112, paragrafi 8, video-incizimin e deklaratave të viktimës që do të përdoren si provë.

98 EULEX, Raporti i Monitorimit të Drejtësisë, 2024, f. 46, [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(11.11.2024\)EU%20Rule%20of%20Law%20Mission%20Justice%20Monitoring%20Report%202024.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(11.11.2024)EU%20Rule%20of%20Law%20Mission%20Justice%20Monitoring%20Report%202024.pdf) (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

99 Protokoli shtetëror për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, 2022, nr. 11/109, <https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/8C3ACF03-4387-453D-942A-AC5B38B00838.pdf>.

100 Udhëzimi administrativ 02/2021 për zbatimin e drejtësisë miqësore për fëmijë në procedurat penale, civile dhe administrative e përcakton (në nenin 3) drejtësinë miqësore për fëmijë si “sistemin e drejtësisë që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, ku konsideratë mbizotëruese është interesi më i mirë i fëmijës, trajtimi i barabartë, mos diskriminimi, mbrojtja e dinjitetit dhe pjesëmarrja e fëmijës duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanave të rastit. Në veçanti, është drejtësi e qasshme, e përshtatshme për moshën, e shpejtë, e saktë, e cila ju përshtatet dhe fokusohet në nevojat dhe të drejtat e fëmijës, që respekton të drejtat e fëmijës, që përfshinë të drejtën për proces të rregullt ligjor, të drejtën për të marrë pjesë dhe për të kuptuar procedurat, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të drejtën për integritet dhe dinjitet”.

Gjetjet

Në qershor dhe korrik 2025, EULEX-i u takua me prokurorët për të mitur në të shtatë Prokuroritë Themelore në Kosovë. Si vërtetim i përgjithshëm, pajisjet, niveli dhe operacionalizimi i dhomave të intervistave miqësore për fëmijë janë të ndryshme. Ndërsa në disa lokacione, dhomat ishin vënë në funksion dhe në përdorim,¹⁰¹ në të tjerat ato përdorshin më pak.¹⁰²

Disa nga prokurorët treguan se ata iu jepnin avokatëve mbrojtës mundësinë për të vëzhguar intervistën nëpërmjet video-lidhjes nga një dhomë tjetër në ambientet e gjykatës. Megjithatë, kjo praktikë nuk është konsistente. Në rastet kur kjo mundësi ofrohet, prokurori zakonisht do t'i japë avokatit mbrojtës mundësinë për të propozuar pyetje që do të bëhen nga prokurori. Kjo përfshirje e mbrojtjes siguron që të gjitha pyetjet përkatëse të bëhen në fazën kur kujtimet janë të freskëta dhe bën të mundur bërjen e pyetjeve pasuese në vend. Në këtë mënyrë, kundërshtimi i paarsyeshëm i deklaratave të viktimës nga mbrojtja në gjykatë është më pak i mundshëm.

Asnjë nga PTH nuk raportoi të kishte video-incizuar intervistat e viktimave ose të kishte përdorur deklaratat të tilla si prova, siç përcaktohet nga KDM. Mungesa e pajisjeve të përshtatshme u përmend disa herë, por shpesh nuk kishte asnjë arsye të artikuluar. Intervistat duket se nuk incizohen sepse nuk është praktikë e zakonshme. Si rezultat, meqenëse nuk janë paraqitur prova të video-incizuara, nuk ka përvojë në përdorimin e regjistrimeve si prova në gjykata.

Megjithatë, në mesin e prokurorëve për të mitur ekzistonte një konsensus se video-incizimi i deklaratave të viktimave do të ishte provë e fuqishme.¹⁰³ Përveçse do të ishte i fuqishëm si provë, video-incizimi do të zvogëlonte ndjeshëm ritraumatizimin e mundshëm të viktimave gjatë intervistës së dytë dhe mundësinë që viktimat të ndryshojnë deklaratat e tyre për shkak të presionit të papërshtatshëm nga familjet ose të dyshuarit. Nëse avokati mbrojtës do të përfshijë gjatë intervistës së parë, të drejtat e të akuzuarit do të mbroheshin më mirë pasi çdo ndikim i padrejtë do të bëhej i dukshëm në incizim, dhe mbrojtja do të kishte një mundësi reale për t'i paraqitur pyetjet për viktimën.

Vlen të përmendet se KDM thekson se intervista e parë “duhet të” drejtohet nga prokurori dhe “mund” të përdoret si provë. Ndërsa incizimi i deklaratave është diskrecionare, detyra e prokurorit për të drejtuar intervistën e parë është e qartë. Sipas vërtetimeve nga monitorimi, ky rregull nuk ndiqet gjithmonë dhe zyrtarët policorë shpesh kryejnë intervista pa praninë e prokurorit. Kjo praktikë, ndërsa shkon kundër kërkesave të KDM, raportohet të jetë rezultat i aranzhimit aktual të punës dhe presionit të ngarkesës me raste.

Lidhur me pajisjet e nevojshme, prokurorët përmendën mungesën e pajisjeve të përshtatshme për të incizuar intervistat. Kjo mund të korrigjohet me zgjidhje të thjeshta, siç janë ueb-kamerat me internet dhe laptopët, duke i mundësuar kështu prokurorit të jetë mobil për të kryer intervista në një vend tjetër nëse është e nevojshme.

Problemi i vazhdueshëm i rigjykrimeve, i cili është theksuar në raportin e monitorimit të drejtësisë të vitit 2024 si një problem që prek edhe rastet e të miturve,¹⁰⁴ ka pasoja potencialisht të dëmshme. Prokurorët për të mitur vunë re se nëse një rast dërgohet për rigjykim nga Gjykata e Apelit, kjo mund të çojë në shkelje të kërkesave të KDM për kufizimin e intervistave të fëmijëve. Në disa raste, për të mbrojtur viktimat nga ritraumatizimi dhe për të shmangur një shkelje të drejtpërdrejtë të ligjit, prokurorët raportuan se kanë refuzuar të intervistojnë viktimat në rigjykim. Meqenëse gjykata i regjistron intervistat fjalë për fjalë në procesverbal, një marrje tjetër në pyetje në rigjykim mund të duket e panevojshme.

101 Gjilan, Gjakovë, Ferizaj, Pejë.

102 Prizren, Mitrovicë, Prishtinë. Në Mitrovicë, PTH është e vendosur në objekt me qira dhe për këtë arsye nuk ka një dhomë të vetën. Në Prishtinë, dhomat përdoren, por intervistat zhvillohen në zyrat e prokurorëve.

103 Një prokuror iu referua një video-incizimi si “mbretëresha e provave”.

104 EULEX, Raporti i Monitorimit të Drejtësisë, 2024, f. 46, [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(11.11.2024\)EU%20Rule%20of%20Law%20Mission%20Justice%20Monitoring%20Report%202024.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(11.11.2024)EU%20Rule%20of%20Law%20Mission%20Justice%20Monitoring%20Report%202024.pdf) (qasur për herë të fundit më 12 shtator 2025).

Në disa rajone, u theksua edhe mungesa e psikologëve mjekoligjorë të kualifikuar për të marrë pjesë në intervista dhe seanca gjyqësore. Mungesa ose disponueshmëria e kufizuar e psikologëve të specializuar mjekoligjorë çon në vështirësi për caktimin e seancave, veçanërisht nëse ata duhet të zëvendësohen nga rajone të tjera dhe në rastin më të keq intervista zhvillohet pa praninë e një psikologu.

Rekomandime

- ✓ EULEX-i inkurajon KPK-në dhe Ministrinë e Drejtësisë që të vënë në dispozicion dhe në funksion dhoma intervistash miqësore për fëmijë në të gjitha PTH dhe të sigurojnë pajisje teknike të përshtatshme për audio-incizime dhe video-incizime në dispozicion për regjistrimin e deklaratave të viktimave.
- ✓ Duke marrë parasysh që asnjë nga PTH nuk ka mbajtur intervista të video-incizuara me viktimat dhe as nuk ka përdorur deklaratat tilla si prova, EULEX-i i kërkon KPK-së të organizojë seanca për ndërtimin e kapaciteteve për të zhvilluar praktikën prokuroriale për përdorimin e plotë të pajisjeve të video-incizimit.
- ✓ Në mënyrë të ngjashme, prokurorët duhet të paraqesin dhe të përdorin deklaratat e regjistruara në video si prova.
- ✓ EULEX-i inkurajon Ministrinë e Drejtësisë që të sigurojë disponueshmërinë e psikologëve të akredituar në të gjitha rajonet për intervistat e fëmijëve viktimë.

3.3. Krimet sipas të drejtës ndërkombëtare

Sfondi

Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe i krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare¹⁰⁵ është detyrim për të drejtat e njeriut dhe komponentë thelbësore e drejtësisë tranzicionale në Kosovë dhe në rajon. Kur autoritetet duhet të angazhohen të ofrojnë drejtësi për viktimat, respektimi i standardeve të gjyqimit të drejtë është po aq i rëndësishëm për të fuqizuar besimin e të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë në institucione.

EULEX-i shqyrtoi zhvillimet e fundit në aspektin e aktiviteteve prokuroriale dhe gjyqësore në këtë fushë dhe nënvizoi disa aspekte në administrimin e rasteve të monitoruara të cilat meritojnë vëmendje pasi ato ngrenë shqetësime për të drejtat e njeriut.

Gjetjet

Lidhur me aktivitetin prokurorial, EULEX-i vëren pozitivisht se Departamenti i hetimit të krimeve të luftës në Prokurorinë Speciale kishte katër prokurorë gjatë gjithë periudhës së raportimit. Bazuar në shifrat më poshtë, mund të konkludohet se si Prokuroria Speciale ashtu edhe PK-ja i trajtuan krimet e luftës si përparësi operative.

¹⁰⁵ Krimet e luftës kundër popullatës civile janë shkelje të rënda të ligjeve të luftës që drejtpërdrejt shënjestrojnë ose dëmtojnë civilët (personat që nuk marrin pjesë aktive në luftime, përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët). Shembujt përfshijnë vrasjen, torturën, marrjen e pengjeve, shkeljet e dinjitetit personal, në veçanti trajtimin poshtërues dhe degradues, etj. Krimet e tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare përfshijnë gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit - të cilat janë vepra penale të kryera si pjesë e sulmeve të gjera ose sistematike të drejtuara kundër popullatës civile, dhe përfshijnë akte si vrasja, skllavërimi, dëbimi, tortura dhe dhuna seksuale, etj.

Në vitin 2024, u ngritën 14 aktakuza¹⁰⁶ dhe u kryen nëntë arrestime. Nga numri i përgjithshëm i aktakuzave të ngritura atë vit, shtatë ishin në mungesë¹⁰⁷ kundër 64 individëve, ndërsa shtatë të tjerat kishin të bënin me individë që ishin në paraburgim dhe do të përballen me gjykim me prani. Në përgjithësi, pavarësisht ngarkesës së vazhdueshme me raste dhe kompleksitetit të tyre, një numër relativisht i lartë i aktakuzave është ngritur, duke sinjalizuar një aktivitet në rritje krahasuar me vitet e mëparshme.

Ky trend pozitiv vazhdoi në vitin 2025 kur në gjashtë muajt e parë, prokuroria ngriti gjashtë aktakuza të reja në lidhje me krime lufte. Katër prej tyre janë në mungesë, ndërsa dy aktakuza kanë të bëjnë me individë që ishin në paraburgim dhe do të përballen me gjykim me prani nëse aktakuza konfirmohet. Gjithashtu, në vitin 2025 u kryen pesë arrestime për krime lufte. Fatkeqësisht, nuk pati zhvillime pozitive në lidhje me bashkëpunimin rajonal, veçanërisht me Serbinë.

Lidhur me aktivitetin gjyqësor, në vitin 2024, GJTH e Prishtinës trajtoi 28 raste të krimeve të luftës në faza të ndryshme të procedurave. Aktgjykime të rëndësishme të lëshuara atë vit përfshinin aktgjykime për fajësi kundër Muhamet Alidemaj, Ekrem Bajrović dhe Čedomir Aksić (i gjykuar në mungesë), si dhe një lirim nga akuzat për Zlatan Arsić, i cili më vonë u konfirmua në shkallën e apelit. Dy aktgjykime për fajësi (Duško Arsić dhe Časlav Jolić) u kthyen për rigjykim nga GjA. Në gjysmën e parë të vitit 2025, aktgjykimet e shkallës së parë çuan në dy lirime të pjesshme nga akuzat (Zoran Vukotić dhe Časlav Jolić), një lirim të plotë nga akuzat (Gavrilo Milosavljević) dhe dy aktgjykime për fajësi (Dragiša Milenković dhe Živojin Nešić).

Ndërkohë që përparimi në aktivitetet prokuroriale dhe gjyqësore përfaqëson një zhvillim pozitiv për të drejtën e viktimave për drejtësi, në disa raste, EULEX-i konstatoi se administrimi i rasteve ngriti disa shqetësime sipas nenit 5 dhe 6 të KEDNJ-së, veçanërisht në tri aspekte të përshkruara më poshtë.

Shkeljet e afateve për caktimin e shqyrtimit gjyqësor

Gjatë periudhës së raportimit, EULEX-i vërejti me shqetësim vonesat e zgjatura për fillimin e procedurave të shqyrtimit gjyqësor në disa raste. Për shembull, dy raste patën seanca fillestare dëgjimore më 8 dhjetor 2024 dhe 15 janar 2025 përkatësisht, por që nga mesi i korrikut 2025 asnjëra nuk kishte kaluar në fazën e gjykimit kryesor. Sipas KPP-së, i pandehuri mund të paraqesë parashtrësë për kundërshtimin e provave ose për hedhjen poshtë të aktakuzës brenda 30 ditëve nga seanca dëgjimore fillestare. Pasi të paraqitet një parashtrësë e tillë, gjykata duhet t'i japë prokurorit 15 ditë për t'u përgjigjur me shkrim, dhe gjyqtari i vetëm gjykues më pas kërkohet të lëshojë një vendim me shkrim brenda 15 ditëve pas asaj periudhe. Ky vendim mund të apelohej nga secila palë brenda dhjetë ditëve nga dorëzimi i tij. Duke i marrë këto afate¹⁰⁸ së

106 Ky numër përfshin aktakuzën në *Rastin Mejë* e cila u ngrit fillimisht në dhjetor 2023, por më vonë u kthye në Prokurorinë Speciale nga gjykata dhe u ngrit përsëri në vitin 2024 në një formë të ndryshuar.

107 Termi 'aktakuzë në mungesë' nuk përdoret në mënyrë shprehimore në KPP, ndryshe nga termi 'gjykim në mungesë'. Megjithatë, ai u fut në praktikë dhe aktakuzat e ngritura nga Prokuroria Speciale në mungesë të të dyshuarit kanë titullin 'aktakuzë në mungesë'. Ky term tregon se faza e procedurës paraprake (pjesërisht ose tërësisht) u zhvillua në mungesë të të dyshuarit. Gjatë fazës së procedurës paraprake, i dyshuari ka të drejtë të shumëfishta (p.sh., të informohet për akuzat kundër tij, arsyen e akuzimit, të informohet për të gjitha të drejtat e tij, të ketë avokat, të heshtë ose të japë deklaratë, etj.) me detyrime korresponduese për hetuesit dhe prokurorët e rastit. Në rast se i dyshuari është i pranishëm gjatë fazës së procedurës paraprake, mosrespektimi i këtyre detyrimeve do të ishte një shkelje e rëndë e të drejtave, por ky nuk është rasti kur i dyshuari mungon.

108 Dispozitat përkatëse ligjore mbi këto afate mund të gjenden në Kodin e Procedurës Penale, nr. 08/L-032, 17 gusht 2022: neni 240, paragrafi 7.1 (30 ditë për mbrojtjen për të paraqitur kërkesë për kundërshtimin e provave) dhe paragrafi 7.2 (30 ditë për mbrojtjen për të paraqitur kërkesë për rrëzimin e aktakuzës), neni 243, paragrafi 3 (15 ditë për gjykatën për të nxjerrë një vendim për të adresuar kundërshtimin e provave) dhe paragrafi 6 (10 ditë për secilën palë për ta apeluar atë), neni 244, paragrafi 3 (15 ditë për gjykatën për të nxjerrë një vendim për të adresuar kërkesën për rrëzimin e aktakuzës) dhe paragrafi 4 (10 ditë për secilën palë për ta apeluar atë) dhe neni 245, paragrafi 3 (15 ditë për prokurorin për të paraqitur përgjigje si për kundërshtimin e provave ashtu edhe për kërkesën për rrëzimin e aktakuzës), <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>.

bashku, është e qartë se një periudhë më e gjatë ka kaluar pa ndonjë përparim të dy rastet e lartpërmendura. Ndërsa disa vonesa mund të konsiderohen të pashmangshme për shkak të ngarkesës së punës së gjykatës, pasiviteti i zgjatur i gjykatës, veçanërisht kur të pandehurit janë të paraburgosur, mund të ngrejë shqetësime sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, i cili garanton një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. GJEDNJ-ja e ka interpretuar vazhdimisht këtë dispozitë si vendosjen e një detyrimi mbi shtetet për të organizuar sistemet e tyre ligjore për të siguruar procedura me kohë.

Zbulimi i provave shfajësuese dhe përdorimi i dëshmitarvet anonimë

Në përputhje me nenin 47 të KPP-së, prokurorët kanë obligim të marrin në konsideratë si provat fajësuese ashtu edhe ato shfajësuese. Kjo dispozitë krijon një detyrë të objektivitetit për prokurorin që jo vetëm të veprojë si palë, por edhe si mbrojtës i ligjshmërisë dhe drejtësisë së gjykimit. Për më tepër, obligimi i prokurorit, pas ngritjes së aktakuzës, për të paraqitur në gjykatë dosjen e plotë të hetimit në përputhje me nenin 236, siguron parimin e barazisë së armëve, i cili është një element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë të paraparë në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së. Mos zbulimi i provave në gjykatë mund të përbëjë, pra, shkelje të drejtave për proces të rregullt ligjor dhe të dëmtojë integritetin e procesit gjyqësor.

Në një rast të kohëve të fundit për krime lufte, u vu re se disa materiale shfajësuese ishin parashtruar në Prokurorinë Speciale, por nuk ishin dërguar në gjykatë sipas nenit 236 të KPP-së, pasi prokuroria supozoi se duheshin paraqitur vetëm provat që mbështesnin aktakuzën. Ndërsa neni 235 i KPP-së lejon që aktakuza t'i referohet vetëm provave të caktuara, neni 236, paragrafi 1 i KPP-së i ngarkon prokurorisë detyrën që gjykatës t'i dërgojë lëndën komplete të rastit. Çdo material i paraqitur tek Prokuroria Speciale, edhe nëse konsiderohet i parëndësishëm nga prokuroria, bëhet pjesë e lëndës së rastit dhe duhet t'i dërgohet gjykatës, sepse mund të vlerësohet si i rëndësishëm nga kjo e fundit. Në këtë rast, ndërhyrja e gjykatës për të urdhëruar që materiali të shtohet në lëndën e rastit përfundimisht e korrigjoi këtë mangësi, por mosdhënia fillestare, të cilën EULEX e identifikoi edhe në raste të tjera, përbën zbatim të pasaktë të ligjit procedural.

EULEX-i identifikoi gjithashtu shqetësime në lidhje me të drejtën për mbrojtje të njohur nga neni 6, paragrafi 3d, i KEDNJ-së, veçanërisht kur bëhet fjalë për praktikën e prokurorisë për mosdhënien e deklaratave të dëshmitarëve anonimë. Në disa raste, prokuroria fillimisht i mohoi mbrojtjes qasjen në deklaratat e dy dëshmitarëve anonimë, duke arsyetuar se Kodi i Procedurës Penale i jep prokurorit autoritetin për të mos i dhënë ato në rast se ato përmbajnë informacione që potencialisht mund të zbulojnë identitetin e ndonjë dëshmitari, anonimiteti i të cilit është dhënë me vendim gjyqësor. Megjithatë, ky interpretim është i diskutueshëm. Neni 216, paragrafi 1.3 i Kodit të Procedurës Penale sqaron se anonimiteti mbulon vetëm informacionin në lidhje me identitetin ose vendndodhjen e palës së dëmtuar, dëshmitarëve bashkëpunues, dëshmitarëve, etj., por jo të tërë deklaratën. Neni 222 i Kodit të Procedurës Penale në lidhje me fazën e gjykimit kryesor i detyron më tej të gjitha palët të përmbahen nga bërja e pyetjeve që potencialisht mund të zbulojnë identitetin e dëshmitarit anonim. Rrjedhimisht, ligji mbron emrin dhe vendndodhjen e dëshmitarëve, por jo vet deklaratat, për të cilat nuk ka bazë ligjore për të mos iu dhënë mbrojtjes. Mos zbulimi i këtyre deklaratave mund të interpretohet si shkelje e nenit 6, paragrafi 3d, të KEDNJ-së, i cili garanton të drejtën e të pandehurit për të pyetur dëshmitarët që dëshmojnë kundër tij.¹⁰⁹ Mbrojtja duhet të ketë mundësinë t'i dijë, të ketë qasje dhe të komentojë mbi të gjitha provat e paraqitura në gjykatë, duke përfshirë deklaratat e bëra nga dëshmitarët para gjykimit.

¹⁰⁹ GJEDNJ-ja ka vendosur që kjo e drejtë përfshin jo vetëm marrjen në pyetje të tërthortë në gjykim, por edhe qasjen në deklaratat në procedurë paraprake. Në rastin *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ-ja theksoi se kufizimet në të drejtën e përballjes duhet të arsyetohen në mënyrë strikte dhe nuk duhet të komprometojnë drejtësinë e përgjithshme të gjykimit. Në raste si *Keskin kundër Holandës* dhe *Schatschaschwili kundër Gjermanisë*, GJEDNJ-ja sqaroi vazhdimisht se qasja në të gjitha provat është pjesë integrale e procedurave gjyqësore kundërshtare.

Një problem tjetër potencial me disa raste të krimeve të luftës në pritje, kryesisht ato që përfshijnë dhunë seksuale të lidhura me konfliktin, është shpeshtësia e përdorimit të dëshmitarëve anonimë, veçanërisht viktimave, identiteti i të cilëve mbrohet për arsye të sigurisë. Sipas nenit 257, paragrafi 3, të KPP-së, shpallja fajtor nuk mund të bazohet vetëm, ose në shkallë vendimtare, në deklaratën e dëshmitarëve anonimë. Në shumë prej këtyre rasteve, dëshmitari kryesor është viktimë, deklarata e të cilit është thelbësore për të dëshmuar krimin. Megjithatë, kur identiteti i tyre mbetet i fshehur, rasti rrezikon të mos i përmbushë standardet ligjore për gjykim të drejtë, veçanërisht nëse deklarata e viktimës është prova më vendimtare. GJEDNJ-ja e ka trajtuar këtë çështje në disa raste, si *Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar (2011)*, ku GJEDNJ-ja vendosi që ndërsa deklarata anonime dhe të thënat mund të përdoren, ato nuk mund të jenë baza e vetme ose vendimtare për shpallje fajtor. Këto vendime nxjerrin në pah rëndësinë e sigurimit të një ekuilibri midis mbrojtjes së viktimave dhe mbështetjes të së drejtës së të pandehurit për të kundërshtuar provat, duke i bërë këto kufizime thelbësore për mbrojtjen e drejtësisë dhe integritetit të procesit gjyqësor.

Përdorimi sistematik i paraburgimit dhe shqetësimet sipas nenit 5 të KEDNJ-së

Një problem tjetër sistematik i identifikuar nga EULEX-i ka të bëjë me përdorimin e tepërt dhe automatik të paraburgimit. Në rastet e krimeve të luftës, Gjykata Themelore e Prishtinës ka arsyetuar paraburgimin rregullisht dhe automatikisht me arsyen e rrezikut të arratisjes për shkak të shtetësisë së dyfishtë të dyshuarve. Megjithatë, ky arsyetim i përgjithshëm nuk arrin të marrë në konsideratë alternativa më pak kufizuese siç kërkohet nga KPP-ja. Prandaj, nuk është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së në nenin 5 të KEDNJ-së, e cila ka vendosur vazhdimisht se çdo privim nga liria duhet të jetë i jashtëzakonshëm, i domosdoshëm dhe proporcional. Shembuj nga gjykimet e mëparshme të EULEX-it dhe rastet aktuale vendase tregojnë se të pandehurit me shtetësi të shumëfishta që jetojnë në Kosovë të cilët janë liruar nuk kanë ikur. Kjo tregon se vlerësimet individuale të rrezikut janë të realizueshme dhe të domosdoshme për të arritur përputhje me standardet ligjore.

Rekomandime

- ✓ Të shmangët mosveprimi i zgjatur i gjykatës të ndikojë në të drejtën për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata Themelore e Prishtinës duhet të sigurojë përparim me kohë nga seancat fillestare dëgjimore në fazën e gjyimit kryesor.
- ✓ Për të mos shkelur të drejtat për proces të rregullt ligjor dhe për të mos dëmtuar integritetin e procesit gjyqësor, EULEX-i i bën thirrje Prokurorisë Speciale të zbatojë zbulimin e plotë dhe me kohë të provave, duke përfshirë deklaratat shfajësuese dhe anonime të dëshmitarëve, dhe t'ia dërgojë gjykatës lëndën e plotë të rastit, në përputhje me nenin 236 të KPP-së.
- ✓ EULEX-i u bën thirrje gjyqtarëve të procedurës paraprake në Departamentin Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës që të reformojnë praktikën e paraburgimit në mënyrë që të kërkojnë vlerësime individuale të mbështetura me prova konkrete, dhe të zbatojnë masa alternative sa herë që ato janë të mjaftueshme, bazuar në proporcionalitet dhe domosdoshmëri.
- ✓ Lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimeve të luftës kundër popullatës civile dhe të krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare, institucionet e Kosovës inkurajohen të kërkojnë mënyra për të forcuar bashkëpunimin rajonal dhe angazhimin ndërkombëtar, veçanërisht me Serbinë.

3.4. Aplikimi i legjislacionit penal në rastet e nxitjes së përçarjes dhe mos durimit

Sfondi

Liria e shprehjes është një e drejtë e garantuar në një numër të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë në KEDNJ, ku ajo njihet me nenin 10.¹¹⁰ Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ-ja ka vendosur që liria e shprehjes përbën një nga themelet thelbësore të shoqërive demokratike, si dhe një nga kushtet themelore për përparimin e tyre dhe për zhvillimin e çdo personi.¹¹¹ Ajo gjithashtu vendosi që kjo e drejtë mund të thirret jo vetëm në lidhje me informacionin dhe idetë që priten në mënyrë të favorshme ose konsiderohen jo-ofenduese ose si çështje indiference, por edhe për ato që ofendojnë, tronditin ose shqetësojnë, meqë “*këto janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe mendje hapjes pa të cilat nuk ka shoqëri demokratike*”.¹¹²

Duke qenë se nuk është një e drejtë absolute, në lirinë e shprehjes mund të ndërhyhet, me kusht që ndërhyrja të përmbushë kërkesat e ligjshmërisë, legjitimitetit dhe domosdoshmërisë në shoqëritë demokratike, siç është elaboruar nga GJEDNJ-ja. Gjuha e urrejtjes, që është “*të gjitha llojet e shprehjes që nxisin, promovojnë, përhapin ose arsyetojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi ose grupi personash, ose që i denigron ata, për shkak të karakteristikave ose statusit të tyre personal të vërtetë ose të atribuar, siç janë “raca”, ngjyra, gjuha, feja, shtetësia, prejardhja kombëtare ose etnike, mosha, aftësia e kufizuar, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual*”¹¹³, nuk konsiderohet pjesë e lirisë së shprehjes pasi shkelë të drejtat e të tjerëve. Prandaj, autoritetet kanë detyrën ta parandalojnë dhe ta luftojnë atë duke vendosur dispozita të rregulluara me kujdes të ligjit civil dhe administrativ, si dhe dispozita penale për forma të caktuara të gjuhës së urrejtjes.¹¹⁴ Faktorët që përcaktojnë nëse gjuha cilësohet si gjuhë e urrejtjes përfshijnë kontekstin politik në të cilin bëhen deklaratat dhe nëse, në atë kontekst, ato mund të shihen si një thirrje e drejtpërdrejtë ose e tërthortë për dhunë, ose si arsyetim për dhunë, urrejtje ose mos durim.¹¹⁵ Dispozitat penale duhet të aplikohen si masë e fundit dhe në mënyrë proporcionale.

Në Kosovë, forma të caktuara të gjuhës së urrejtjes janë të penalizuara sipas nenit 141 të Kodit Penal për nxitje të përçarjes dhe mos durimit.¹¹⁶ Sjellja që është bazë e nenit 141 mund të marrë forma të ndryshme, si fjalime, shpërndarje posterash, materiale të shpërndara përmes

110 Neni 10: Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

111 GJEDNJ, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1976, paragrafi 49.

112 GJEDNJ, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1976, paragrafi 49; GJEDNJ, *Observer and Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1991, paragrafi 59.

113 Duke pasur parasysh se nuk ka përkufizim të njohur universalisht për gjuhën e urrejtjes, ai i përdorur në këtë raport është nga Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës drejtuar Shteteve Anëtare për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, CM/Rec(2022)16.

114 GJEDNJ, *Özgür Gündem kundër Turqisë*, 16 mars 2000, paragrafi 63.

115 GJEDNJ, *Perinçek kundër Zvicrës*, 15 tetor 2015, paragrafët 205-206.

116 Kodi Penal i Kosovës, 06/L-074, 14 janar 2019, Neni 141, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>. Neni 141 thotë: “1. Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. 2. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij apo të saj kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. 3. Kushdo që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni përmes shtrëngimit, rrezikimit të sigurisë, përqeshjes së simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. 4. Kushdo që në mënyrë sistematike ose duke keqpërdorur pozitën apo autorizimet e tij kryen veprën penale nga paragrafi 3. i këtij neni ose shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda me kryerjen e veprës së tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

faqeve të internetit online të cilat janë të qasshme publikisht, etj. Ajo duhet të synojë përhapjen e urrejtjes kundër grupeve specifike, bazuar në karakteristika si kombësia, orientimi seksual, etnia, feja, etj. Elementi i nxitjes do të thotë se duhet të ekzistojë qëllimi për të shkaktuar një lloj reagimi nga publiku/personat të cilëve u drejtohet, dhe ky reagim duhet të paraqesë kërcënim për rendin publik. Sipas kornizës ligjore, Prokuroria Speciale ka juridiksion ekskluziv mbi rastet sipas neni 141 të KP-së.¹¹⁷

Në një aktgjykim të vitit 2023, i cili liroi nga akuzat një të pandehur për veprën penale nga neni 141, paragrafi 1, i KP-së, Gjykata Supreme¹¹⁸ sqaroi se vepra penale e nxitjes së përçarjes dhe mos durimit përbëhet nga tri elemente kumulative të cilat duhet të jenë të pranishme njëkohësisht: 1) *actus reus*, d.m.th. veprimi i nxitjes ose përhapja publike e urrejtjes ose përçarjes dhe mos durimit; 2) *mens rea*, që do të thotë qëllimi i nxitjes ose përhapjes publike të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit midis grupeve racore dhe etnike; dhe 3) mundësia e prishjes së rendit publik. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata Supreme gjithashtu kujtoi se e drejta e pasjes së mendimeve është element thelbësor i të drejtës së lirisë së shprehjes të mbrojtur sipas neni 10 të KEDNJ-së dhe në thelb sqaroi se pasja dhe shprehja e mendimit që nuk e kanë shumica e popullsisë nuk mund të konsiderohet se përbën në vetvete nxitje të përçarjes dhe mos durimit.

Një dispozitë tjetër relevante në këtë kontekst është neni 11 i Ligjit për rendin dhe qetësinë publike,¹¹⁹ i cili sanksionon shpërndarjen ose shfaqjen e çdo shkrimi, shenje ose përfaqësimi të dukshëm që është fyes ose i pahijshëm me qëllim që të kërcënojë prishjen e qetësisë. Kjo është një kundërvajtje dhe dënohet me gjobë. Ky cilësim ndonjëherë përdoret nga institucionet gjyqësore kur një shprehje nuk i plotëson elementet e veprës penale që nxit përçarje dhe mos durim.

Në përgjigje të rritjes së perceptuar të rasteve të iniciuara ose të gjykuara sipas neni 141 të KP-së, EULEX-i kreu një vlerësim paraprak mbi aplikimin e kësaj dispozite nga institucionet gjyqësore. Informacioni dhe gjetjet më poshtë janë nxjerrë nga tetë raste nga periudha 2023-2025, prej të cilave një është gjykuar, ndërsa rastet e tjera janë ende në pritje ose përfundimisht janë mbyllur.

Gjetjet

Një çështje e përsëritur e identifikuar në shumicën e rasteve të monitoruara është pasiguria nëse kualifikimi i veprimeve ose deklaratave sipas neni 141 të KP-së ishte i saktë. Në disa raste, individët u morën në pyetje dhe më vonë iu iniciuan procedura penale pasi kishin vendosur letra ngjitëse, kishin bërë deklaratat publike ose kishin veshur veshje me simbole të konsideruara si provokuese ose fyese. Në mungesë të gjitha elementeve të veprës penale nga neni 141 përshkruar më sipër, dhe në dritën e mjedisit të ndjeshëm etnik/politik në Kosovë, EULEX-i konsideron se deklaratat ose shfaqja e atyre simboleve përbënin thjesht shprehje të një mendimi politik ose përkatësie kombëtare ose etnike.

Në një nga rastet e monitoruara, individët u vendosën gjithashtu në paraburgim për disa muaj përpara se akuzat për nxitje të përçarjes dhe mos durimit të rrëzoheshin në fund. Kjo ndodhi në një rast të tre shtetasve të huajë të arrestuar për shkak të një mbishkrimi në automjetin e tyre që përmbante një pikëpamje politike.

117 Ligji për Prokurorinë Speciale, 08/L-168, 23 nëntor 2023, neni 9, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84236>.

118 Gjykata Supreme e Kosovës, *Rasti Todosijević*, 3 korrik 2023, Pml.nr.157/2023.

119 Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike, 03/L-142, 17 shtator 2009, <https://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2009-142-eng.pdf>.

Disa raste ngritën shqetësime edhe në lidhje me trajtimin e të miturve. Konkretisht, një numër fëmijësh të mitur u privuan për një kohë të shkurtër nga liria dhe u morën në pyetje nga policia për veshjen e bluzave me simbole kombëtare ose për pikturimin e grafitëve, duke përbërë shkelje të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe të ligjit të Kosovës, të cilat parashikojnë që ndalimi i të miturve, edhe për një kohë të shkurtër, duhet të përdoret vetëm si masë e fundit. Disa nga të miturit morën gjoba për kundërvajtje bazuar në nenin 11 të Ligjit për rendin dhe qetësinë publike. Megjithatë, në rastet e monitoruara që përfshijnë të mitur, qëllimi i kërkuar me ligj për kërcënimin e prishjes së qetësisë nuk ishte i drejtpërdrejtë. Si përfundim, EULEX-i konstaton se PK-ja, Prokuroria Speciale dhe gjykatat demonstrojnë një interpretim të pabarabartë të veprës të nxitjes së përçarjes dhe mos durimit, shpesh duke vepruar me shpërfillje ndaj jurisprudencës përkatëse të Gjykatës Supreme dhe duke shkelur nenin 10 të KEDNJ-së.

Një qasje ndëshkuese ndaj asaj që mund të konsiderohet si manifestim i lirisë së shprehjes mund të dëmtojë besimin e publikut në institucione, veçanërisht në mesin e komuniteteve jo shumicë, duke çuar në ndasi shoqërore të mëtejshme. Një qasje më e ndjeshme nga autoritetet, e bazuar në angazhim konstruktiv dhe dialog me të gjitha segmentet e shoqërisë, është e nevojshme për të balancuar në mënyrë adekuate lirinë e shprehjes me nevojën për të parandaluar dhe ndëshkuar gjuhën e urrejtjes. Duke pasur parasysh kontekstin politik dhe shoqëror të Kosovës, është me rëndësi të madhe të sigurohet një zbatim i drejtë, proporcional dhe jo diskriminues i legjislacionit në këtë fushë. Në dritën e këtyre konsiderimeve, EULEX-i inkurajon të gjitha palët të angazhohen në mënyrë konstruktive në këtë temë, dhe paraqet rekomandimet e mëposhtme.

Rekomandime

- ✓ Kufizimet për shfaqjen e simboleve në kontekste të ndjeshme bazuar në konsiderime të rendit publik duhet të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 10 të KEDNJ-së, siç interpretohet në jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ-së. Për më tepër, çdo kufizim i tillë duhet t'i komunikohet publikut në mënyrën e duhur.
- ✓ EULEX-i u bën thirrje autoriteteve që të përdorin sanksione penale ose kundërvajtje vetëm kur janë të pranishme të gjitha elementet e veprave.
- ✓ Për të shmangur veprimet e panevojshme dhe/ose jo proporcionale të policisë, veçanërisht në lidhje me të miturit, EULEX-i inkurajon PK-në që të ngritë një sistem ku zyrtarët policorë mund të marrin këshilla në kohë reale nga prokurorë ose këshilltarë ligjorë nëse një sjellje mund të konsiderohet se përmbushë kriteret nga neni 141 i KP-së dhe nga neni 11 i Ligjit për rendin dhe qetësinë publike.
- ✓ EULEX-i bën thirrje për më shumë diskutime ndër-institucionale, për shembull në formën e punëtorive/tryezave të rrumbullakëta me PK-në, Prokurorinë Speciale, gjyqtarët dhe shoqërinë civile, për të arritur një mirëkuptim të përbashkët mbi atë se cilat sjellje përbëjnë nxitje të përçarjes dhe mos durimit ose shfaqje të materialeve të pahijshme dhe ofenduese, duke siguruar një ekuilibër të duhur midis lirisë së shprehjes dhe luftës kundër gjuhës së urrejtjes, dhe duke marrë parasysh standardet e drejtësisë për të miturit.
- ✓ Në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe ligjin e Kosovës, PK-ja duhet t'i ndalojë të miturit vetëm si masë e fundit.

3.5. Përdorimi dhe mirëmbajtja e Sistemit për menaxhimin informativ të lëndëve

Sfondi

SMIL është pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e gjyqësorit dhe prokurorisë së Kosovës. SMIL është sistem elektronik që ruan një sërë informacionesh në lidhje me lëndët. Sistemi është vendosur që nga viti 2018 dhe, pavarësisht disa sfidave të përshkruara më poshtë, është një element i rëndësishëm i sundimit të ligjit që kontribuon në përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe qasjes në drejtësi brenda gjyqësorit të Kosovës.

Gjetjet

SMIL është një ndihmë e madhe në punën e përditshme të gjykatave dhe prokurorive. Falë SMIL, kryetarët e gjykatave themelore, gjyqtarët mbikëqyrës në degët e gjykatave, si dhe kryeprokurorët në prokuroritë themelore mund të verifikojnë lehtësisht veprimet dhe progresin e bërë nga gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët juridikë dhe stafi tjetër. Më konkretisht, përmes SMIL, kryeprokurorët ose kryetarët e gjykatave themelore mund të mbikëqyrin lehtësisht punën e secilit prokuror ose gjyqtar në mënyrë digjitale dhe të shohin se sa shpesh e kanë hapur sistemin, për cilat raste dhe cilat dokumente janë ngarkuar. Gjithashtu, SMIL tregon statusin e lëndës pa pasur nevojë të shikohet nëpër regjistrat fizike dhe të kërkojnë dosjet e rasteve. Një shembull i shkëlqyer praktik i dobisë së SMIL u demonstrua pas një zjarri që shkatërroi zyrat e dy gjyqtarëve në degën e Gjykatës Themelore të Ferizajt në Kaçanik në pranverën e vitit 2024. Afër 300 raste janë rimëkëmbur falë ekzistencës së kopjeve elektronike në SMIL.

Për më tepër, nëpërmjet SMIL, bashkëpunimi mes gjykatave themelore dhe prokurorive themelore bëhet me kohë dhe në mënyrë efikase. Vetëm në rastet e paraburgimit, ku vendimet duhet të merren brenda pak orësh nga gjyqtarët kujdestarë, ndodh që versioni në letër i dosjeve të rasteve dorëzohet nga prokurorët kujdestarë në gjykatë përpara versionit elektronik të SMIL. Edhe pse lëshime të tilla nuk kanë implikime të konsiderueshme negative, ato duhet të shmangen. Do të ishte e dëshirueshme që gjyqtarët të kenë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në kompjuterët e tyre, si dhe në tavolinën e tyre. Kur dosjet elektronike nuk janë ende të disponueshme, gjyqtarët kujdestarë mund të punojnë me dosje në letër në situata të jashtëzakonshme për të mirën e menaxhimit të shpejtë të rasteve. Megjithatë, dosjet e rasteve të Prokurorive themelore duhet të ngarkohet në SMIL përpara se të jepet vendimi.

Me një shënim më pak pozitiv, EULEX vëren se mirëmbajtja e SMIL, e cila është e nevojshme për funksionimin e tij të papenguar, nuk rregullohet në një kontratë të përhershme. Kjo ka qenë sfidë e vazhdueshme për një kohë. Tenderi për mirëmbajtjen e SMIL, i cili u përsërit për herë të tretë, dështoi përsëri në fund të prillit 2025. Aktualisht, sistemi mirëmbahet vetëm nga stafi i KGJK-së, pavarësisht mungesës së ekspertizës së tyre teknike të mjaftueshme. Në rast të mosfunksionimit të SMIL, është e diskutueshme nëse ekspertiza për të zgjidhur problemin është e disponueshme. Kompanitë që kishin kontratë tenderimi për SMIL në të kaluarën, e mirëmbanin sistemin në bazë të një kontrate emergjente *ad hoc*, ose ndonjëherë për shkak të marrëdhënieve të tyre të mira të krijuara me KGJK-në. Aktualisht, nuk ka zgjidhje të përhershme dhe të realizueshme. Një element kaq i rëndësishëm i funksionimit efikas të gjyqësorit nuk mund të varet nga vullneti i mirë i dikujt, veçanërisht pasi mund të lindin probleme serioze me mirëmbajtjen e duhur të përditshme të SMIL.

Në Raportin e Monitorimit të Drejtësisë të EULEX-it për vitin 2021, EULEX-i i rekomandoi KGJK-së që të zhvillojë një trajnim shtesë të përshtatur për SMIL-in bazuar në një anketë me përdoruesit e SMIL-it, si mjet për ta bërë SMIL-in më miqësor për përdoruesit dhe më përmbushës. Në mars të vitit 2025, një anketë u shpërnda nga KGJK-ja te i tërë stafi përkatës i gjyqësorit,

e strukturuar në formën e një pyetësoi i cili ishte përshtatur sipas përgjegjësiave specifike të punës së gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve ligjorë, zyrtarëve ligjorë dhe nëpunësve të administratës/regjistrimit. Qëllimi i anketës ishte të identifikoheshin problemet dhe nevojat e stafit për të vendosur përparësitë për përmirësimet e sistemit, megjithatë, shumica e stafit nuk morën pjesë në anketë.¹²⁰ Rezultati i anketës pret të analizohet nga KGJK-ja.

EULEX-i ka vërejtur më tej se, edhe pse Prokuroritë Themelore e vlerësojnë nivelin e bashkëpunimit mes zyrave të tyre dhe PK-së si të mjaftueshëm dhe pa probleme serioze, nevojiten përmirësime të regjistrimit të palëve dhe skanimit të saktë të dosjeve të rasteve. Sistemi elektronik i përdorur në stacionet e policisë nuk është SMIL, por është kompatibil me të. Ndërsa ky fakt nuk shkakton probleme në vetvete, janë identifikuar disa sfida në shkëmbimin elektronik të dhënave me Prokuroritë Themelore. PK-ja është në dijeni se dokumentet që nuk futen në SMIL nuk do të pranohen në formë fizike nga prokuroritë themelore. Një përjashtim bëhet vetëm në rastet që përfshijnë paraburgimin, ku dosjet në letër mund të dorëzohen përpara se të regjistrohen digjitalisht në SMIL, për shkak të procedurave të ndjeshme ndaj kohës. Megjithatë, vendimet merren vetëm pasi të jetë marrë versioni elektronik përkatës. Ka pasur raste kur parashtresat e reja për rastet e regjistruara në sistem të jenë trajtuar gabimisht si raste të reja, duke rezultuar në krijimin e numrave të rinj të SMIL. Mangësitë e zakonshme të ndërveprimit përfshijnë skanime të paplota ose me cilësi të dobët dhe dokumente të lëndëve dhe pjesë të raporteve që mungojnë. Këto zakonisht janë për shkak të gabimit njerëzor, që vijnë nga njohuri të pamjaftueshme ose mungesë trajnimit mbi përdorimin e sistemit elektronik të policisë. Në disa stacione të policisë, vetëm një zyrtar është i trajnuar për të operuar sistemin dhe për të menaxhuar transferimet e dosjeve në Prokuroritë Themelore. Raportet e policisë shpesh nuk kanë të dhëna të mjaftueshme personale mbi palët e përfshira, si numrat personalë të identifikimit, detajet e kontaktit, etnia ose statusi ekonomik. Këto gabime njerëzore duhet të adresohen.

Në fund, përfundimi i mbështetjes së ofruar nga Gjykata Norvegjeze e Administratës për SMIL në dhjetor 2025, pa ndonjë zgjatje të mëtejshme të parashikuar, është shqetësues. Planifikimi dhe buxhetimi i duhur për SMIL është thelbësor për zhvillimin dhe përparimin e tij afatgjatë.

Rekomandime

- ✓ Meqë në rastet e paraburgimit, u vu re se versioni në letër i dosjeve të rasteve dorëzohet nga prokurorët kujdestarë në gjykatë para versionit elektronik të SMIL, EULEX-i inkurajon KGJK-në dhe KPK-në që të sigurojnë ndërveprimin në lidhje me shkëmbimin në kohë të të dhënave elektronike mes gjykatave dhe prokurorive.
- ✓ Duke marrë parasysh rëndësinë e SMIL në kontributin për përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe qasjes në drejtësi brenda gjyqësorit të Kosovës, EULEX-i i bën thirrje KGJK-së që të sigurojë mirëmbajtje profesionale dhe afatgjatë të SMIL-it, po ashtu me planifikim dhe buxhetim të duhur.
- ✓ Me qëllim identifikimin e problemeve dhe nevojave të stafit dhe përcaktimin e prioritetëve për përmirësimet e sistemit, EULEX-i e inkurajon KGJK-në që të analizojë dhe, nëse është e arsyeshme, të zbatojë kërkesat e përdoruesve që kanë dalë nga anketa për SMIL.
- ✓ Duke marrë parasysh sfidat e vërejtura në shkëmbimin elektronik të dhënave me prokuroritë themelore, EULEX-i inkurajon PK-në që të trajtojë një numër më të madh të zyrtarëve policorë mbi përdorimin e sistemit elektronik të policisë për transferimin e të dhënave të prokuroritë themelore.
- ✓ Në mënyrë të ngjashme, PK-ja duhet të sigurojë saktësinë dhe plotësinë e dosjeve të rasteve para dërgimit të tyre të prokuroritë themelore për regjistrim në SMIL.

¹²⁰ Nga 1250 pyetësorë, vetëm 491 u plotësuan sipas *Raportit të vlerësimit të nevojave për përmirësimin e SMIL të KGJK-së, Projektit CMIS*, 17 prill 2025.



eulex.kosovo



eulexkosovo



eulex.kosovo



eulex-mission-in-kosovo



eulexkosovo



EULEXKosovo



www.eulex-kosovo.eu